

Personat që nuk dëgjojnë në Shqipëri, 2015

Studim

*Redaktuar nga
Inkeri Lahtinen dhe Päivi Rainò*



FINNISH ASSOCIATION
OF THE DEAF



UNIVERSITY OF
APPLIED SCIENCES


© Shoqata Finlandeze e Njerëzve që nuk Dëgjojnë dhe autorët
ISBN 978-952-5396-77-5 (kopertina në shqip)
ISBN 978-952-5396-78-2 (PDF në shqip)

Struktura dhe paraqitja grafike nga Suvi Pylvänen

Shtypur dhe botuar nga “Gent Grafik”, Shqipëri 2016

Ky studim ka si qëllim të përdoret nga cilido, por përmbajtja e tij nuk mund të ndryshohet apo modifikohet pa marrë pëlqimin e autorëve. Gjithashtu, në çdo rast kur ky studim të kopjohet, përkthehet, interpretohet apo të merret si referencë pjesërisht ose tërësisht, duhet të përmendet në cilësinë e burimit.

Ky studim u botua me mbështetjen e Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të organizatës së Partneritetit Finlandez për Aftësinë e Kufizuar i financuar nga Ministria Finlandeze e Punëve të Jashtme dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, në kuadër të Programit të OKB-së për Përfshirjen Sociale të financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



PARATHËNIE

Studimi i dedikuar “Për Personat që nuk dëgjojnë në Shqipëri” vjen si studimi i parë i këtij lloji dhe si një domosdoshmëri në kushtet e zbatimit të Konventës së OKB “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK)”, e cila u ratifikua nga shteti shqiptar në shkurt të vitit 2013.

Në kuadër të ratifikimit të kësaj Konvente, qeveria shqiptare filloi të ndërmerre masa të menjëhershme për përmirësimet e nevojshme ligjore që afektojnë personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri. Një qasje të re ligjore solli miratimi i Ligjit Nr 93/2014 në Korrik të vitit 2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e PAK” nga Parlamenti Shqiptar i cili i hapi rrugë hartimit të shumë akteve nënligjore që do të ndikonin në përmirësimin e statusit të personave me aftësi të kufizuar.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në Mars të vitit 2014, vendosi ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës, i cili punoi për njohjen dhe zyrarizimin e gjuhës shqipe të shenjave dhe finalizoi punën e tij me miratimin e VKM Nr.837 Datë 3.12.2014 “Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces bëri shumë evident edhe nevojën për të pasur një pasqyrë të qartë jo vetëm të numrit të personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri por edhe të situatës së tyre social-ekonomike, statusit arsimor, punësimit por edhe aksesit në shërbimet publike. Iniciativa e MMSR së bashku me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të personave që nuk dëgjojnë (ANAD) dhe Shoqatën finlandeze të personave që nuk dëgjojnë (FAD) për të kryer një vërtetim të dedikuar, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Statistikave (INSTAT) sot është bërë realitet.

Duke qenë se deri më sot nuk ka pasur asnjë studim apo informacion të besueshëm cilësor në lidhje me situatën e popullsisë që nuk dëgjon në Shqipëri, qëllimi i këtij vërtetimi është mbledhja e informacionit mbi personat adultë që nuk dëgjojnë si dhe mundësitë e tyre për bashkëveprim në jetën e përditshme, qasjen e tyre ndaj informacionit, edukimit dhe punësimit - në funksion të neneve dhe parimeve kryesore të Konventës Ndërkombëtare, lidhur me personat që nuk dëgjojnë dhe gjuhën e shenjave.

Ky studim vjen njëkohësisht si një vlerë e shtuar, në funksion të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për PAK për periudhën 2016-2020, duke krijuar një informacion bazë për matjen e progresit të treguesve të planit apo edhe impaktin e zbatimit të masave dhe ndërhyrjeve të parashikuara. Rezultatet e këtij studimi do të ndihmojnë gjithashtu në hartimin dhe zbatimin e politikave të sektorëve të ndryshëm të cilat do të kenë ndikim në jetën e personave që nuk dëgjojnë.

Një falënderim i veçantë për të gjithë bashkëpunëtorët në këtë proces të cilët mundësuan realizimin me sukses të studimit “Për Personat që nuk dëgjojnë në Shqipëri, 2015”.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)

Instituti i Statistikave (INSTAT)

Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD)

Shoqata Finlandeze e Njerëzve që Nuk Dëgjojnë (FAD)

Universiteti i Shkencave të Zbatuara në Finlandë (HUMAK)

Program për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie		
Falënderim për komunitetin shqiptar të personave që nuk dëgjojnë		1
Përmbledhje ekzekutive		3
Personat që kontribuuan		5
1	Hyrje	7
	<i>Päivi Rainò dhe Inkeri Lahtinen</i>	
1.1	Një histori e kohëve të fundit e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri, e shoqatës së njerëzve që nuk dëgjojnë dhe e gjuhës shqipe të shenjave	7
	<i>Dëshmi personale: Vështrim në historikun e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri nga viti 1960 deri më sot</i>	9
	<i>Eduard Ajas</i>	
1.2	Statistikat dhe terminologjia për humbjen e dëgjimit dhe mungesën e dëgjimit	11
	<i>Päivi Rainò</i>	
2	Historiku I studimit	13
	<i>Inkeri Lahtinen dhe Päivi Rainò</i>	
	<i>Puna në terren e kryer nga përdoruesit e gjuhës së shenjave që nuk dëgjojnë</i>	17
	<i>Florjan Rojba</i>	
3	Bazat statistikore të vrojtimit	21
	<i>Mirela Muça, Emira Galanxhi dhe Alma Kondi</i>	
3.1	Baza e zgjedhjes dhe njësitë e vrojtimit të kampionit	21
3.2	Shtresëzimi	23
3.3	Madhësia e kampionit	23
3.4	Procedurat e përzgjedhjes së kampionit	24
3.5	Procesi i vlerësimit	25
3.6	Historiku demografik	26
	3.6.1 Matja e aftësisë së kufizuar	26
	3.6.2 Struktura e popullsisë në total dhe e personave që nuk dëgjojnë	27
	<i>Ekstraktet nga raportet e punës në terren</i>	31

4	Rezultatet e studimit	35
	<i>Päivi Rainò dhe Liisa Martikainen</i>	35
4.1	Historiku demografik i të anketuarve	35
4.2	Arsimi	38
	4.2.1 Arsimi dhe alfabetizmi	39
	4.2.2 Arsimi dhe punësimi	42
4.3	Punësimi	43
4.4	Mjedisi gjuhësor dhe njohuritë mbi gjuhën shqipe të shenjave	46
	<i>Dy ditë në jetën e secilit prej nesh</i>	<i>51</i>
	<i>Florjan Rojba</i>	
4.5	Aksesi në informacion	52
	<i>Mesazhe në grup në WhatsApp</i>	<i>55</i>
5	Konkluzione dhe rekomandime	57
	<i>Florjan Rojba dhe Inkeri Lahtinen</i>	
5.1	Komente të përgjithshme	57
5.2	Rekomandime	58
	5.2.1 Zbulimi dhe ndërhyrja e hershme	59
	5.2.2 Arsimi bazë	61
	5.2.3 Arsimi dytësor i lartë, shkolla e mesme dhe arsimi i lartë	63
	5.2.4 Punësimi	64
	5.2.5 Aksesi në informacion dhe në shërbimet e përkthimit	65
	5.2.6 Për mbrojtjen sociale	67

Referenca

Shtojca 1	Pyetësi i studimit
Shtojca 2	Statistika të tjera për popullsinë me probleme në dëgjim sipas Censurit të vitit 2011 në Shqipëri.
Shtojca 3	A. Shënime B. Probabiliteti i përzgjedhjes C. Faktorët bazë të vlerësimit D. Rregullimet e faktorëve bazë të vlerësimit E. Rregullimet nga mospërgjigjet

Tabela

Figura

FALËNDERIM PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR TË PERSONAVE QË NUK DËGJOJNË

Ekipi i studimit shpreh mirënjohjen e tij për të gjithë personat që nuk dëgjojnë dhe interpretët që dhanë kontributin e tyre në këtë studim:

Ekipet e punës në terren që udhëtuan në të gjithë Shqipërinë; drejtuesit e komuniteteve që nuk dëgjojnë nëpër rrethe dhe personat e kontaktit për ndihmën e dhënë në gjetjen e personave që nuk dëgjojnë për t'u intervistuar dhe shoqërimin në disa raste të ekipeve edhe në zonat më të thella të vendit; të gjithë të anketuarit që morën pjesë në intervista si dhe familjarët dhe të afërmit e tyre të cilët lehtësuan komunikimin. – Falë informacioneve të dhëna prej jush u bë i mundur realizimi i këtij vrojtimi shumëkahësh dhe shumëgjuhësor. Faleminderit!

Gjithashtu shprehim mirënjohje të thellë edhe për personat e mëposhtëm:

Koordinatorin dhe trajnuesin e grupit të punës në terren



Florjan Rojba

Grupin e punës në terren – intervistuesit, regjistruarit e të dhënave, reporterët



Eduard Ajas



Valmira Avdullaj



Lidia Capa



Jetmir Dekovi



Erkid Hatia



Klisman Ibrahim



Ilirjana Jupa



Irena Oruçaj



Denis Plloça

Interpretët dhe përkthyesit të cilët

- përkthyen tekstet nga gjuha e shenjave në gjuhën shqipe dhe anasjelltas



Sopot Bogdani



Rovena Rojba



Adela Rrjoll



Aljona Spahi



Nikoleta Spahi

- përkthyen tekstet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe të shenjave dhe nga gjuha shqipe e shenjave në gjuhën finlandeze të shenjave



Arttu Liikamaa

- përkthyen tekstet nga gjuha e shenjave ndërkombëtare në gjuhën shqipe të shenjave dhe nga kjo e fundit në anglisht



Selman Hoti

Të gjithë personat që nuk dëgjojnë që ndihmuan interpretët dhe garantuan cilësinë e përkthimit nga gjuha e shenjave e përdorur nga punonjësit e terrenit dhe të teksteve të tjera në gjuhën e shenjave në shqip dhe sërish në gjuhën shqipe të shenjave

*Eduard Ajas, Valmira Avdullaj, Jetmir Dekovi, Klisman Ibrahimimi,
Ilijana Jupa, Denis Plloça*

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria e ratifikoi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) në shkurt të vitit 2013. Meqenëse nuk ekzistonte asnjë studim apo informacion i besueshëm sasior në lidhje me situatën e popullsisë që nuk dëgjon në Shqipëri, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ngarkoi Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD) dhe Shoqatën Finlan-deze të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (FAD) për të kryer një studim në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Statistikave (INSTAT).

Qëllimi i këtij studimi “Personat që nuk Dëgjojnë në Shqipëri 2015” ishte sigurimi i informacionit për personat e rritur që nuk dëgjojnë në Shqipëri, mundësitë e tyre për ndërveprim me njerëzit në jetën e përditshme, aksesin e tyre në informacion, arsimim dhe punësim, në kuadër të neneve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) lidhur me personat që nuk dëgjojnë dhe gjuhën e shenjave. Personat që nuk dëgjojnë u përfshinë në të gjitha aspektet dhe fazat e procesit të studimit, që nga planifikimi e deri te shpërndarja e rezultateve përmes zbatimit të metodave me pjesëmarrje dhe me bashkëpunim dhe duke ndjekur parimet e studimeve më të fundit të aftësisë së kufizuar. Nëntë intervistues, staf i ANAD-it që nuk dëgjojnë dhe anëtarë të tjerë, e kryen studimin gjatë periudhës 20.1.–21.2.2015, duke intervistuar përmes gjuhës së shenjave dhe përshtatjeve të saj 434 persona që nuk dëgjojnë në Shqipëri. Për këtë u përdor një pyetësor online i strukturuar, i përpiluar në gjuhën shqipe të shkruar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe të shenjave.

Gjendja civile e të intervistuarve

Nga të intervistuarit, 61% ishin meshkuj dhe 39% ishin femra. 67% e të anketuarve (N=434) ishin të martuar, 86% e tyre me një person tjetër që nuk dëgjon. (3% e të anketuarve ishin të divorcuar dhe 1% të ve.) Shumica e të anketuarve të martuar (93%) kishin fëmijë, 72% e tyre kishin më shumë se një. Një e katërta (26%) ishin të pamartuar. Pothuajse gjysma e të intervistuarve jetonin me prindërit (49%); 62% me bashkëshortin/en dhe fëmijët; 18% me vëllezërit e motrat; 12% jetonin me vjehrrin/vjehrrën. Vetëm 4% e të anketuarve jetonin vetëm. (Shuma e përqindjeve shkon më shumë se 100%, për shkak se këto kategori mbivendosen pjesërisht. P.sh. një person mund të jetojë me prindërit e tij/saj dhe me vëllezërit e motrat e tij/saj.)

Arsimi i të intervistuarve

83% e grupit të kampionit kishin ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë (shkollë 9-vjeçare), 319 madje e kishin mbaruar institutin. Të gjithë përveç njërit (1) kishin ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë në Tiranë. Shtatë (7) prej tyre madje kishin provuar të shkonin edhe në shkollë për personat që dëgjojnë, për 1-8 vjet, ndërsa 14 të intervistuar kishin ndjekur vetëm një shkollë për nxënësit që dëgjojnë (3-9 vjet).

Në grupin e kampionit ishin 16 nga 434 persona që kishin ndjekur shkollën e mesme. Megjithatë, ata kishin hasur vështirësi të mëdha për shkak të aftësive të dobëta në lexim dhe shkrim. 11 persona nga ky nëngrup do të kishin preferuar të ndiqnin shkollën me një interpret të gjuhës së shenjave. Sidoqoftë, kjo do të kishte qenë e pamundur për shkak të mungesës së interpretëve. Vetëm tre (3) nga këta 16 të anketuar kishin ndjekur arsimin e lartë pas shkollës së mesme, njëri prej tyre në shkollën e artit dhe dy të tjerë në

vendet fqinje (nga të dhënat e mbledhura nuk disponojmë specifikime të programit apo institucionit).

Gjithashtu, ata pohuan se kishin hasur vështirësi gjatë studimeve të tyre për shkak të aftësive të dobëta në lexim dhe shkrim në gjuhën shqipe.

Punësimi i të intervistuarve

46% e të intervistuarve deklaruan se ishin të papunë. Sipas statistikave të INSTAT-it, shkalla e përgjithshme e papunësisë te qytetarët e moshës 15 deri në 64 vjeç në Shqipëri është rreth 15%. Në krahasim me këtë, shkalla e papunësisë te personat që nuk dëgjojnë është 3 herë më e lartë në krahasim me personat pa aftësi të kufizuara. Nëse krahasojmë faktorët lidhur me nivelin arsimor dhe punësimin, mund të themi se ata që kanë ndjekur dhe përfunduar Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, nga pikëpamja statistikore kanë pasur më shumë mundësi për t'u punësuar se sa ata që nuk e kishin përfunduar shkollën ose ata që kanë ndjekur shkollën për personat që dëgjojnë.

Aksesueshmëria gjuhësore e të intervistuarve

Për të pasur një përshtypje diagnostifikuese të aftësive gjuhësore në gjuhën shqipe të shkruar mes personave që nuk dëgjojnë, gjatë studimit u prezantua një test i shkurtër leximi. Të anketuarve iu prezantua një histori që përmbante shtatë fjali së bashku me nëntë vizatime. Vetëm shtatë (7) persona (2% e të gjithë grupit të kampionit) ishin në gjendje të zgjidhnin vizatimet që lidheshin disi me rrjedhën e historisë dhe t'i rendisnin ato në mënyrë të pranueshme. 38% e të gjithë të anketuarve u përgjigjën menjëherë se ishin analfabetë në gjuhën shqipe dhe se nuk dëshironin t'u përgjigjeshin kësaj pyetjeje të studimit, dhe 23% (102 persona) zgjedhën vizatime krejtësisht të gabuara

që nuk lidheshin semantikisht me historinë. Edhe këta persona mund të konsiderohen analfabetë, njëjloj si ata që refuzuan të merrnin pjesë në këtë test. - Në krahasim me Censusin kombëtar të vitit 2011, sipas të cilit shkalla e analfabetizmit për popullsinë 10 vjeç e lart është 2,8%, numri i personave analfabetë që nuk dëgjojnë është shumë i lartë. Ende mbetet shumë e lartë krahasuar me popullsinë me aftësi të kufizuara (15 vjeç e lart), ku shkalla e analfabetizmit është 21%.

Në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, përveç gjuhës së folur, mësimi kryhet duke përdorur daktilimin (gjuha shqipe e transliteruar në alfabetin me forma dore) shoqëruar me gjeeste. (Vetëm katër të anketuar pohojnë se janë arsimuar edhe në gjuhën e shenjave.) 97% e të anketuarve pretendojnë se aftësitë komunikuese të mësuesve janë “të dobëta”; sipas 3% të tyre, komunikimi ishte i kuptueshëm (“mesatar”). Asnjë i anketuar nuk arriti të jepte një vlerësim pozitiv (“mirë”).

Në kundërshtim me historinë tradicionale sociale dhe kulturore të popullsisë që nuk dëgjon në vende të tjera, vetëm disa të anketuar (9%, n=139), të cilët pohuan se e njihnin pak gjuhën shqipe të shenjave (AlbSL), e kanë mësuar atë në shkollë nga shokë të tjerë klase që nuk dëgjojnë, duke e mësuar në moshë më të madhe, kryesisht nga persona të tjerë që nuk dëgjojnë dhe duke qenë në kontakt me ANAD-in.

Sipas të anketuarve, gjuha që ata përdorin me anëtarë të tjerë të familjes që dëgjojnë është një formë e folur ose e shkruar e gjuhës shqipe, e cila mund të prodhohet nga alfabeti daktil me forma dore për të treguar fjalë të shkëputura. Vetëm nëntë persona ishin në gjendje të përdornin gjuhën e shenjave me anëtarët e tyre të familjes që dëgjojnë. Kur komunikojnë me persona jashtë familjeve të tyre, personat që nuk dëgjojnë kanë nevojë për ndihmën e të tjerëve, duke qenë se 94% e tyre deklarojnë se nuk arrijnë të kuptojnë të folurit e personave që dëgjojnë (pjesa tjetër prej 6% është në gjendje të kuptojë, por me vështirësi). 87% e të anketuarve kanë pohuar se personat që dëgjojnë nuk arrijnë t'i kuptojnë (vetëm 11% perceptojnë se janë kuptuar nga të tjerët, por me vështirësi). Përveç dy interpretëve që punojnë në ANAD, në të gjithë vendin ekzistojnë vetëm katër interpretë me trajnim bazë në gjuhën e shenjave. Vetë prindërit e të anketuarve, vëllezërit e motrat dhe miqtë - pavarësisht faktit se nuk e njohin gjuhën e shenjave - kanë shërbyer si lehtësues gjatë komunikimit me këta persona që nuk dëgjojnë.

Aksesi në informacion

Matja e aksesit në informacion është bërë duke pyetur të intervistuarit se çfarë mendonin rreth informacionit në lajme dhe ngjarjet aktuale. Shumica e të anketuarve (87%) deklaruan se e merrnin informacionin nga lajmet në gjuhën e shenjave në televizor apo në faqet e internetit, ose duke u besuar miqve që përdornin gjuhën e shenjave. Rreth 60% përpikeshin ta

kërkonin informacionin duke parë pamjet në televizor. Megjithatë, tekstet e shkruara mbeten një burim i rëndësishëm informacioni edhe për të anketuarit analfabet, prej të cilëve një e treta e tyre përpikeshin të mblidhnin informacione nga gazetatat dhe lajmet e shkruara në faqet e internetit.

Konkluzione dhe rekomandime

Bazuar në rezultatet e studimit mund të deklarohet, si konkluzion i përgjithshëm, se popullsia që nuk dëgjon në Shqipëri nuk gëzon mundësi të njëjta si personat që dëgjojnë në lidhje me jetesën e pavarur, të drejtën për arsim të përgjithshëm dhe studime të mëtejshme, të drejtën për punësim që i përshtatet potencialit dhe informacion. Për më tepër, sikur të mos mjaftonte kjo, skemat e mbrojtjes sociale nuk i njohin nevojat e personave që nuk dëgjojnë.

Ekziston nevoja për të përsheptuar ndryshimin e paradigmes nga konsiderimi i mungesës së dëgjimit vetëm si gjendje mjekësore në një model shoqëror të mungesës së dëgjimit. Një hap drejt këtij objektivi është që gjuha shqipe e shenjave të marrë statusin e gjuhës minoritare. Në momentin që popullsia e personave që nuk dëgjojnë nuk do të shihet më vetëm si një grup me aftësi të kufizuara por edhe si një minoritet gjuhësor, të gjitha palët përgjegjëse do të përftojnë instrumente më të mira për të trajtuar pengesat gjuhësore dhe të tjera me të cilat popullsia e personave që nuk dëgjojnë përballet gjatë gjithë jetës dhe që konfirmohen qartësisht në këtë studim.

Kapitulli i fundit përfshin propozime konkrete lidhur me masat që duhen për të plotësuar kapacitetin dhe mangësitë e tjera të vërejtura në fushat e studimit. Në të theksohet rëndësia e ndërhyrjes së hershme për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe metodës dygjuhëshe në arsim për personat që nuk dëgjojnë, si dhe ekspozim të vazhdueshëm dhe akses në gjuhën e shenjave në të gjitha aspektet e jetës së një personi që nuk dëgjon. Rekomandimet formojnë një kuadër dhe një udhërrëfyes për zbatim, i cili kërkon angazhim të fortë nga disa ministri të linjës për bashkëpunim ndërministror, si dhe bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), si ekspertja dhe aktorja kryesore që përfaqëson grupin e fokusit. Përveç ndryshimit të mëtejshëm të legjislacionit të nevojshëm, nismat e nevojshme duhet të marrin burimet e duhura buxhetore, duhet të garantohet zbatimi i tyre gjatë periudhave të mandatit elektoral dhe të ndiqen në të gjitha fazat në nivel qendror dhe vendor.

Me miratimin dhe zbatimin e rishikimeve në legjislacion dhe zbatimin në realitet të masave të rekomanduara, Shqipëria ka mundësinë të bëhet një vend lider në rajonin e Ballkanit sa i përket përmbushjes së detyrimeve që dalin nga KDPAK dhe respektimit të të drejtave të njeriut të personave që nuk dëgjojnë.

PERSONAT QË KONTRIBUAN

Bardhylka Kospiri, Zëvendësministre, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë MMSR; Kryetare e grupit ndërministror të punës për gjuhën e shenjave.
Porositëse e studimit.



Mirela Muça,
Drejtoare e Përgjithshme,
Instituti i Statistikave INSTAT.
Bashkautore.



Eduard Ajas, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë ANAD.
Ekspert nga përvoja personale.
Bashkautor.

Ilda Bozo, Drejtoare e Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë MMSR; Koordinatorë e grupit ndërministror të punës për gjuhën e shenjave.
Bashkautor.



Emira Galanxhi, Drejtoare e Drejtorisë së Statistikave Sociale, Instituti i Statistikave INSTAT. Anëtare e grupit ndërministror të punës për gjuhën e shenjave.
Bashkautor.



Alma Kondi, Përgjegjëse e Sektorit për Cilësinë Statistikore, Instituti i Statistikave INSTAT.
Bashkautore.



Inkeri Lahtinen, Menaxhere Projekti, Shoqata Finlandeze e Njerëzve që nuk Dëgjojnë FAD.
Projektimi dhe koordinimi i studimit, bashkëredaktore dhe bashkautore.



Päivi Rainò, Studiuese, Universiteti i Shkencave të Aplikuara Humak, Finlandë; Ph.D., Lektore e parë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Humak. Fushat e saj të ekspertizës janë aksesueshmëria gjuhësore e personave që nuk dëgjojnë dhe me probleme në dëgjim; Linguistika e gjuhës së shenjave dhe gjuha e shkruar/e folur si gjuhë e dytë për përdoruesit e gjuhës së shenjave; Historia e gjuhës së shenjave dhe e personave që nuk dëgjojnë.
Projektimi i studimit, analiza cilësore dhe statistikore; bashkëredaktore dhe bashkautore.



Florjan Rojba, Koordinator i Përgjithshëm, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë ANAD. Trajnues dhe koordinator për punën në terren; ekspertë nga përvoja personale.
Bashkautor.



Liisa Martikainen, Studiuese, Universitetin e Shkencave të Aplikuara Humak, Finlandë; Ph.D., Lektore e parë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Humak. Fushat e saj të ekspertizës janë analizat statistike sasiore; Kërkime për nivelin e kënaqësisë ndaj jetesës dhe cilësisë së jetesës.
Analiza statistikore, bashkautore.



Suvi Pylvänen, MA, Lektore në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Kymenlaakso, Finlandë.
Struktura dhe paraqitja grafike.

Ylli Gorka, përkthyes shqip–anglisht.
Përkthimi i raporteve të punës në terren dhe diskutimeve me shenja.



1.1 Një histori e kohëve të fundit e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri, e shoqatës së njerëzve që nuk dëgjojnë dhe e gjuhës shqipe të shenjave

Pas Luftës së Dytë Botërore Shqipëria ka qenë për 50 vite vendi më i izoluar në Evropë. Ato vite ishin një sfidë për të gjithë popullsinë, por edhe për personat që nuk dëgjonin.¹ Shumë prej tyre ishin të izoluar nga shoqëria, duke qëndruar brenda familjeve të tyre anëtarët e tjerë të së cilës nuk kishin probleme me dëgjimin, përdorimi i shenjave konsiderohej diçka e turpshme dhe regjimi komunist e ndalonte pjesëmarrjen e personave që i përkisnin një minoriteti gjuhësor ose etnik. Edhe pse në vitin 1960 u themelua në Tiranë një shkollë për fëmijët që nuk dëgjonin, Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, ky komunitet nuk mund të dilte hapur deri përpara rënies së komunizmit në vitet 90-të. (Hoyer 2007; Andoni, Shabani dhe Baçi 2003.) Në ato vite, në mbarë botën, arsimimi për nxënësit që nuk dëgjonin bazohej fort në metodën e të folurit, ku këta të fundit ishin të detyruar të përdornin të folurit dhe leximin e buzëve në komunikimin e tyre. Përdorimi i shenjave ishte i ndaluar, shpesh edhe me dhunë, pasi përdorimi i tyre konsiderohej si një nga faktorët kryesorë që pengonte të mësuarit e gjuhës së folur. Ndërkohë që në vendet perëndimore oralizmi filloi të mos përdorej më që prej viteve 80-të, mësuesit shqiptarë të nxënësve që nuk dëgjonin u formuan në Bashkimin Sovjetik dhe Kinë, ku mbizotëronte tradita e oralizmit (Hoyer 2007). Krahas gjuhës së folur dhe të shkruar shqipe, pak mësues e kanë lejuar transliterimin në gjuhën shqipe të alfabetit me forma dore (daktilimin) si mjete të vetëm pamor të komunikimit. Vetëm kohët e fundit disa prej mësuesve të nxënësve që nuk dëgjojnë kanë futur përdorimin e shenjave gjatë mësimit.

Siç përshkruhet në studimin novator të Hoyer-it (2007) dhe në dëshminë personale të Eduart Ajasit, të rinjtë që nuk dëgjonin kur ktheheshin pas shkolle në shtëpitë e tyre në fshat, shpesh e kishin të pamundur të takoheshin me njerëz të tjerë me të njëjtin problem. Sidomos gratë që nuk dëgjonin nuk lejoheshin të dilnin nga shtëpitë e tyre, ndërkohë që burrat me të njëjtin problem që jetonin në të njëjtat qytete apo fshatra mund të takoheshin me njëri-tjetrin. Shumë fëmijë që nuk dëgjonin nga familje të varfra të cilat jetonin në fshatrat e thella asnjëherë nuk e kanë pasur mundësinë të ndiqnin shkollën me konvikt në Tiranë. Ata ende jetojnë të izoluar nga njerëzit e tjerë që nuk dëgjojnë dhe madje mund të mbahen ende të izoluar nga prindërit të cilët e konsiderojnë problemin e tyre me dëgjimin si diçka të turpshme.

¹ Në këtë raport kemi rënë dakord të përdoret gjithmonë shkronja e vogël e shtypit d kur i referohemi popullsisë që nuk dëgjon dhe personave që identifikohen ose që e identifikojnë veten se nuk dëgjojnë - pa asnjë dallim nga shkalla e tyre e dëgjimit, gjuha e preferuar (ose modaliteti i gjuhës), qoftë gjuha e shenjave apo e folur, apo përkatësia e tyre e presupozuar ndaj kulturës së personave që nuk d/ Dëgjojnë ose që "dëgjojnë".

Personat që nuk dëgjonin filluan të mblidheshin rregullisht në mënyrë të organizuar vetëm pas rënies së Komunizmit në vitin 1990. Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD) u themelua zyrtarisht në vitin 1993. Ajo nuk ishte funksionale deri në momentin që ky komunitet mori kontakt me Shoqatën Finlandeze të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (FAD), në fillim të mijëvjeçarit. ANAD dhe FAD filluan bashkëpunimin zyrtar në vitin 2000. Në atë kohë (dhe deri në ditët e sotme) ky proces u financua nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës dhe FAD për përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe gjuhësore të personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri. Bashkë me ndryshimet në qëndrimet e shoqërisë në favor të pranimit të minoriteteve gjuhësore, bashkëpunimi afatgjatë dhe në shkallë të gjerë me FAD-in ka dhënë kontribut kryesor për promovimin në mënyrë aktive dhe nxitjen e personave që nuk dëgjojnë që të përdorin shenjat në komunikim. (Shih më poshtë edhe dëshminë personale të Eduard Ajas.)

Në vitin 2002, ANAD dhe FAD filluan dokumentimin e krijimit të gjuhës shqipe të shenjave (AlbSL). Në vitin 2005 u botua një fjalor – në libër dhe në DVD – “Gjuha e Shenjave Shqipe 1”, i cili përmbante rreth 250 shenja. (Hoyer 2007, ANAD 2005) Sidoqoftë, gjuha shqipe e shenjave pati shansin të krijohet dhe të fillonte procesin e saj të gjatë drejt një gjuhe të përbashkët kryesisht falë aktiviteteve sociale formale dhe joformale të individëve që nuk dëgjojnë, ende të organizuara më së shumti nga ANAD, dhe falë mbështetjes së ANAD-it për krijimin e grupeve aktiviste lokale. Në ditët e sotme i gjithë informacioni nga ANAD drejtuar personave që nuk dëgjojnë përcillet kryesisht në gjuhën shqipe të shenjave nëpërmjet faqes së internetit dhe Facebook-ut të ANAD-it me anë të shërbimeve që lejojnë regjistrimet me video (p.sh. Whatsapp). Po kështu, në vitin 2008, si rezultat i avokimit dhe trajnimit nga ANAD, stacioni televiziv kombëtar TVSH filloi transmetimin e përditshëm të lajmeve përmes shfaqjes në ekran të përdoruesit të gjuhës së shenjave. (Skinner 2013).

Ndërkohë që gjuha shqipe e shenjave filloi të përdorej ngadalë dhe të merrte formë kur personat që nuk dëgjojnë filluan të mblidheshin dhe të shoqëroheshin me njëri-tjetrin, ANAD dhe FAD kanë promovuar në mënyrë aktive të drejtat gjuhësore të këtij komuniteti dhe kanë përmirësuar statusin social të gjuhës së shenjave në mënyrë që ajo të njihet si gjuha e parë e personave që nuk dëgjojnë. Me anë të një dekreti të nënshkruar në dhjetor të vitit 2014, Parlamenti njohu zyrtarisht gjuhën shqipe të shenjave (Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 837, datë 3.12.2014, shih Avokati i Popullit 2015, 37). Përveç dy personave që punojnë tek ANAD dhe katër interpretëve të pavarur të cilët kanë marrë aftësitë bazë të interpretimit gjatë një programi trajnimi afatshkurtër në vitet 2007-2009, në Shqipëri nuk ka ende interpretë profesionalë. Nga njëra anë, gjashtë interpretë të gjuhës së shenjave janë shumë pak dhe nga ana tjetër personat që nuk dëgjojnë nuk mund të përballojnë koston e një shërbimi i cili nuk kompensohet nga sektori publik.

Megjithatë, sfida kryesore mbetet në fushën e arsimimit të këtij komuniteti ku mbi-zotëron ende tradita e oralizmit. Aktualisht, janë vetëm pak mësues të cilët zotërojnë mirë gjuhën e shenjave ose aftësi të tjera për të komunikuar nga ana pamore me nxënësit e tyre, përveç daktilimit.

Vështrim në historikun e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri nga viti 1960 deri më sot

Eduard Ajas

Perkhtimi nga gjuha shqipe e shenjave në anglisht

Do t'ju tregoj për jetën time si person që nuk dëgjoj në Shqipëri, duke filluar me arsimimin tim. Shkolla në Tiranë, të cilën unë e frekuentova për 9 vjet nga viti 1973 deri në vitin 1982, ishte themeluar 10 vjet më parë, në vitin 1963. Në ato vite për fat të mirë përdorej daktilimi, por mësuesit përdornin një metodë mësimdhënie me baza shumë të forta oralizmi. Nxënësit që nuk dëgjonin ishin të detyruar të përdornin të folurit duke qenë se gjuha e folur shqipe ishte gjuha e mësimdhënies, si për personat që nuk dëgjonin dhe për nxënësit me probleme në dëgjim. Ne përipiqeshim të flisnim, por në të njëjtën kohë daktilonim nën bankën e shkollës fjalët që shqiptonim. Nëse mësuesit na shikonin na rrihnin. Megjithatë, ne mund të komunikonim me njëri-tjetrin me gjeste dhe me disa shenja gjatë pushimit, në kohën e drekës dhe në konvikt. Ne kishim shenjat tona për shembull për TUALETIN, MËSUESIN, MAKINËN, BABANË dhe fraza të tilla si “BABAI I JEPTË MAKINËS”. Këto shenja janë përdorur që nga viti 1960 deri më sot.

Pas përfundimit të shkollës u ktheva përsëri te familja ime. Ndonjëherë takohesha me miqtë e mi që nuk dëgjonin duke u shkuar për vizitë në shtëpitë e tyre, por kurrë nuk takoheshim p.sh. në një kafene duke qenë se deri në vitin 1990 ne jetonim nën regjimin komunist. Ne nuk na lejohej të linim takime në vende publike. Gjatë atyre takimeve në shtëpinë e dikujt ne komunikonim kryesisht nëpërmjet daktilimit duke përdorur disa shenja shoqëruar me gjeste.

Pas çdo takimi ne caktonim takimin e radhës duke përcaktuar datën, orën dhe vendin e saktë. Familjet tona na luteshin që të qëndronim në shtëpi dhe të mos dilnim. Unë nuk mund ta kuptoja këtë duke qenë se nuk i njihja rregullat e rrepta komuniste. Pas vitit 1990, me ardhjen e demokracisë, personat që nuk dëgjonin filluan të takoheshin me njëri-tjetrin më lirshëm në vende publike (në kafene). Megjithatë, të moshuarit dhe të rinjtë takoheshin veçmas. Ata nuk takoheshin me grupmosha të ndryshme për shkak se

identiteti i grupit i bazuar në problemet e dëgjimit apo komunikimin me shenja nuk kishte dalë ende si koncept.

Jeta në vitet '90

Gjatë këtyre viteve në Shqipëri erdhi demokracia. Në vitin 1996 në Shqipëri erdhi një konsulente që nuk dëgjonte. Ajo ishte Katja Merentie nga Finlanda. Ishte hera e parë që shikoja një të huaj të përdorte gjuhën e shenjave, edhe pse komunikimi ynë me të bazohej në gjeste. Qëllimi i vizitës së saj ishte të mblidhte informacion në lidhje me situatën e personave që nuk dëgjonin në Shqipëri, komunikimin dhe jetën e tyre në përgjithësi gjatë periudhës së komunizmit. Pas vizitës ajo i propozoi organizatës së saj Shoqatës Finlandeze të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (FAD) që një grup përfaqësues i komunitetit të personave që nuk dëgjojnë nga Shqipëria të vizitonte Finlandën. Për të respektuar barazinë gjinore znj. Merentie theksoi se në grup duhet të kishte femra dhe meshkuj. Në ato kohë ne nuk e dinim rëndësinë e barazisë dhe ishim të bindur se burrat ishin më të fortë dhe më të ditur sesa gratë. Megjithatë, ne vendosëm që një grup prej pesë personash - dy gra dhe tre burra do të udhëtonte drejt Finlandës. Unë isha njëri prej tyre.

Ishte viti 2000 kur unë vizitova Finlandën për herë të parë. Ajo ishte një përvojë shumë e veçantë për mua pasi nuk kisha qenë kurrë jashtë vendit. Ishim jashtëzakonisht shumë të izoluar gjatë periudhës së komunizmit. Ai udhëtim më mësoi shumë gjëra.

Udhëtimi studimor filloi me një vizitë në zyrën e FAD-it. Ne duhej të vëzhgonim se si punonte një organizatë e drejtuar nga persona që nuk dëgjojnë. Gjithashtu vizituam disa klube të personave që nuk dëgjojnë në tre qytete (Tampere, Kerava dhe Pori). Ishte një përvojë emocionuese. Komuniteti finlandez i personave që nuk dëgjonin dukej i fuqishëm. Ato klube nuk drejtoheshin nga persona që dëgjonin por nga vetë personat që nuk dëgjonin. Më bëri për-

shtypje se si këta njerëz punonin së bashku në harmoni. Për herë të parë në jetën time pashë edhe një interpret të gjuhës së shenjave. Në atë kohë, nuk e kuptoja se çfarë do të thoshte të punoje me një interpret. Më vonë kuptova rëndësinë e interpretëve në punën avokuese dhe lehtësimin e komunikimit midis personave që nuk dëgjojnë dhe atyre që dëgjojnë. Një nga gjërat që më befasoi, ishte gjithashtu se në televizor mund të shihje programe në gjuhën e shenjave.

Kur u kthym në Shqipëri pyesja veten se si mund të trajnohesha për të bashkuar komunitetin e personave që nuk dëgjonin i cili ishte i shpërndarë në nëngrupe dhe në marrëdhënie jo të mira me njëri tjetrin. Doja që të gjitha ato gjëra që kisha parë të ndodhnin dhe në Shqipëri. Pas çlirimit komuniteti shqiptar i personave që nuk dëgjonin ishte shpërndarë në grupe të veçanta. Të rinjtë që nuk dëgjonin nuk mund t'u afroreshin të moshuarve që nuk dëgjonin. Ata thjesht përjashtoheshin për shkak të moshës së tyre. Kjo ishte dhe vazhdon të jetë një dukuri normale në kulturën tonë. Megjithatë, ne e kuptuam se ishte diskriminim i një grupi dhe e shfuqizuam atë parim. Unë doja të krijoja një komunitet të fortë të personave që nuk dëgjonin edhe në Shqipëri, dhe FAD premtoi se do të na mbështeste.

Mbështetja e huaj (2000–2006)

ANAD-i filloi të trajnonte, të zhvillonte dhe të fuqizonte komunitetin tonë shqiptar të personave që nuk dëgjonin. FAD-i rekrutoi një konsulent ndërkombëtar, z. Colin Allen, i cili erdhi nga Australia për të qëndruar me ne. Në fillim ne komunikonim kryesisht me anë të gjesteve duke qenë se gjuhët tona të shenjave ndryshonin shumë nga njëra-tjetra. Kur ai takohej me të rinj që nuk dëgjonin ai komunikonte lirshëm me ta. Kjo ishte e habitshme për ne, pasi te ne të moshuarit që nuk dëgjonin nuk i jepnin rëndësinë e duhur të rinjve që nuk dëgjonin. Megjithatë, z. Allen u shpjegoi atyre me durim se pavarësisht moshës të gjithë njerëzit duhet të trajtohen me respekt dhe dinjitet.

Z. Allen si edhe konsulentët e tjerë të FAD-it na kanë përkrahur jashtëzakonisht shumë, madje jo vetëm mua, por të gjithë stafin e ANAD-it. U jam shumë mirënjohës. Pa përkrahjen dhe trajnimin nga ana e konsulentëve nuk do të kishim arritur këtë fazë zhvillimi në të cilën jemi tani.

Në vitin 2003, për herë të parë në historinë e komunitetit shqiptar të personave që nuk dëgjojnë, ANAD filloi hulumtimin për gjuhën e shenjave në Shqipëri. Karin Hoyer, një konsulente gjuhësore nga FAD trajnoi tre anëtarë të stafit të ANAD-it të cilët nuk dëgjonin lidhur me punën me

gjuhën e shenjave. Ata zhvilluan aftësitë e tyre trajnuese dhe tani ndajnë njohuritë e tyre për gjuhën e shenjave me komunitetin e personave që nuk dëgjojnë nëpër rrethe.

Zhvillime të viteve të fundit (2007–2016)

Gjatë dhjetë viteve të fundit ka pasur zhvillime entuziaste pasi stafi i ANAD-it ka marrë shumë trajnime nga konsulentë të huaj. Gjithashtu kemi filluar të shkëmbejmë trajnime nëpër rrethe. Tani personat që nuk dëgjojnë nëpër rrethe mund të zhvillojnë më tej njohuritë dhe aftësitë e tyre të shenjave, krahasuar me kohë më parë, kur ata dinin shumë pak rreth kësaj gjuhe dhe përdornin vetëm daktilimin.

Për fat të keq kemi ende probleme, sidomos në fshatrat e largëta. Atje personat që nuk dëgjojnë, pasi përfundojnë shkollën, jetojnë të mbyllur në shtëpitë e tyre. Kemi persona që nuk dëgjojnë të moshës 40-60 vjeç dhe më të mëdhenj të cilët përdorin vetëm daktilimin me disa gjeste. Familjet e tyre mund t'i mbajnë të fshehur duke i penguar që të kenë kontakte me komunitetin përreth të personave që nuk dëgjojnë. Kjo bën që ata të harrojnë gjuhën e shenjave dhe daktilimin që mund t'i kenë mësuar në shkollë. Ka shumë raste të tilla për shkak të mungesës së informacionit.

Gjatë intervistave për studimin takuam një familje e cila kishte një vajzë që nuk dëgjonte e cila përdorte daktilimin. Pasi u përshëndeta me prindërit e saj, ata dukeshin të habitur që dhe unë isha një person që nuk dëgjoja. Vajza më pyeti se kur kisha vajtur në shkollë, cilët ishin miqtë e mi dhe se si mund t'i përdorja kaq mirë shenjat. I tregova asaj për ANAD-in, për personat që nuk dëgjojnë të cilët përdorin gjuhën e shenjave për të komunikuar e kështu me radhë. Vajza nuk dinte asgjë për këtë dhe ishte e zhgënjyer që ishte mbajtur në shtëpi nga prindërit e saj. U përpoqa t'i shpjegoja situatën familjes së saj, por ishte shumë e vështirë për shkak të mungesës së informacionit që kishin, madje edhe për të drejtat themelore civile të gjithë qytetarëve.

Edhe kur takon një person që dëgjon komunikimi është sërish i vështirë dhe jo i lehtë. Kur shkoj të bëj pazar, për shembull, tregoj me gisht një artikull (“dy nga kjo”) dhe pastaj një artikull tjetër (“tre nga ajo”) dhe pastaj me një gjest pyes se sa kushtojnë. Ky është “komunikimi im pamor”. Leximi i buzëve është gjithashtu një sfidë. Nëse takohem me një shok që nuk ka probleme dëgjimi, kjo është sigurisht shumë më e lehtë pasi ai do të përdorë gjeste dhe shenja pamore, por përsëri, leximi i buzëve të tij, i asaj çfarë ai është duke thënë është tej mase i vështirë.

1.2 Statistikat dhe terminologjia për humbjen e dëgjimit dhe mungesën e dëgjimit

Päivi Rainò

Një person i cili nuk është në gjendje të dëgjojë si një person me dëgjim normal me prag dëgjimi prej 25 decibelë (dB) ose më shumë në të dy veshët thuhet se ka humbje të dëgjimit. Humbja e dëgjimit mund të jetë e lehtë, e moderuar, e rëndë ose e thellë. Nga humbja e dëgjimit mund të preket njëri vesh ose të dy veshët, dhe shkon deri në vështirësi në të dëgjuarin e bisedave madje dhe të tingujve lartë. “Persona me probleme në dëgjim” i referohet individëve me humbje të dëgjimit nga shkalla më e lehtë deri te shkalla më e rëndë. Ata zakonisht komunikojnë nëpërmjet gjuhës së folur dhe mund të përdorin aparate dëgjimi, implant koklear dhe teknologji të tjera ndihmëse, të tilla si titrimi.

Personat që nuk dëgjojnë kanë kryesisht një humbje të thellë të dëgjimit, e cila nënkupton shumë pak ose aspak dëgjim. Ata shpesh përdorin gjuhën e shenjave për të komunikuar. Humbja e dëgjimit ka të bëjë me humbjen e më shumë se 40 decibelë (dB) të dëgjimit në veshin që dëgjon më mirë, tek të rriturit, dhe një humbje e më shumë se 30 dB në veshin që dëgjon më mirë, te fëmijët (shih Tabelën 1). Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) pjesa më e madhe e njerëzve të cilët vuajnë nga humbja e dëgjimit jetojnë në vende me të ardhura të ulëta ose mesatare (OBSH 2016, 2015a).

Tabela 1. Shkalla e dëmtimit të dëgjimit (Komisioni Evropian 2016, OBSH 2008).

Shkalla e dëmtimit	Vlera përkatëse audiometrike ISO	Rezultati	Rekomandime
0 - Asnjë dëmtim	25 dB ose më shumë (veshi që dëgjon më mirë)	Asnjë ose probleme shumë të vogla dëgjimi. Në gjendje të dëgjojë pëshpëritjet.	
1 - Dëmtim i lehtë	26–40 dB	Në gjendje të dëgjojë dhe të përsërisë fjalë që fliten me zë normal në distancë 1 metër.	Konsultim. Aparatet e dëgjimit mund të jenë të nevojshëm.
2 - Dëmtim i moderuar	41–60 dB (veshi që dëgjon më mirë)	Në gjendje të dëgjojë dhe të përsërisë fjalë që fliten me zë të lartë në distancë 1 metër.	Zakonisht rekomandohen aparatet e dëgjimit.
3 - Dëmtim i rëndë	61–80 dB (veshi që dëgjon më mirë)	Në gjendje të dëgjojë disa fjalë të thëna me zë të lartë në veshin që dëgjon më mirë.	Aparatet e dëgjimit janë të nevojshme. Nëse nuk ka asnjë aparat dëgjimi, duhet të mësohet leximi i buzëve dhe gjuha e shenjave. *)
4 - Dëmtim i thellë duke përfshirë mungesën e dëgjimit	81 dB ose më shumë (veshi që dëgjon më mirë)	Pamundësi për të dëgjuar dhe kuptuar edhe kur bërtasin me zë të lartë	Aparatet e dëgjimit mund të ndihmojnë për të kuptuar fjalë. Nevojitet rehabilitim i mëtejshëm. Leximi i buzëve dhe ndonjëherë edhe përdorimi i shenjave janë thelbësore. *)

Shkallët 2, 3 dhe 4 klasifikohen si humbje e dëgjimit.

Vlerat audiometrike ISO janë mesataret e vlerave 500, 1000, 2000, 4000 Hz.

*) “Fëmijët që nuk dëgjojnë duhet të mësojnë që të vegjël gjuhën e shenjave dhe të arsimohen si përdorues të shumë gjuhëve në lexim dhe shkrim. Mësuesit duhet të trajnohen për gjuhën e shenjave dhe t’u sigurohen materiale arsimore të aksesueshme.” (Raporti Botëror për Aftësinë e Kufizuar i OBSH-së, 2011, 227.) (Raporti Botëror për Aftësinë e Kufizuar i OBSH-së, 2011, 227.)

Dëmtimi i dëgjimit mund të quhet si “aftësi e kufizuar me incidencë të ulët” (Mitchell dhe Karchmer 2006). Përpara vitit 2011 nuk ka pasur statistika zyrtare mbi popullsinë që vuante nga humbja e dëgjimit në Shqipëri. Censusi kombëtar i kryer në vitin 2011, identifikoi për herë të parë personat me kufizime në shikim, dëgjim, lëvizje, kujtesë, kujdesin ndaj vetes dhe komunikim. Objektivi kryesor i Censurit ishte të përcaktonte numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar sipas kategorive të mëposhtme: aspak vështirësi – pak vështirësi – shumë vështirësi – nuk mundem fare (INSTAT 2012, 14; 90). Në këtë Census numri i personave mbi moshën 15 vjeç që nuk mundej fare të dëgjonte ishte 5351. Në këtë shtresë të popullsisë prej 2,2 milionë banorë (me një popullsi totale prej 2,8 milionë banorë), prevalenca e aftësisë së kufizuar në dëgjim është 2,4 për çdo 1000 persona. Ka pak më shumë gra (N = 2806) sesa burra (N = 2545). (INSTAT 2012, 90.)

Sipas Censurit të vitit 2011, 10% e popullsisë nga moshë 15 vjeç e lart vuan nga një humbje e dëgjimit që varion nga dëmtim i lehtë në dëmtim të thellë. 38 000 persona (1,7%) kanë shumë vështirësi me dëgjimin ose një humbje të plotë të dëgjimit e cila, sipas klasifikimit të OBSH-së, do të përfshihej në kategoritë e “rëndë” ose e “thellë” (shih INSTAT, 2012, 90, 164.). 5351 persona e kishin fare të pamundur të dëgjonin (INSTAT 2012, 90) dhe 10 378 persona e kishin fare të pamundur të komunikonin (INSTAT 2012, 98). Nga ana tjetër, në Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) të kryer një vit më pas lidhja midis aftësisë së kufizuar në “komunikim” dhe “dëgjim” (0,54) ishte më e dobët se ajo midis “kujtesës” dhe “komunikim” (0,79) (Ferré, Galanxhi dhe Dhono 2015, 15). Këto rezultate korrelacioni tregojnë se kufizimet në komunikim jo domosdoshmërisht varen nga dëgjimi, por me më shumë gjasa varen nga kufizimet në kujtesë. Megjithatë, në të dyja klasat u gjet një vështirësi e madhe ose pamundësi e plotë në dëgjim dhe në komunikim në 0,5% të popullsisë (Ferré, Galanxhi dhe Dhono 2015, 13). Me kërkesë të INSTAT të paraqitur po ashtu në prill 2016, ky studim i grupon shifrat bazuar në klasifikimin e Censurit 2011: popullsia 15 vjeç e lart me aftësi të kufizuara në komunikim dhe dëgjim sipas qarqeve arrin në 3051 persona në total (shih Shtojcën 2, Tabela I).

Këto shifra japin një tertium comparationis (krahasim) të shkëlqyer të studimeve mbi normat e prevalencës së humbjes së dëgjimit në popullsi të ndryshme. Vlerësimet më të reja të OBSH-së parashikojnë që në të ardhmen 9% e popullsisë në Evropën Qendrore (përfshirë këtu edhe Shqipërinë) do të vuajë nga humbja e dëgjimit (OBSH 2012). - Krahasuar me shifrat e mëparshme të mundësuar nga INSTAT, parashikimi i OBSH-së është disi shumë i lartë për Shqipërinë. Në Evropë, p.sh në Mbretërinë e Bashkuar, prevalenca e dëmtimit në dëgjim më e madhe se 40 dBs (shih Tabelën 1) është rreth 1,65 për 1000 lindje të gjalla dhe prevalenca e dëmtimit të lehtë në dëgjim, por i rëndësishëm për procesin e të mësuarit është afërsisht 2,05 për çdo 1000 fëmijë (Fortnum, Summerfield, Marshall, Davis dhe Bamford 2001).

2

HISTORIKU I STUDIMIT

Inkeri Lahtinen dhe Päivi Rainò



Shqipëria e ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) në shkurt të vitit 2013 (Tërësia e Traktateve të Kombeve të Bashkuara 2016). Si pjesë e harmonizimit të legjislacionit në lidhje me personat që nuk dëgjojnë, qeveria ngriti një grup pune ndërministror për procesin e njohjes të gjuhës së shenjave në Shqipëri duke caktuar Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si ministrinë përgjegjëse për këtë proces. Përveç të dhënave numerike të mbledhura për popullsinë me aftësi të kufizuara në Censusin kombëtar të vitit 2011, nuk kishte asnjë studim apo nuk ekzistonin të dhëna cilësore të besueshme për sa i përket situatës së personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri.²

Si rrjedhojë, u gjykua e nevojshme të kryhej një studim bazë i vlefshëm nga pikëpamja statistikore, në mënyrë që ministrinë të hartojnë ndryshime në legjislacionin ekzistues. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë njoftoi funksionimin e grupit të punës për njohjen e gjuhës së shenjave në mars të vitit 2014 dhe i propozoi Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD) dhe Shoqatës Finlandeze të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (FAD) të realizonin vrojtimin në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT).

Qëllimi i këtij vrojtimi ishte sigurimi i informacionit për personat e rritur që nuk dëgjojnë në Shqipëri, mundësitë e tyre për ndërveprim me njerëzit në jetën e përditshme, aksesin e tyre në informacion, arsimim dhe punësim, në kuadër të neneve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) lidhur me personat që nuk dëgjojnë dhe gjuhën e shenjave. Fokusi vihet veçanërisht mbi studimin e aksesueshmërisë gjuhësore: statusi i gjuhës së shenjave dhe gjuhës së shkruar në jetën e personave që nuk dëgjojnë dhe aksesin në informacion dhe shërbimet e interpretimit (nenet 2, 9 dhe 21 i KDPAK). Qëllimi gjithashtu është studimi i mënyrave në cilat arsimimi (neni 24 i KDPAK) i dhënë në shkollën speciale për personat që nuk dëgjojnë ka kontribuar në aftësitë gjuhësore të këtij komuniteti për të përmbushur kërkesat e shoqërisë që i rrethon. (Shih Tërësia e Traktateve të Kombeve të Bashkuara 2016.)

Hulumtimi u krye si një studim duke intervistuar në gjuhën e shenjave dhe përshtatjet e saj 434 persona që nuk dëgjojnë në Shqipëri gjatë periudhës janar dhe shkurt 2015. Intervistat u realizuan nga stafi i personave që nuk dëgjojnë i ANAD-it dhe anëtarë të tjerë duke përdorur një pyetësor online të strukturuar në gjuhën shqipe. Intervistat u kryen nga 9 intervistues që nuk dëgjonin gjatë periudhës 20.1.2015–21.2.2015.

² Më vonë në janar të vitit 2015, u botua një studim në lidhje me popullsinë me aftësi të kufizuara në Shqipëri (Ferré, Galanxi dhe Dhono 2015), me porosi të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. Studimi është bazuar në të dhënat e Censurit të vitit 2011 dhe në Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës të vitit 2012 dhe jep një panoramë të përgjithshme të popullsisë me aftësi të kufizuara, prevalencën e aftësisë së kufizuar dhe kushtet sociale dhe ekonomike. Sidoqoftë, studimi përmban vetëm disa detaje lidhur me personat me vështirësi në dëgjim dhe komunikim.

Përmbajtja e pyetësorit u hartua nga Päivi Rainò (Doktorante, gjuhëtare e gjuhës së shenjave, studiuese e kulturës së personave që nuk dëgjojnë dhe e studimeve të gjuhës së shenjave në Universitetin e Studimeve të Aplikuara (UAS) Humak, Finlandë) në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin e Përgjithshëm të ANAD, Florjan Rojba dhe Menaxheren e Projektit të FAD-it, Inkeri Lahtinen. Më pas, grupit kërkimor iu bashkua dhe ekspertja në analizën statistikore Dr. Liisa Martikainen (Universiteti i Studimeve të Aplikuara Humak). gjatë fazës së analizimit të rezultateve.

Qasja në këtë vërtetim në Shqipëri ishte të përpilohej një pyetësor në përputhje me metodat me pjesëmarrje dhe me bashkëpunim të hulumtimit, për të mbledhur dhe analizuar në mënyrë sistematike të dhënat në këtë kontekst shumë të veçantë gjeopolitik dhe gjuhësor, duke respektuar ekspertizën e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri dhe se këta të fundit duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e të gjithë procesit të hulumtimit duke filluar nga hipotezat deri te mbledhja e të dhënave; analizimi dhe interpretimi i rezultateve, dhe shpërndarja e tyre. Këto parime (të përmbledhura në sloganin “Asgjë për ne, pa ne”) janë të shprehura dhe në projektin: “Promovimi në nivel ndërkombëtar i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara” D.R.P.I, 2002. (Boucher dhe Fiset 2015; Samson 2015; Pinto 2011; OBSH 2011; Hoyer 2007; Kitchin 1999, Charlton 1998.)

Vërttimi i parë “specifik për personat që nuk dëgjojnë” i realizuar në rajonin e Ballkanit është kryer në Kosovë (Shoqata e Njerëzve që nuk Dëgjojnë në Kosovë dhe Shoqata Finlandeze e Njerëzve që nuk Dëgjojnë, 2010). Ai vërtetoi edhe një herë, se sfida kryesore për kryerjen e një vërtimi në një mjedis të ndryshëm kulturor është përshtatja e kontekstit të pyetjeve dhe e metodologjisë së intervistimit me komunikimin përkatës dhe kuadrin konjitiv dhe arsimor të grupit të synuar.³ Kështu, për shembull, pyetjet e formuluara paraprakisht dhe/ose pyetësorët e përpiluar për personat me aftësi të kufizuara (p.sh. Grupi i Uashingtonit për Statistikat e Aftësisë së Kufizuar, shih Qendra Kombëtare për Statistikat e Shëndetësisë, 2016) nuk mund të përdoren për personat të cilët nuk mund të lexojnë dhe dëgjojnë mirë ose për persona që nuk dëgjojnë të cilët përdorin gjuhën e shenjave pak të përhapur (“standarde”) ose ndonjë formë tjetër të një komunikimi pamor/me gjeste si gjuhën e tyre kryesore.⁴ Megjithatë, bazuar në përvojat afatgjata të ANAD-it, është normale që intervistuesit do të përballeshin me aftësi gjuhësore të ndryshme në punën e tyre në terren. Struktura dhe përmbajtja e vërtimit të kryer në Kosovë u modifikuan shumë nga grupi kërkimor, duke i përshtatur ato me tiparet gjuhësore dhe kulturore të mjedisit dhe kontekstit të ndryshëm në Shqipëri. Pas pilotimit të pyetësorit me gjashtë persona të rritur që nuk dëgjonin banues në Tiranë u bënë disa modifikime. Që prej fillimit të punës, grupi kërkimor u konsultua me ekspertët e Institutit Kombëtar të Statistikave në Shqipëri, INSTAT. INSTAT kishte kryer më parë një Census mbarëkombëtar (Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011) gjatë të cilit të anketuarit ishin pyetur dhe për aftësinë e tyre të kufizuar (kur kishte raste të tilla) si: humbja e dëgjimit dhe problemet lidhur me komunikimin.

³ Të njëjtat pyetje u trajtuan dhe në vërtimin e parë specifik për personat që nuk dëgjonin të kryer në Finlandë për të gjithë popullsinë e personave që nuk dëgjonin (Jalonen dhe Pohjonen 1975).

⁴ Vlerësimi i Përgjithshëm i Grupit të Uashingtonit për Aftësinë e Kufizuar (shih OBSH 2011) mbledh informacione në lidhje me kufizimet në kryerjen e aktiviteteve bazë, në nivel të përgjithshëm, në popullsitë e vendeve të ndryshme. Ai e ka të pamundur të identifikojë, për shembull, kufizimet në pjesëmarrje që shoqëria krijon për shkak të dallimeve në sjelljen gjuhësore midis anëtarëve të saj që nuk dëgjojnë dhe atyre që dëgjojnë. Megjithatë, kjo ka qenë gjithmonë sfida kryesore e hasur nga minoritetet e personave që nuk dëgjojnë, gjatë gjithë historisë së tyre në të gjithë botën (p.sh. Lane 1984).

Rezultatet e këtij Censusi bënë të mundur që INSTAT të vlerësonte kuadrin e kampionit të asaj shtrese të popullsisë të identifikuar si “fare të pamundur për të dëgjuar” (shih Kapitullin 3). Nisur nga kjo bazë të dhënash kombëtare, Drejtoria e Statistikave Sociale e INSTAT vlerësoi përfaqësimin e grupit kampion të përbërë nga anëtarët e ANAD-it, duke e krahasuar atë me grupin e synuar.

Grupi i synuar i këtij vrojtimi ishte popullsia e personave që nuk dëgjojnë. Si rrjedhojë, asnjë pyetje nuk do të kishte qenë e besueshme nëse do të ishte bërë në gjuhën e folur ose të shkruar. Duke qenë se e vetmja mënyrë për të marrë informacion direkt nga personat që nuk dëgjojnë ishte gjuha e shenjave, atëherë e vetmja mënyrë e mundshme për të marrë kontakt me këtë popullsi brenda afatit të shkurtër kohor të caktuar ishte të kontaktonim të gjithë anëtarët e ANAD-it. ANAD-i përbëhet nga persona të cilët kanë aderuar vullnetarisht në shoqatën kombëtare të njerëzve që nuk dëgjojnë për shkak të humbjes së rëndë të dëgjimit të tyre dhe preferencës gjuhësore për të përdorur një formë të gjuhës së shenjave në komunikim.

Pas informimit të anëtarëve të ANAD-it për kryerjen e vrojtimit në gjuhën e shenjave nëpërmjet faqes së internetit dhe Facebook-ut të ANAD-it, intervistuesit të cilët ishin persona që nuk dëgjonin (pesë çifte, 9 persona), të instruktuar mbi përdorimin e pyetësorit online dhe përkthimin e tij në gjuhën e shenjave, udhëtuan për të intervistuar të gjithë ata anëtarë të ANAD-it të cilët dolën vullnetarë për të marrë pjesë në vrojtim, 305 persona në mbarë vendin. Po kështu, 129 persona të tjerë, të identifikuar nga personat vendas që nuk dëgjonin si të intervistuar të mundshëm, u rekrutuan për t'u marrë në shqyrtim përmes të ashtuquajturës metodë kampionimi zinxhir. Intervistuesit përdorën një pyetësor online të strukturuar i përpiluar në gjuhën shqipe të shkruar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe të shenjave. Çdo pyetje iu drejtohej të intervistuarve përmes shenjave dhe çdo përgjigje e dhënë me shenja regjistrohej menjëherë në vend në bazën e të dhënave të programit të vrojtimit online (Webropol, ofruar nga Universiteti i Studimeve të Aplikuara Humak).⁵ Nëse nuk kishte lidhje interneti në vendin ku po kryhej vrojtimi, përgjigjet e dhëna me shenja dokumentoheshin në formatet e vrojtimit dhe raportoheshin në po të njëjtën ditë në bazën e të dhënave të programit Webropol.

Intervistuesit mbanin ditar dixhital në gjuhën e shenjave në telefonat e tyre celularë apo laptopë ku regjistronin rregullisht në gjuhën e shenjave vëzhgimet e tyre në vendet ku po kryhej vrojtimi. Ata ishin në kontakt të vazhdueshëm me intervistuesit e tjerë dhe koordinatorin nëpërmjet sistemit të telekonferencës që lejonte përdorimin e gjuhës së shenjave. Po kështu, u filmuan katër intervista nga fillimi deri në fund në katër vende të ndryshme për qëllime të kontrollit të cilësisë.

Analiza statistikore e mëposhtme e bazuar në këtë punë në terren është kryer nga Dr. Rainò dhe Dr. Liisa Martikainen. Nivelet më të zakonshme të vlerësimit të përfshira në këto të dhëna ishin në shkallë nominale dhe rendore. Lloji nominal i shkallës së vlerësimit tregon vetëm kategorinë në të cilën bën pjesë një rast (p.sh. “Ku e keni mësuar gjuhën e shenjave?”, “Çfarë aftësie tjetër të kufizuar keni?”). Shkalla rendore lejon që rastet të renditen sipas shkallës (“A keni pasur vështirësi në arsimim në shkollë të mesme?” (asnjë vështirësi/po, pak/po, shumë)) por distanca midis kategorive është e panjohur. Të dyja këto shkallë janë kategorike për nga natyra (shih

5 www.webropol.fi; www.webropol.com

p.sh. Argyrous 1997). Si rrjedhojë metodat statistikore të përdorura më së shumti në analizë janë ato që mund të përdoren me variabla kategorike, të tilla si shpeshësia dhe shpërndarjet sipas përqindjes, ndër-tabulimet dhe testet “chi-kuadrat”. Në disa raste të pakta janë përdorur dhe testet e korrelacionit. Problemi i përgjithshëm me analizimin dhe interpretimin e rezultateve është fakti se ka një numër të të anketuarve të cilët kanë keqkuptuar pyetje të caktuara. Ky fakt ndoshta mund të shpjegohet me natyrën komplekse të disa pyetjeve, si dhe me procesin e komplikuar të mbledhjes së të dhënave: pyetjet e bëra nga intervistuesit ishin pjesë e një pyetësoi i cili ishte hartuar në një gjuhë për të cilën shumë të anketuar nuk kishin njohuri dhe as aftësi të mira komunikimi, qoftë në gjuhën e shkruar dhe në atë të shenjave. Megjithatë mund të thuhet se rezultatet e vrojtimit janë mjaftueshëm të besueshme për të hedhur dritë mbi aspektet e rëndësishme në fjalë.

Puna në terren e kryer nga përdoruesit e gjuhës së shenjave që nuk dëgjojnë

Florjan Rojba

Përkthimi nga gjuha e shenjave ndërkombëtare në anglisht

Përgatitja e pyetësorit në gjuhën e shenjave dhe trajnimi për punën në terren

Pyetësi i vërtetimit i përbërë nga 48 pyetje u përkthye fillimisht nga anglishtja (gjuhë në të cilën ishte shkruar fillimisht) në gjuhën shqipe dhe nga gjuha shqipe në gjuhën shqipe të shenjave dhe pastaj përsëri në shqip dhe anglisht. Për fazën finale të përkthimit u desh shpesh herë kalimi ndërmjet gjuhëve shqip-anglisht-gjuha shqipe e shenjave. Pyetësi u realizua falë bashkëpunimit të ngushtë me studiuesit, interpretët dhe stafin e ANAD-it dhe përdoruesit e gjuhës së shenjave që nuk dëgjojnë. Ky proces u mbështet edhe nga një konsulent finlandez që nuk dëgjonte i FAD-it, Arttu Liikamaa, i cili shërbeu si interpret kulturor. Përkthimet e çdo pyetjeje u filmuan në mënyrë që çdo pyetje të mund të kontrollohej në laptopin që secili intervistues merrte me vete në vendin e intervistimit. Si koordinator i ANAD-it unë kisha përgatitur një prezantim 5 minuta të gjatë në të cilin shpjegohej qëllimi i vërtetimit i cili do të shfaqej në laptopin e

punonjësit të terrenit për çdo pjesëmarrës në vërtetim përpara se të kryhej intervista. Pasi të shikonte këtë mesazh në gjuhën e shenjave, i intervistuari duhej të vendoste nëse do të merrte pjesë në vërtetim apo jo.

Një grup prej 9 personash (5 burra dhe 4 gra) të grupmoshave të ndryshme morën pjesë në procesin e trajnimit që do të përgatiste intervistuesit që nuk dëgjonin për punën në terren. Duheshin marrë në konsideratë kërkesat e kulturës shqiptare si p.sh. mund të kërkohej prania e një punonjëse terreni femër në rast të intervistimit të grave. Trajnimi zgjati dhe u zhvillua në dy javë, një javë në fund të dhjetorit të vitit 2014 dhe një javë tjetër në janar të vitit 2015. Përpara kësaj ne kishim marrë udhëzime dhe orientime edhe nga INSTAT.

Seancat e trajnimit që unë udhëhoqa, kishin në fokus qëllimin e hulumtimit, aspektet praktike dhe përgjegjësitë gjatë kryerjes së intervistave, punën në çift, ndarjen e detyrave (intervistimin, trajtimin dhe regjistrimin e të dhënave në programin Webropol)



Figura 1.
Intervistuesit që nuk dëgjojnë gjatë trajnimit në zyrat e ANAD-it në Tiranë përpara nisjes së punës në terren.



Figura 2.
Eduart Ajas me një të anketuar vendas rrugës për në shtëpinë e tij në një fshat të largët.

dhe mbështetjen reciproke. Gjithashtu diskutuam gjatë për mënyrën se si të tregonim respekt ndaj ndryshimeve të mëdha në lidhje me aftësitë në gjuhën e shenjave dhe shumëllojshmërinë e mënyrave të komunikimit në komunitetin tonë të personave që nuk dëgjojnë, si të merrej parasysh arsimimi, mosha dhe kushtet socio-kulturore me të cilat do të përballëshin intervistuesit në vende gjeografikisht të ndryshme dhe si të respektonin legjislacionin lidhur me privatësinë. Ne bëmë praktikë duke përgatitur ditare në gjuhën e shenjave për dokumentimin e punës sonë në terren e cila normalisht do të realizohej vetëm nëse të intervistuarit do të pranonin të fotografeshin apo filmoheshin.

Pyetësi u testua, studiuu dhe u mësua përmendësh në gjuhën shqipe të shenjave, si edhe në gjuhën shqipe të shkruar. Për më tepër, pyetësi u pilotua në Tiranë, në zyrat e ANAD-it, ku u intervistuan dhe u filmuan katër të anketuar. Pas pilotimit pyetësi iu bënë sërish disa ndryshime të vogla për t'i dhënë atij versionin përfundimtar.


Me ekipin e intervistuesve ne përgatitëm një grafik të udhëtimeve nëpër rrethe për të gjitha ekipet e vrojtimit. Vendosëm objektivat për çdo javë, p.sh. sa njerëz do të intervistoheshin në rrethe dhe kohëzgjatjen e çdo udhëtimi. Secili ekip do të ndiqte listën

e dhënë nga INSTAT-i në lidhje me numrin e nevojshëm të të intervistuarve. Unë vetë mora përsipër të kontaktoja anëtarët aktivë të ANAD-it ose “personat lider që nuk dëgjonin” që jetonin në rrethe për t'i informuar në lidhje me vrojtimin, datën e intervistave dhe shkëmbeva numrat e telefonit midis këtyre liderëve dhe intervistuesve.

Realizimi i vrojtimit

Ekipet udhëtonin me autobus ose furgon në të gjithë rrethet dhe natën qëndronin në hotel. Fillimisht ata kontaktonin “personin lider vendas”, duke e informuar atë në lidhje me vrojtimin dhe së bashku planifikonin intervistat që do të kryheshin mëngjesin e nesërm. Në këtë mënyrë, ne ishim në gjendje të intervistonim anëtarët e ANAD-it dhe ata që nuk kishin pasur kontakte të mëparshme me ANAD-in. Të gjitha ekipet ishin në kontakt me njëri-tjetrin duke përdorur WhatsApp, dhe diskutonin me mua dhe njëri-tjetrin për çdo çështje, shqetësim apo gjetjen e ndonjë zgjidhjeje të menjëhershme për problemet që shfaqeshin.

Të nesërmen në mëngjes pas mbërritjes të dy intervistuesit takoheshin me personin lider që nuk dëgjonte, udhëtonin nëpër fshatra për të takuar personat që nuk dëgjonin të cilëve u ishte kërkuar të intervistoheshin. Disa fshatra ndodheshin afër por



disa të tjerë ndodheshin shumë larg nga vendi ku ekipi kishte zgjedhur të qëndronte. Në përgjithësi, ekipet fillimisht bënin intervistat në fshatrat më të largëta ku mund të bënin tre deri në katër intervista në ditë. Në fshatrat më të afërta, gjatë tre ose katër ditëve ekipet mundën të intervistonin 10-25 persona që nuk dëgjonin. Në qytetet më të mëdha dhe fshatrat e tyre më të afërta arritën të intervistonin edhe 45 persona në katër ditë. Në ato vende ku nuk kishte autobusë apo furgonë, ekipet përdornin taksì për të shkuar te njerëzit që nuk dëgjonin në fshatrat e thella për t'i intervistuar. Por kishte dhe vende ku nuk mund të shkoje dot as edhe me taksì. Si rrjedhojë, personi lider

Figura 3. Foto nga intervistat në terren. I anketuari i përqendruar në testin e leximit dhe në dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të vrojtimit të përcjella përmes shenjave nga personat që punuan në terren.

bashkë me ekipin e vrojtimit ecnin deri edhe në tre orë në këmbë, për të shkruar te familjet që nuk dëgjonin të cilat i njihnin.

Në mbrëmje dyshja e punës kthehej në hotel dhe filmonte një ditë të punës në terren (nga i cili janë shkëputur disa fragmente të përkthyer dhe janë përdorur në këtë raport). Nëse ndonjë çështje e dalë gjatë intervistave kërkonte sqarim, kontaktonim nëpërmjet aplikacionit WhatsApp. Në disa raste intervistuesit nuk mund ta plotësonin pyetësonin online në terren. Në ato raste mbanin shënime në një fletë pyetësoni nga e cila i transferonin të dhënat në programin Webropol. Nëpërmjet aplikacionit WhatsApp mund të merrja pyetjet dhe të dërgoja përgjigjet që merrja nga studiuesja finlandeze ose INSTAT-i tek anëtarët e ekipit tonë. Kjo ishte një mënyrë e shkëlqyer dhe efikase e komunikimit pamor, transparente dhe e kuptueshme nga të gjithë anëtarët e grupit tonë të punës.

Gjatë intervistave unë isha në Tiranë duke drejtuar punën dhe 9 intervistuesit ishin në rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Siç e përmenda dhe më lart, komunikimi midis nesh realizohej përmes forumit në WhatsApp pjesë e të cilit ishim të gjithë dhe ku çdo anëtar i ekipit mund të komentonte. Të gjitha ekipet punonin nga e hëna deri të premtën dhe të shtunën ktheheshin në Tiranë. Të dielave ne bënim një takim përmbledhës ku diskutonim për punën e bërë gjatë javës. Unë gjithashtu ndaja me anëtarët e tjerë të ekipit informacionin e përditësuar për mbledhjen e të dhënave online të cilin e merrnim çdo javë nga studiuesja. Ne punuam sipas planit tonë të veprimit të përgatitur po nga ne, nga data 21 janar 2015 deri më 22 shkurt 2015 dhe arritëm të intervistonim me sukses 434 persona që nuk dëgjonin nga 437 që ishte kuota e kampionit tonë në të gjithë Shqipërinë.

Për mua ishte hera e parë që koordinoja një proces të tillë kaq të madh vrojtimi. Megjithatë, ekipet ishin shumë të kënaqura me mënyrën tonë të komunikimit, mënyrën se si zgjidheshin problemet dhe se si rritej motivimi i tyre kur gjatë punës në terren lindnin probleme. Detyra kryesore e kthimit të pyetjeve në gjuhën e shenjave të një pyetësoni të shkruar në gjuhën që nuk njihet nga intervistuesi, sigurisht që ishte sfiduese. Por, duke pasur pyetësonin

në kompjuter, përveçse në gjuhën e shkruar edhe në gjuhën e shenjave, u bë i mundur kapërcimi i sfidës.

Sfidat dhe mësimet e nxjerra

Gjetja e mënyrës së duhur të komunikimit gjatë intervistimit të të anketuarve ishte një sfidë e vërtetë. Intervistuesve iu desh të provonin dhe të aplikonin një shumëllojshmëri të modaliteteve të gjuhës për të lehtësuar komunikimin të tilla si: gjuha shqipe e shenjave, daktilimi, gjestikulacioni, të treguarit me gisht ose kombinime të ndryshme të të gjithave së bashku. Shumë nga anëtarët e ekipit të vrojtimit takonin për herë të parë në jetën e tyre persona që nuk dëgjonin dhe që nuk shikonin. Megjithatë, ata mësuan të komunikonin me ta me gjuhën e shenjave me prekje. Ky ishte një moment “zgjimi” për shumë anëtarë të familjeve të cilët dëgjonin për të kuptuar se personat që nuk dëgjonin të “paarsimuar” janë në gjendje të reflektojnë dhe kanë të drejtë të thonë mendimin e tyre mbi një sërë çështjesh që kanë hasur gjatë jetës.

Intervistuesit kuptuan se ishin plotësisht të aftë për të kryer detyrën e cila nuk varej nga aftësitë e tyre në shkrim apo lexim. Ata mund të zgjidhnin problemet në gjuhën e shenjave si mënyra kryesore e komunikimit, duke lënë në hije gjuhën shqipe.

Intervistuesit i takuan personat që nuk dëgjonin në kushte të ndryshme jetese; disa ishin krejtësisht të izoluar, disa të tjerë përballëshin me një varfëri ekstreme, disa të tjerë, sidomos gratë dhe vajzat që nuk dëgjonin, diskriminoheshin hapur nga familjet e tyre, dhe të tjerë nuk kishin as informacion dhe as arsimim. Intervistuesit u prekën emocionalisht kur panë vështirësitë me të cilat përballëshin personat që nuk dëgjojnë në rrethe dhe përpjekjet që duhet të bënin në jetën e përditshme për t'i kapërcyer ato. Kjo përvojë ishte një kthim në realitet për intervistuesit, pasi u vendoste një perspektivë pengesave dhe problemeve në jetën e tyre. Ata tani i kuptojnë më mirë shumëllojshmëritë e situatave jetësore dhe kushtet e jetesës me të cilat përballlet popullsia që nuk dëgjon në të gjithë Shqipërinë.

3

BAZAT STATISTIKORE TË VROJTIMIT

Mirela Muça, Emira Galanxhi dhe Alma Kondi



3.1 Baza e zgjedhjes dhe njësitë e vrojtimit të kampionit

Njësitë e analizës dhe njësitë e vrojtimit janë grupet e mëposhtme:

1. Personat me aftësi të kufizuar në dëgjim të cilët janë përgjigjur “Nuk mundem fare” në Censusin e Popullsisë dhe Banesave 2011. Këta persona e kanë tërësisht të pamundur që të kryejnë një aktivitet të caktuar. E kemi shënuar “Nuk mundem fare” vetëm nëse personi nuk dëgjon fare.
2. Mosha e të anketuarve duhet të jetë 18 vjeç e lart.

Republika e Shqipërisë ndahet gjeografikisht në 12 Qarqe. Këto të fundit ndahen në Rrethe, të cilat ndahen në Bashkie dhe Komuna. Për qëllime statistikore, territori shqiptar (qytetet dhe fshatrat) ndahet në zona regjistrimi të Censurit (ZR-të). Tabela 2 tregon numrin e zonave të regjistrimit të familjeve në çdo qark të studimit tonë.

Tabela 2. Shpërndarja e ZR-ve, familjeve dhe individëve me aftësi të kufizuar në dëgjim, sipas qarqeve.

Qarku	Numri i ZR-ve	Numri i familjeve që kanë të paktën një anëtar me aftësi të kufizuar	Numri individëve	Shpërndarja në përqindje e individëve
Berat	523	348	386	7
Dibër	463	367	243	5
Durrës	817	614	444	8
Elbasan	1047	928	611	11
Fier	1147	809	744	14
Gjirokastrë	355	203	207	4
Korçë	904	555	451	8
Kukës	276	282	163	3
Lezhë	439	358	286	5
Shkodër	761	528	456	9
Tirana	2074	1293	905	17
Vlorë	701	448	455	9
Total	9507	6733	5351	100

Lista e bazës së zgjedhjes, përfshin klasifikimin urban/rural për çdo Zonë Regjistrimi (ZR) dhe do të përdoret për zgjedhjen e njërive primare të kampionimit (PSU). Kjo listë u ndërtua nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 dhe përmban informacionin për personat të cilët në Pyetësorin e Censurit 2011 në pyetjen e 35: “A keni vështirësi: në Dëgjim” janë përgjigjur nuk mundem fare. Tabela 2 përmban informacion rreth ZR-ve, familjeve, individëve të cilët nuk dëgjojnë dhe i korrespondojnë kategorisë “Nuk mundem fare”.

Anketa do të jetë një procedure 3 hapeshe kampionimi ku : në hapin e parë do të përdoren ZR-të si Njësi Primare të Kampionimit që do ti referohemi si PSU , hapi i dytë do të jenë familjet dhe në hapin e tretë do të përzgjidhen individët që do të anketohen. I gjithë procesi do të behët më zgjedhje të rastësishme.

Avantazhet e kësaj procedure me tre hapa përzgjedhjesh janë:

1. Procedura e përzgjedhjes është e thjeshtë për tu zbatuar dhe redukton mundësitë e gabimeve në procesin e përzgjedhjes.
2. Është e lehtë për të gjetur individët e përzgjedhur si dhe kjo metodë redukton mundësitë e gabimeve në procesin e përzgjedhjes si dhe mos-përgjigjet.
3. Intervistuesit intervistojnë vetëm individët në familjet e para-përzgjedhura. Asnjë zëvendësim i individëve nuk lejohet të realizohet nga anketuesi, për të parandaluar gabimet në studim.

Zgjedhja gjithashtu përmban për çdo ZR, numrin e familjeve dhe numrin e personave që nduk dëgjojnë. Informacioni për çdo ZR do të përdoret për llogaritjen e madhësisë së kampionit dhe përzgjedhjen e tij.

Për të kontrolluar gabimet e mbulimit, të cilat e bëjnë më pak përfaqësues kampionin, duhet që zgjedhja e kampionit të jetë e një cilësie optimale gjatë të gjitha fazave të zgjedhjes. Në fazën e parë, ZR (gjithashtu të quajtur PSU) duhet të mbulojë të gjitha zonat e banuara nga popullsia në studim. Kufijtë e PSU-ve janë të përcaktuara dhe të identifikuara qartë nga sistemi hartografik i përdorur.

3.2 Shtresëzimi

Kuadri i kampionit do të ndahet në shtresa pak a shumë homogjene për të përmirësuar efikasitetin e kampionit probabilitar. Niveli i shtresëzimit do të përdoret për të siguruar vlerësime të besueshme për secilën prej zonave të vlerësimit. Zonat e vlerësimit paraqiten në Tabelën 3.

Duhet të theksohet se nivelet e ndarjes urbane-rurale në qarqe nuk janë nivele të publikimit por janë vetëm nivele të kampionimit, dhe kjo është bërë për të përmirësuar efektivitetin e ndërtimit të kampionit. E vetmja kërkesë për nivelet e kampionimit është një minimum prej dy ZR-sh brenda çdo niveli.

3.3 Madhësia e kampionit

Madhësia e kampionit për një studim të caktuar përcaktohet nga saktësia e nevojshme për vlerësimet e studimit për çdo zonë, si dhe nga kufizimet në burime dhe ato operacionale. Saktësia e rezultateve të studimit varet si nga gabimi në zgjedhjen e kampionit, i cili mund të matet përmes vlerësimit të variancës, ashtu edhe nga gabimi që nuk ka të bëjë me kampionin nga të gjitha burimet e tjera, si për shembull gabimet në përgjigje dhe gabime të tjera në matje, gabimet në kodifikim dhe në hedhjen e të dhënave. Gabimi në marrjen e kampionit është në proporcion të kundërt me rrënjën katrore të madhësisë së kampionit. Në anën tjetër, gabimi që nuk ka të bëjë me kampionin mund të rritet me madhësinë e kampionit, sepse cilësia e një procesi më të madh është më e vështirë të kontrollohet. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që madhësia e përgjithshme e kampionit të jetë e menaxhueshme për qëllime të cilësisë dhe kontrollit operacional. Madhësia e kampionit varet gjithashtu nga kostoja dhe çështjet logjistike që lidhen me organizimin e ekipeve të anketuesëve dhe ngarkesën e punës për mbledhjen e të dhënave. Sipas përlogaritjeve tona, madhësia e kampionit është 437 individë me aftësi të kufizuara të rënda.

Tabela 3. Zonat e vlerësimit (qarku).

Zonat	Qarku
1	Berat
2	Dibër
3	Durrës
4	Elbasan
5	Fier
6	Gjirokastrë
7	Korçë
8	Kukës
9	Lezhë
10	Shkodër
11	Tirana
12	Vlorë

Tabela 4. Madhësia e kampionit sipas qarkut.

Qarku	Madhësia e kampionit sipas qarqeve
Berat	30
Dibër	28
Durrës	58
Elbasan	36
Fier	76
Gjirokastrë	11
Korçë	37
Kukës	25
Lezhë	17
Shkodër	23
Tirana	72
Vlorë	24
Gjithsej	437

Kur përdoret kampionimi me disa faza, efekti probabilitar mat kryesisht ndikimin e nivelit të grupimit në efikasitetin e përzgjedhjes së kampionit. Efekti probabilitar varet nga numri i individëve kampionë të përzgjedhur për çdo shtresë. Madhësia e kampionit për një shtresë urbane dhe rurale në një prefekturë të caktuar i është alokuar proporcionalisht numrit të personave me aftësi të kufizuara të rënda në secilën shtresë. Tabela 4 tregon numrin e individëve për çdo shtresë të prefekturave në bazë të madhësisë së kampionit të përshkruar më sipër.

3.4 Procedurat e përzgjedhjes së kampionit

Procedura e zgjedhjes së kampionit për anketën është bazuar në një dizajn të shtresuar në dy faza të kampionit. Në fazën e parë të kampionimit, PSU/ZR-të janë përzgjedhur në mënyrë sistematike (PPS- Probability Proportional to Size) brenda çdo niveli (qarku, urbane/rurale) bazuar në madhësinë e numrit të emigrantëve.

Para fazës së parë së kampionimit, zgjedhja e kampionit për çdo ZC brenda çdo niveli u specifikua gjeografikisht në mënyrë që të sigurojë një nënndarje të tillë që kampioni të jetë përfaqësues për çdo qarku.

Kemi përdorur softuerin SAS për të përzgjedhur sistematikisht ZR-të me PPS brenda çdo shtrese, në fazën e parë të përzgjedhjes së kampionit. Ky program gjeneroi një skedar përfundimtar që përfshin probabilitetin e përzgjedhjes së fazës së parë për çdo ZR.

Faza e dytë e përzgjedhjes janë familjes e renditura nga ZR-të e përzgjedhura. Në Tabelën 5 paraqitet numri mesatar i familjeve për ZR dhe numri mesatar i personave për familje, sipas qarkut dhe ndarjes urbane/rurale sipas Censurit 2011. Në nivel kombëtar, numri mesatar i familjeve për ZR është 61. ZR-të urbane kanë mesatarisht 77 familje, ndërsa ZR-të rurale kanë mesatarisht 48 familje. Megjithatë, familjet janë më të shpërndara në ZR-të rurale, ndaj dhe ato zakonisht mbulojnë një zonë më të madhe krahasuar me ato urbane. Numri mesatar i personave për familje është 3,8 në nivel kombëtar; madhësia mesatare e familjes është 3,6 persona në zonën urbane dhe 4,1 në zonën rurale.

Tabela 5. Numri mesatar i familjeve për ZR dhe numri mesatar i personave për familje sipas qarkut dhe zonës urbane/rurale, sipas Census 2011 në Shqipëri.

Qarku	Gjithsej		Urbane		Rurale	
	Numri mesatar i familjeve për ZR	Numri mesatar i personave për familje	Numri mesatar i familjeve për ZR	Numri mesatar i personave për familje	Numri mesatar i familjeve për ZR	Numri mesatar i personave për familje
Berat	58	3.7	84	3.4	45	4
Dibër	56	4.6	87	4.1	49	4.8
Durrës	64	3.9	66	3.8	57	4.2
Elbasan	60	4	84	3.6	49	4.3
Fier	58	3.8	78	3.5	48	4
Gjirokastrë	42	3.4	77	3.3	28	3.4
Korçë	53	3.6	82	3.3	42	3.9
Kukës	54	5	86	4.5	44	5.2
Lezhë	62	4.1	72	4	53	4.3
Shkodër	61	3.9	82	3.6	50	4.1
Tirana	76	3.7	84	3.6	60	4.2
Vlorë	53	3.4	58	3.4	45	3.4
Albania	61	3.8	77	3.6	48	4.1

Lista e personave të renditur në Census për secilën familje të përzgjedhur të kampionit në hapin e dytë do të përdoret si bazë për zgjedhjen e individëve. Personat të cilët kanë vështirësi në dëgjim në shkallën “Nuk mundem fare”, pra janë të pamundur të realizojnë aktivitetin në fjalë dhe janë mbi 18 vjeç janë grupet e synuara për intervistën në terren.

3.5 Procesi i vlerësimit

Vlerësimi i duhur i të dhënave të vrojtimit është i rëndësishëm për të garantuar përfaqësimin e të dhënave të tij dhe për të parandaluar njëanësinë e shkaktuar nga mospërgjigjet. Të gjitha analizat e bazuara në të dhënat vrojtimi duhet të zbatojnë siç duhet vlerësimin e kampionit për të garantuar vlefshmërinë e gjetjeve të vrojtimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për një vrojtim kompleks. Në një vrojtim kompleks, çdo individ ka një mundësi të veçantë (e njohur si probabiliteti i përfshirjes) që të përzgjidhet në këtë kampion. Përgjigjet e tij/saj duhet të vlerësohen siç duhet (kryesisht, sipas probabilitetit reciprok të përfshirjes së tij/saj) në mënyrë që të jenë përfaqësuese. Për shembull, nëse në një kampion do të përzgjidhej një individ i caktuar me një probabilitet 0,001, atëherë ai/ajo përfaqëson 1000 individë të ngjashëm në popullsinë bazë. Rrjedhimisht, për të qenë përfaqësuese, përgjigjet e tij/saj për të gjitha pyetjet duhet të shumëzohen me 1000. Nëse përzgjidhet një individ tjetër i caktuar me probabilitet 0,002, atëherë

ai/ajo përfaqëson 500 individë të ngjashëm në popullsinë bazë, dhe rrjedhimisht do të vlerësohet me 500. Përfaqësim do të thotë të jesh në gjendje ta zgjerosh kampionin në popullsinë bazë. Meqenëse kampionet zgjidhen në mënyrë të pavarur në çdo zonë të vrojtimit, ato përfaqësojnë zonat e tyre përkatëse, nëse ato janë vlerësuar siç duhet. Nëse çdo kampion individual është përfaqësues i zonës së tij, atëherë i gjithë kampioni për vendin në tërësi përfaqëson vendin. Rrjedhimisht, studimi me kampion aftësinë e kufizuar në dëgjim përfaqëson vendin të tërësi. Vlerësimet e kampioneve nevojiten për të siguruar përfaqësimin real të kampionit në nivel kombëtar. (Për detaje të mëtejshme shih Shtojcën 3.)

3.6 Historiku demografik

3.6.1 Matja e aftësisë së kufizuar

Është shumë e vështirë për të matur aftësinë e kufizuar, sepse aftësia e kufizuar nuk është një atribut që mund të identifikohet shpejt si gjinia ose mosha, por është një ndërveprim kompleks dhe dinamik ndërmjet gjendjes shëndetësore të një personi dhe mjedisit fizik dhe social. Në studimet e aplikuara për aftësinë e kufizuar përgjithësisht janë përdorur pyetjet rreth aftësisë së kufizuar në censusin e popullsisë: shkalla e dëmtimeve, shkalla e kufizimeve në kryerjen e funksioneve dhe shkalla e kufizimeve në kryerjen e aktiviteteve. Vlerësimi i problemit nga aftësia e kufizuar fokusohet në praninë e dëmtimeve të lindura tek individi. Për shembull, individët mund të pyeten rreth dëmtimeve që mund të përfshijnë mungesën e shikimit, mungesën e dëgjimit, aftësinë e kufizuar intelektuale, problemin në të folur dhe belbëzimin, paralizën e plotë ose parciale. Këto vlerësime janë përdorur gjerësisht në të shkuarën. Më së fundmi, shkalla e kufizimeve në kryerjen e funksioneve fokusohet në kufizime të përjetuara me funksione të caktuara të trupit, si shikimi, ecja, dëgjimi, të folurit, ngjitja e shkallëve, ngritja ose mbajtja e peshave, pavarësisht nëse individi ka një dëmtim apo jo. Si përfundim, shkalla e kufizimeve në kryerjen e aktiviteteve fokusohet në kufizimet në kryerjen e aktiviteteve të jetës së përditshme, si larja ose të veshurit. Kufizimet në kryerjen e aktiviteteve mund të përfshijnë gjithashtu kufizimet në pjesëmarrje në aktivitete kryesore të jetës, si p.sh. dalja jashtë shtëpisë, vajtja në punë ose kryerja e punëve të shtëpisë për personat në moshë pune dhe vajtja në shkollë ose lojërat për fëmijët.

Vlerësimi i përgjithshëm i Grupit të Uashingtonit (WG) për aftësinë e kufizuar

Në raportin *“Profili i personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri”* (Ferré, Galanxhi dhe Dhono, 2015) është përdorur vlerësimi i dytë i aftësisë së kufizuar, d.m.th kufizimet funksionale. Vlerësimi i përgjithshëm i Grupit të Uashingtonit (WG) për aftësinë e kufizuar identifikon personat që janë në rrezik më të lartë sesa pjesa tjetër e popullsisë, për t’u përballur me kufizime në kryerjen e detyrave (si p.sh. aktivitete të jetës së përditshme) ose në integrimin në role të ndryshme (si, p.sh. të punuarit). Vlerësimet që kanë për qëllim identifikimin e kësaj popullsie “në rrezik” përbëjnë skajin më elementar të spektrit të aktiviteteve (d.m.th. aktivitete funksionale si ecja, kujtesa, shikimi, dëgjimi). Ky grup “në rrezik” përfshin personat me kufizime në kryerjen e aktiviteteve bazë, personat që mund ose mund të mos përballen me kufizime në aktivitete më komplekse dhe/ose kufizime në pjesëmarrje, në varësi deri diku nga fakti nëse përdorin pajisje ndih-mëse apo jo, nëse kanë mjedis mbështetës ose nëse kanë burime të shumta.

Grupi i Uashingtonit ka hartuar një grup pyetjesh për t'u përdorur në censuset kombëtare për mbledhjen e informacioneve rreth kufizimeve në kryerjen e aktiviteteve bazë në popullsitë e ndryshme të vendit. Pyetjet janë ideuar për të siguruar të dhëna të krahasueshme në nivel kombëtar për popullsitë që jetojnë në një shumëllojshmëri të madhe kulturash me burime të ndryshme ekonomike. Objektivi është të identifikohen personat me lloje dhe nivele të ngjashme kufizimesh në kryerjen e aktiviteteve bazë, pavarësisht nga kombësia ose kultura. Ai nuk është hartuar për të identifikuar çdo person me një aftësi të kufizuar brenda çdo komuniteti dhe as nuk duhet konsideruar si një zëvendësues për popullsitë e vlerësuara përmes një game më të gjerë fushash që do të ishin të mundura në forma të tjera të mbledhjes së të dhënave ose në të dhëna administrative.

Për qëllime thjeshtësie, saktësie dhe krahasimi, zgjedhja është bërë për të identifikuar kufizimet në gjashtë fusha të kryerjes së aktiviteteve bazë që janë universale, që janë të lidhura më ngushtë me përjashtimin social dhe që ndodhin më shpesh. Informacioni që del nga përdorimi i këtyre pyetjeve pritet (i) të tregojë shumicën, por jo të gjithë personat me kufizime në kryerjen e aktiviteteve bazë në secilin prej vendeve; (ii) të tregojë kufizimet që ndodhin më shpesh në kryerjen e aktiviteteve bazë brenda çdo vendi dhe (iii) të mbulojë personat me probleme të ngjashme ndërmjet vendeve të ndryshme.

Të dhënat

Puna analitike për profilizimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe veçanërisht për personat me probleme në dëgjim, është kryer duke përdorur Censusin 2011, vlerësimin e përgjithshëm të Grupit të Uashingtonit (WG) për aftësinë e kufizuar dhe studimin e dedikuar të kryer nga ANAD.

3.6.2 Struktura e popullsisë gjithsej dhe e personave që nuk dëgjojnë

Censusi i Popullsisë dhe Banesave i vitit 2011 tregon se popullsia banuese shqiptare ka rënë me 8,8 për qind që nga Censusi i mëparshëm i vitit 2001 dhe me 12,0 për qind që nga Censusi i vitit 1989. Kjo rënie e numrit të popullsisë ka ardhur kryesisht si pasojë e emigracionit, i cili ka vazhduar të jetë shumë i pranishëm që prej vitit 1990. Numri i lindjeve ka rënë ndjeshëm, nga 82 000 në vitin 1990, 53 000 në vitin 2001 në 36 000 në vitin 2013, e cila përbën një ulje me 32 për qind. Që prej vitit 2001, Indeksi Sintetik i Fekonditetit ka pësuar rënie të vazhdueshme. Në vitin 2001, ISF-ja ishte mbi nivelin e zëvendësimit, në 2,31 fëmijë për çdo një grua në moshën e riprodhimit. Numri i vdekjeve është relativisht i qëndrueshëm në rreth 20 000 në vit. Rënia e rritjes natyrale të popullsisë i atribuohet kryesisht rënies së numrit të lindjeve.

Ndërkohë që rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë janë procese që shtrihen përgjatë disa dekadave, emigracioni ndërkombëtar ka filluar të ndodhë vetëm që prej fillimit të viteve 1990. Emigracioni, sipas përlllogaritjeve me metodat indirekte, gjatë periudhës 2001-2011 (periudha ndërmjet dy censuseve të fundit) është vlerësuar të jetë rreth 480 000 persona. Duke iu referuar përlllogaritjeve indirekte lidhur me numrin e emigrantëve (piramida e popullsisë së emigrantëve 2001-2011), burrat ende priren më shumë se sa gratë që të emigrojnë, por ndryshimet gjinore kanë rënë ndjeshëm nëse krahasojmë të dhënat e dy censuseve të fundit (1989-2001 dhe 2001-2011). Ky fenomen pasqyron bashkimin e familjeve gjatë dekadës së dytë të periudhës së tranzicionit në Shqipëri.

Ky fenomen në popullsinë shqiptare pasqyrohet në piramidën e popullsisë (Figura 4). Baza e piramidës tregon rënien e numrit të lindjeve dhe nivelit të lindshmërisë. Hende-ku në piramidë tregon emigrimin kryesisht të të rinjve. Më poshtë paraqiten piramidat e popullsisë shqiptare dhe personave që nuk dëgjojnë.




Figura 4. Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës, Census 2011.

Sipas vlerësimit të emigracionit, Censusi nuk siguron informacione rreth emigrantëve me aftësi të kufizuara në përgjithësi, ose rreth atyre me probleme dëgjimi. Për qëllime të këtij studimi, prezumohet se numri i personave që nuk dëgjojnë që kanë emigruar është shumë i ulët.

Nëse shikojmë piramidën e personave të cilët sipas Censurit kanë deklaruar “Shumë vështirësi” dhe “Nuk mundem fare” në lidhje me dëgjimin, prevalenca e aftësisë së kufizuar në dëgjim lidhet shumë me moshën, ku grupet më të moshuara janë më të prekura nga kjo vështirësi.⁶




Figura 5. Popullsia banuese 15 vjeç e lart sipas gjinisë, grupmoshës dhe shkallës së aftësisë së kufizuar në dëgjim, Censusi i Popullsisë i vitit 2011.

⁶ Kjo mund të shpjegohet nga fakti që në të gjithë popullsinë, përafërsisht një e treta e personave mbi 65 vjeç preken nga humbja e dëgjimit. (OBSh 2012). (Ed.)

Megjithatë, studimi paraqet rezultate të ndryshme. Kjo lidhet me rrjetin e ANAD-it (lista e personave në kampion). Diçka tjetër që mund të shpjegojmë përmes kësaj është shpërndarja shumë e ndryshme e personave që nuk dëgjojnë në grupin e kampionit në krahasim me Censusin, i cili mbuloi të gjithë popullsinë që nuk dëgjon. Nëse shohim piramidën e personave që nuk dëgjojnë të intervistuar në kuadrin e anketimit, shumica e tyre i përkasin grupmoshës 45-49 vjeç.⁷




Figura 6. Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës, personat që nuk dëgjojnë sipas vrojtimit.

Ky dallim bëhet edhe më i qartë kur krahasojmë moshën mesatare të popullsisë gjithsej dhe të personave me aftësi të kufizuara sipas Censurit, me atë të personave që nuk dëgjojnë sipas studimit (Tabela 6).

Tabela 6. Moshë mesatare e popullsisë në total, personave me aftësi të kufizuara dhe personave që nuk dëgjojnë.

	Moshë mesatare
Popullsia në total	35,5
Personat me aftësi të kufizuara	62,2
Personat që nuk dëgjojnë sipas studimit	40,5

Moshë mesatare e personave që nuk dëgjojnë sipas studimit është 40,5 vjeç, në krahasim me 62,2 vjeç sipas Censurit.

⁷ Një shpjegim hipotetik në lidhje me numrin e pazakontë të përfaqësuesve në këtë grupmoshë mund të jetë ndonjë epidemi ose pandemi e rubeolës, fruthit, meningjtit edhe citomegalovirusit (shih Cohen, Durstenfeld dhe Roehm 2014) që mund të kenë prekur popullsinë shqiptare menjëherë përpara ose gjatë vitit 1969. Sipas vërejtjeve të Cohen dhe të studiuesve të tjerë në vitin 2014, përpara kryerjes së vaksinimit në masë, fruthi do të infektonte, për shembull, më shumë se 90% të fëmijëve të prirur ndaj epidemive. Për shembull, përpara kryerjes së vaksinimit, mendohej se fruthi ishte shkaku i humbjes së dëgjimit të shkallës së rëndë dhe të thellë në 4% deri në 9% të pacientëve që nuk dëgjojnë (Suboti, 1976). Megjithatë, kjo hipotezë nga epidemia mbetet e pavërtetuar për momentin. Studiuesit e këtij studimi nuk kanë pasur akses në informacionin për shëndetin publik dhe epidemitë në Shqipëri në vitet 1960. Megjithatë, në studimet e ardhshme, kjo mundësi nuk duhet të anashkalohej por të verifikohet, sepse 61% e të anketuarve deklarojnë se kanë humbur dëgjimin për shkak të ndonjë sëmundjeje apo lëndimi (vetëm 2% për shkak të ndonjë sëmundjeje të nënës gjatë shtatzënisë). Gjithashtu, një rast i ngjashëm është vënë në dukje nga Divizioni i Shëndetit Publik në Oregon (2013): Në vitin 1941, gjatë praktikës së tij, një okulist Australian vuri re një numër të pazakontë fëmijësh me katarakt. Ai dyshoi se bëhej fjalë për rubeolën, por vetëm pas disa vitesh të tjera mungese vëmendje dhe skepticizmi, epidemiologët dhe teratologët konfirmuan sindromën kongjenitale të rubeolës (CRS), e cila shkakton tre sëmundjet, kataraktin kongjenital, sëmundjet e zemrës dhe humbjen e dëgjimit (Reef dhe Plotkin 2013). (Ed.)

Gjendja civile

Më shumë se gjysma e personave madhorë që nuk dëgjojnë të identifikuar në Censusin e Popullsisë dhe Banesave, 2011 dhe në këtë studim janë të martuar. Megjithatë, sipas Censurit, përqindja e personave të martuar që nuk dëgjojnë është 54,5% ndërsa sipas studimit, përqindja është 67,3%. Figura 7 tregon një diferencë të madhe në grupin e personave të ve: sipas Censurit, ky grup përbën 33,8% ndërsa sipas studimit, ky grup përbën vetëm 1,3%.⁸ Diferencat në karakteristikat demografike kërkojnë një tjetër studim për të marrë informacion më të thelluar.




Figura 7. Personat që nuk dëgjojnë sipas gjendjes civile.

⁸ Siç u theksua më parë, sipas OBSH-së (2012), një e treta e personave mbi 65 vjeç vuan nga humbja e dëgjimit. Sërish, këto ndryshime në gjendjen civile mund të shpjegohen nga fakti se shifrat e marra nga censusi kombëtar përfshijnë një numër të madh personash që e kanë humbur dëgjimin në moshë më të vonë. Për këtë arsye, natyrisht që do të kemi më shumë persona të ve në këtë grup krahasuar me grupin e kampionit në këtë studim ku moshë mesatare është 20 vjeç e më pak (shih Tabelën 7). (Ed.)

Ekstraktet nga raportet e punës në terren

Përkthimi nga gjuha shqipe e shenjave në anglisht

20–25 janar 2015

Intervistat u kryen në shoqatën ANAD. Punuam në tre grupe në tre zyra. Intervistat u kryen si në vijim: dy anëtarë të stafit tonë kryen intervistën me personin që nuk dëgjon, njëri prej tyre shkruante në kompjuter ndërsa tjetri bënte pyetjet. E ndamë punën në tre grupe në mënyrë që të mbaronim sa më shpejt të ishte e mundur. Në total intervistua 65 persona, meshkuj dhe femra të moshave të ndryshme. -- Komuniteti i personave që nuk dëgjojnë e kuptoi rëndësinë e këtyre intervistave të cilat do të shërbejnë për të përmirësuar jetët e tyre në të ardhmen. Në fakt, u intervistuan 63 persona nga Tirana, ndërsa dy të rinjtë e tjerë erdhën nga Durrësi dhe nga Lushnja. Ata kishin ardhur rastësisht në Tiranë dhe kryen intervistën.

Valmira Ardullaj

29 janar 2015

Unë dhe Klisman Ibrahim shkuam në Shkodër për të kryer intervistat me personat që nuk dëgjojnë. Intervistua dy persona, një djalë dhe një vajzë. Unë dhe Klismani kryem intervistën e parë me djalin. Ne nuk patëm mundësi ta intervistonim vajzën sepse bashkëshorti i saj nuk ishte dakord. I kërkua Ilirjana Jupas që të kryente intervistën.

Eduard Ajas

30–31 janar 2015

Unë dhe Ilirjana Jupa shkuam në Lezhë për të kryer intervistat. Intervistua 10 persona që nuk dëgjojnë, 7 meshkuj dhe 3 femra. Tre prej tyre jetonin në qytet, ndërsa shtatë të tjerët nëpër fshatra. Për të shkuar nëpër fshatra që të kryenim intervistat, një person që nuk dëgjon na shoqëroi me makinë e tij, të cilin i paguam karburantin. Dy nga personat që kishim planifikuar të intervistonim ishin shpërngulur dhe jetonin në Tiranë. Një person tjetër ishte larguar për në Itali. Ishte edhe një person tjetër i moshuar, të cilin shkuam ta takonim dy herë, por shtëpia ishte e mbyllur dhe nuk arritëm ta takonim. Në përgjithësi intervistat shkuan mirë, por patëm disa probleme të tilla si për shembull: Në një nga familjet që shkuam për

të intervistuar një vajzë, prindërit e saj ishin të shqetësuar se kush do të kujdesej për vajzën pas vdekjes së tyre. Ata kërkojnë ndihmë nga shteti për t'u kujdesur për të.

Në Lezhë u përballëm me pengesa të tjera. Një vajzë që do të intervistonim i kërkoi leje bashkëshortit të saj që punonte në Itali, por ai nuk e lejoi që ta merrnim në intervistë. E respektuam opinionin e saj dhe u larguam. -- Në një familje tjetër në Lezhë ku jetonin dy persona që nuk dëgjojnë, u përpoqëm t'ia shpjegonim babait të tyre qëllimin e intervistës. Nëse nuk do t'i kishim pasur të gjitha informacionet me vete, do të kishte qenë e vështirë t'ia shpjegonim.

Në një rast tjetër, një person që nuk dëgjon ishte martuar me një grua që dëgjon. Vëllai, i cili mund të dëgjonte, na pyeti se pse një shoqatë e tillë kryente intervista kur shteti nuk siguronte asnjë lloj ndihme për këta njerëz. Për të, kjo nuk kishte asnjë kuptim. Ne ia shpjeguam rolin e shoqatës dhe detyrën e saj për të ndihmuar komunitetin e personave që nuk dëgjojnë dhe të drejtat e tyre. I treguam arsyen se pse po kryeshin intervistat, për t'u njohur me nevojat e personave që nuk dëgjojnë dhe për t'ia përcjellë shtetit këtë informacion në mënyrë që jetët e tyre të përmirësohen. Përsëri ai nuk ishte dakord dhe ne i thamë se personat që nuk dëgjojnë mund të vendosnin vetë nëse do të intervistoheshin ose jo. Unë i kërkova që të mos e diskriminonte vëllanë e tij. Në atë moment erdhi babi i tyre dhe pranoi që intervista të kryhej.

Eduard Ajas

*Raporti i intervistave të datës 1 shkurt 2015
në veri të vendit, në një fshat të thellë të Shkodrës.*

Unë shkova me Klisman Ibrahim për të kryer intervistat me personat që nuk dëgjojnë. Në mëngjes, u nisëm nga qendra e Shkodrës drejt një fshati të thellë të quajtur Hani i Hotit në kufi me Malin e Zi. Nuk arritëm ta takonim të moshuarin që nuk dëgjon, kështu që na shoqëroi një person tjetër, i cili e njihnte shumë mirë zonën. Më 1 shkurt shkuam në fshatin Hani i Hotit. Rruga ishte e gjatë dhe na u desh të ecnim që të mbërrinim atje. Gjetëm një person që nuk dëgjon dhe një çift të moshuarish në shtëpinë ku shkuam.

Intervista me ta ishte e vështirë sepse ata nuk e njihnin gjuhën e shenjave dhe njihnin shumë pak germa nga alfabeti me forma dore. Shumicën e kohës, ata komunikojnë me shikim. Ata menduan se ne kishim shkuar atje për t'i ndihmuar me ushqime apo me ndonjë pension. Ata nuk na kuptuan 100%, edhe pse ne bëmë më të mirën e mundshme. Në shtëpinë tjetër, takuam një vajzë analfabete që nuk dëgjonte dhe me sa dukej ajo kishte edhe probleme të shëndetit mendor. Ajo nuk fliste fare dhe nuk kishte përfituar kurrë asgjë në jetën e saj, as punë e as pension pas një moshe të caktuar. Prindërit e saj ishin të moshuar. Shtëpia e tyre ishte ngjitur me shtëpinë e çiftit që kishim intervistuar më parë. Intervistuar prindërit e vajzës dhe ata ishin të shqetësuar se çfarë do të ndodhte me vajzën pas vdekjes së tyre. Ata mendonin se do të ishte më mirë ta dërgonin vajzën në ndonjë azil me njerëz të tjerë sepse, përveç se nuk dëgjonte, vajza vuante edhe nga çrregullime mendore. Vajza ishte njeri i mirë dhe i qetë. Problemi qëndronte se si do të jetonte vajza në të ardhmen kur prindërit e saj të mos jetonin më. Shteti duhet të bëjë diçka për ta ndihmuar atë.

Valmira Ardullaj

6 shkurt 2015

Unë dhe Irena Oruçaj punuam së bashku për kryerjen e intervistave me personat që nuk dëgjojnë. Intervistuar 5 persona dhe intervistën e parë e kryem në një fshat pranë qytetit të Fierit. Në fillim intervistuar një grua që nuk dëgjonte, bashkëshortin e saj që nuk dëgjonte dhe vëllanë e saj që nuk dëgjonte dhe nuk shikonte. Ishte çudi që vajza nuk dëshiroi të intervistohet, por ne e respektuam zgjedhjen e saj. Ishin edhe dy persona të tjerë që nuk dëgjonin dhe nuk shikonin, të cilët nuk mundëm t'i intervistonim. Vendorsëm që t'i intervistonim një herë tjetër, ndërsa gruan e intervistuar. Intervistuar F. dhe A., të cilët nuk dëgjonin, por u përballëm me disa vështirësi në komunikim sepse A. vuante nga disa çrregullime mendore. Kështu që na u desh të komunikojmë me të përmes gjesteve, sepse kjo ishte e vetmja mënyrë që ai kishte komunikuar gjatë gjithë jetës së tij. Ai kishte punuar si këpucar, por asnjëherë nuk kishte arritur të komunikonte me familjen e tij. Megjithatë, intervista u krye me sukses dhe më erdhi shumë mirë për këtë gjë. Në qendër të Fierit, intervistuar edhe dy persona të tjerë, një burrë dhe bashkëshorten e tij K. Procesi i intervistave u krye me sukses dhe arritëm të intervistonim pesë persona, por nuk arritëm të intervistonim dy vëllezërit që nuk dëgjonin dhe nuk shikonin.

Denis Ploça

7 - 8 shkurt 2015

Do t'ju raportoj për procesin e intervistave në rrethin e Fierit më 7 dhe 8 shkurt 2015. Unë, Denis Ploça dhe një person që nuk dëgjon, i cili na ndihmoi të gjenim adresat e personave që nuk dëgjojnë, shkua në Patos dhe Libofshë. Intervistuar 10 persona, 5 meshkuj dhe 5 femra. Gjatë intervistave u përballëm me disa probleme:

Intervista me dy vëllezërit që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. Koordinatorin ynë, Florjan Rojba, nguli këmbë që ta kryenim këtë intervistë, pavarësisht kushteve të tyre. I kërkova leje familjes për të kryer intervistën me vëllezërit që nuk dëgjonin dhe nuk shikonin, si dhe me bashkëshorten e njërit prej tyre e cila nuk dëgjonte, por mund të shikonte. Çifti kishin një vajzë në moshë madhore e cila mund të dëgjonte. Në fillim familja nuk pranoi të intervistoheshin, duke thënë se nuk dëshironin që intervistat të publikoheshin në televizor dhe në media. Ne u shpjeguam se ishim përfaqësues të ANAD-it dhe se këto intervista po kryheshin në bashkëpunim me INSTAT-in dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, dhe se i gjithë informacioni do të ishte konfidencial. Pasi ata ranë dakord, ne i kryem intervistat. Komunikimi ishte i vështirë sepse ata nuk shikonin por unë, me përvojën time të gjatë, arrita të komunikoj me ta përmes daktilimit në pëllëmbën e dorës dhe shenjave me prekje. Më pas, bashkëshortja që nuk dëgjonte na tregoi për situatën e tyre të vështirë. Ajo po kërkonte punë dhe kishte kërkuar ndihmë nga shteti për bashkëshortin dhe kuintin e saj. Ata qëndronin në shtëpi sepse e kishin të pamundur të punonin. Situata ishte shumë e vështirë. Shtëpia e tyre ishte e vjetër dhe çatia pikonte. Ata nuk kishin marrë asnjë ndihmë nga shteti për kushtet e tyre të jetesës.

Intervistën tjetër e kryem në zonat e thella të Libofshës, ku intervistuar një çift të martuar. Ata kishin 3 djem dhe më i vogli (8 vjeç) ishte i verbër. Ata kishin kërkuar ndihmë nga shteti për shkak të situatës së tyre. Në Fier dhe Patos, personat që nuk dëgjonin nuk kishin probleme serioze. I mbajtëm shënim çdo gjë që na thanë.

Eduard Ajas

8 shkurt 2015

Unë dhe Jetmir Dekovi shkua të kryenim intervistat në fshatin e Levanit, Fier. Intervistuar 6 persona në total, 2 ishin femra dhe 4 meshkuj. Vajza e parë që intervistuar kishte ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë. Në fillim ajo ishte e ndrojtur dhe nuk komunikonte lirshëm me ne. Ajo komunikonte vetëm me gjeste sepse nuk njihnte as daktilim as shenja. E patëm shumë të vështirë dhe na u desh të përsërisnim disa herë të njëjtën pyetje. Gjithashtu, i kërkua edhe nënës së saj të na

ndihmonte gjatë komunikimit. Vajza tjetër që intervistua nuk kishte qenë asnjëherë në Institut dhe nuk e njihje as alfabetin me forma dore dhe as gjuhën e shenjave. Komunikua me gjeste, çka rezultoi shumë e vështirë me të. I intervistuari tjetër ishte një djalë që kishte ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, por përsëri intervista u krye me gjeste dhe duke artikuluar pa zë fjalët në shqip. Komunikimi me të ishte shumë i vështirë dhe na u desh t'i përsërisim disa herë pyetjet. Për këtë arsye, na u desh shumë kohë të kryenim këtë intervistë. Këto ishin të gjitha intervistat e kryera.

Irena Oruçaj

Më 11 shkurt 2015

Unë dhe Eduard Ajas shkuam në Gjirokastrë. U shoqëruam nga një person nga komuniteti lokal i personave që nuk dëgjojnë, i cili kishte të gjitha kontaktet e nevojshme. Gjatë ditës, intervistua 10 persona që nuk dëgjojnë, prej të cilëve 5 meshkuj dhe 5 femra. Ndërkohë, u përpoqëm të intervistonim dy persona të tjerë që nuk dëgjonin, por ata nuk erdhën.

Një nga personat e intervistuar, i lindur në Shqipëri, kishte shkuar të jetonte me familjen e tij në Greqi, ku ishte rritur dhe kishte përfunduar studimet. Tani, ai ishte kthyer në Gjirokastrë dhe ishte bërë --. E kishim të pamundur të komunikim me të në gjuhën shqipe, por arritëm të komunikim me gjeste. Patëm fat që e takuam. Intervistën e drejtoi Eduard, ndërsa unë mbajta shënime. Ai nuk e njihje gjuhën apo ndonjë shenjë të gjuhës shqipe, por vetëm gjuhën e shkruar greke. Ai nuk e njihje as gjuhën e shenjave ndërkombëtare dhe as gjuhën angleze të shkruar. Eduardi komunikoi me të vetëm përmes gjesteve. Ai u informua për herë të parë lidhur me situatën e personave që nuk dëgjojnë, që kishte edhe persona të tjerë që nuk dëgjojnë; që ekzistonte një shkollë, një shoqatë, etj. Për shkak të mungesës së informacionit në media, ai shprehu dëshirën dhe nevojën të kishte më shumë informacion.

Valmira Ardullaj

12 shkurt 2015

Unë dhe Denis Plloça shkuam në Lushnjë për të kryer intervistat. Intervistua 8 persona që nuk dëgjojnë, 2 femra dhe 6 meshkuj. Intervista me vajzën e parë ishte shumë e suksesshme. Komunikua përmes daktilimit që ajo e kishte mësuar në shkollë. Ajo i kuptoi të gjitha pyetjet, çka ishte diçka shumë pozitive. Intervista e dytë u krye me një grua, e cila komunikonte vetëm përmes daktilimit. Edhe ajo i kuptoi të gjitha pyetjet.

Nga të gjashtë burrat e intervistuar, dy ishin më të moshuar. Intervistat me personin e parë dhe të dytë u kryen kryesisht përmes daktilimit dhe më pak përmes shenjave. I pari

nga burrat e tjerë më të rinj në moshë, edhe pse ishte diplomuar në shkollë, e pati të vështirë të na kuptonte. U detyruam të përdornim të gjitha metodat e mundshme të komunikimit; alfabetin me forma dore, shenjat, gjestet. Përdorëm disa lloje sinonimesh dhe figura me forma në ajër për të formuar shembuj të koncepteve, në mënyrë që të lehtësonim komunikimin. Intervista me të ishte disi e vështirë.

As personi i dytë që intervistua nuk e kuptonte mirë gjuhën e shenjave, megjithatë intervista pati sukses. Intervista me personin e tretë ishte shumë e mirë; ai i kuptoi pyetjet sepse e njihje shumë mirë gjuhën e shenjave. Intervista me personin e katërt u krye duke përdorur alfabetin me forma dore, sepse ai njihje vetëm atë formë komunikimi.

Irena Oruçaj

13 shkurt 2015

Po ju raportoj për intervistat e kryera më 13 shkurt 2015. Unë dhe Irena Oruçaj shkuam në Lushnjë për të kryer intervistat. Intervistua në total dhjetë persona që nuk dëgjonin, prej të cilëve 8 meshkuj dhe 2 femra. Intervistat u kryen si më poshtë:

Komunikimi me personin e parë që nuk dëgjonte nuk ishte i vështirë, kështu që intervista pati shumë sukses. Nga të tre personat e tjerë të intervistuar, dy prej tyre ishin çift dhe intervista shkoi shumë mirë. Personi i tretë ishte vëllai i bashkëshortit që kishim intervistuar më parë, një person që nuk dëgjonte i cili ishte edhe me aftësi të kufizuara. Ai kishte probleme me gishtërinjtë dhe për këtë arsye, pavarësisht gjithë përpjekjeve tona, ishte e vështirë të kryeje intervistën. Vëllai i tij na ndihmoi duke na dhënë shumë informacione për të. Për sa i përket arsimimit, vëllai i tij na tha se ai kishte ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, por mësuesit e përjashtuan për shkak të aftësisë së tij të kufizuar, duke e diskriminuar atë. Në mungesë të arsimimit në shkollë, niveli i tij intelektual ishte tepër i ulët. Secili prej këtyre tre personave jetonte në shtëpi më vete pranë njëri-tjetrit.

Intervista me çiftin që nuk dëgjonte ishte e vështirë. Komunikimi me bashkëshortin që nuk dëgjonte ishte edhe më i vështirë, por bashkëshortja e tij, e cila kishte ndjekur shkollën, e lehtësoi komunikimin mes nesh. Intervista me bashkëshorten e tij shkoi shumë mirë. Intervista me vëllanë e tij nuk ishte e lehtë sepse ai nuk kuptonte shumë nga shenjat. Ai e kishte lënë shkollën sepse ndihej keq dhe ishte kthyer në shtëpi. Ai ishte rritur nën kujdestarinë e vëllait të tij. Të dy vëllezërit që nuk dëgjonin ishin analfabetë dhe, siç e thamë më parë, vetëm gruaja kishte ndjekur shkollën.

Intervistua edhe një person tjetër që nuk dëgjonte, por komunikimi me të ishte pothuajse i pamundur. I provuam të gjitha metodat e komunikimit, dhe në fund na ndihmoi

babai i tij në mënyrë që i biri të kuptonte pyetjet dhe ne të mund të merrnim përgjigjet. I jemi shumë mirënjohës babait të tij për kryerjen e kësaj interviste sepse do të kishte qenë e pamundur pa ndihmën e tij.

Denis Mloca

18 shkurt 2015

Unë dhe Ilirjana Jupa u shoqëruam nga një person që e njihje mirë zonën e Tropojës. Kryem 5 intervista me persona që nuk dëgjonin. Tre prej tyre ishin meshkuj dhe dy të tjerat femra. Vështirësitë që hasëm ishin:

Në një nga shtëpitë nuk kishte njeri, ndërsa te shtëpia tjetër pritëm pak kohë, por ai nuk erdhi. Personi që na shoqëroi na tha se kishte edhe persona të tjerë që nuk dëgjonin në atë zonë, por ai nuk e dinte se ku jetonin. Komunikimi me pesë personat e intervistuar që nuk dëgjonin ishte i vështirë dhe i ndryshëm. Na u desh shumë kohë për të kryer intervistat sepse shumë persona komunikonin me gjeste dhe na u desh të imitonim me duar dhe të jepnim shumë shembuj. Do të përmendja edhe disa gjëra të tjera si më poshtë:

Një çift i martuar nuk kishte shtëpi dhe ata jetonin pa leje ligjore në një shtëpi të vjetër të epokës së komunizmit. Madje, kishin dhe fëmijë.

Ata na thanë se lajmet i shihnin në Televizionin Publik Shqiptar, por nuk i kuptonin edhe aq mirë lajmet sepse ato jepeshin në gjuhën e shenjave, ndërsa ata kuptonin vetëm alfabetin daktil [daktilimin].

Jetmir Bekovi

19 shkurt 2015

Unë dhe Erkid Hatia kryem disa intervista në Pogradec dhe në fshatrat në afërsi të tij. Intervistua 8 persona në total, 4 meshkuj dhe 4 femra. Gjatë intervistave, vumë re se personat që nuk dëgjonin ishin në situatë të keqe ekonomike. Komunikimi me ta ishte i vështirë sepse ata nuk e njihnin gjuhën e shenjave.

Një problem tjetër ishte të punuarit jashtë orarit dhe distancat e largëta për të shkuar nga një vend në tjetrin. Në mëngjes, shkuam në një fshat ku intervistua dy persona, S. dhe bashkëshortin e tij. S. kishte ndjekur shkollën, ndërsa grua ja e tij jo. Ajo vinte nga qyteti. Intervista shkoi mirë në përgjithësi dhe i vetmi problem që ata kishin ishte papunësia.

Ditën e dytë, personi që na ndihmoi na tha se ishte dhe një person tjetër që nuk dëgjonte i quajtur M. Ne shkuam ta takonim. M. ishte analfabet dhe jetonte në një gjendje të keqe ekonomike. Prindërit e tij ishin të divorcuar. Ata kishin dy fëmijë, njëri prej tyre dëgjonte dhe M., i cili ishte më i madhi dhe që merrte një ndihmë ekonomike (pension) prej 10 000

lekësh. Nëna e tij ishte e papunë dhe nuk merrte pension. Ata jetonin në shtëpi me qira.

Më parë, M. kishte punuar në Greqi dhe tani ishte kthyer. Ai na tregoi për historinë e familjes së tij. Unë dhe Erkid e dëgjuam me shumë kujdes. M. ishte analfabet dhe komunikonte me gjeste. Gjatë intervistës, nëna e M. u emocionua dhe filloi të qante. E ndalua intervistën për një moment dhe shkuam ta qetësonim. Ajo na tha se kishin probleme ekonomike dhe se nuk kishin para të blinin ushqime. Unë dhe Erkid shkuam në një dyqan dhe blemë disa ushqime. Ajo u qetësua dhe na falënderoi. Më pas vazhduam me intervistën. Ata kishin probleme të mëdha sepse duhet të paguanin qiranë, faturën e energjisë elektrike dhe në fund nuk u mbeteshin para mjaftueshëm për të blerë ushqime. Të gjitha këto duhet të mbuloreshin vetëm me një pension.

Klismar Ibrahim

21 shkurt 2015

Po raportoju në lidhje me intervistat e kryera në qytetin e Fierit. Unë, bashkë me Irena Oruçaj, intervistua tre persona që nuk dëgjonin, prej të cilëve 2 meshkuj dhe 1 femër. Bëmë edhe një intervistë me një çift që nuk dëgjonte. Në fillim intervistua bashkëshortin dhe çdo gjë shkoi mirë. Ai kishte ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë. Ne komunikua me të përmes alfabetit me forma dore, por ai e kishte harruar pjesën më të madhe për shkak të mungesës së ndërveprimit me njerëz të tjerë, kështu që na u desh të punonim pak më shumë për të përfunduar të gjithë pyetësorin.

Bashkëshortja e tij që nuk dëgjonte nuk dinte si t'i përgjigjej pyetjes se pse nuk e kishte ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë. Ajo nuk kishte asnjë informacion për këtë sepse ishte analfabete dhe përpiquej të komunikonte përmes artikulimit të fjalëve pa zë. Ajo kuptonte shumë pak nga gjestet. Për të, mungesa e arsimit përbënte problem gjatë intervistës sepse nuk kishte asnjë informacion. Personi tjetër i intervistuar ishte një burrë në moshë madhore nga Levani, edhe ai analfabet. Ai kishte ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë por më pas e kishte lënë.

Komunikimi me të ishte i vështirë dhe u krye përmes artikulimit të fjalëve pa zë dhe me gjeste sepse ai nuk e njihje as alfabetin me forma dore. Për shkak të problemeve të tij fizike dhe mungesës së përqendrimit, komunikimi me të ishte edhe më i vështirë. Për shkak të moshës, ai kishte probleme edhe me shikimin. Një person që dëgjonte na ndihmoi në mënyrë që të plotësonim pyetësorin me përgjigjet e nevojshme. Megjithatë, intervista shkoi mirë.

Denis Mloca

4

REZULTATET E STUDIMIT

Päivi Rainò dhe Liisa Martikainen



4.1 Historiku demografik i të anketuarve

Sipas analizave statistikore të kryera nga INSTAT, numri i vlerësuar i individëve për t'u intervistuar në bazë të shtresave ishte përcaktuar 437 persona, me një shpërndarje gjeografike të përcaktuar (Tabelat 4, 7). Meqenëse intervistuesit nuk arritën të takonin të gjithë personat në grupin e kampionit, numri në total i të intervistuarve (434) ishte pak më pak se numri i përcaktuar si objektiv. Ndryshimet mes kampionit të përcaktuar nga INSTAT dhe madhësisë reale të kampionit, d.m.th. personat e intervistuar në çdo prefekturë, paraqiten në Tabelën 7. Grupmoshat e të intervistuarve dhe shpërndarja e tyre në prefektura paraqiten në Tabelën 8.

Tabela 7. Krahasimi i grupit të kampionit të intervistuar dhe madhësia e propozuar e grupit të kampionit nga INSTAT.

Qarku	Personat e intervistuar në grupin e kampionit		Madhësia orientuese e kampionit	
	N	%	N	%
Berat	38	9	30	7
Dibër	8	2	28	5
Durrës	32	7	58	8
Elbasan	50	12	36	11
Fier	73	17	76	14
Gjirokastrë	14	3	11	4
Korçë	48	11	37	8
Kukës	15	3	25	3
Lezhë	13	3	17	5
Shkodër	36	9	23	9
Tiranë	66	15	72	17
Vlorë	41	9	24	9
Total	434	100	437	100

Tabela 8. Shpërndarja e të intervistuarve sipas moshës dhe zonës së banimit.

Qarku / Moshë	-20	21-30	31-40	41-50	51-60	61-	Total
Berat	0	5	8	17	6	2	38
Dibër	0	0	2	5	1	0	8
Durrës	1	14	5	11	1	0	32
Elbasan	2	12	7	18	9	2	50
Fier	2	18	17	25	10	1	73
Gjirokastrë	1	1	4	3	2	3	14
Korçë	0	9	17	16	5	1	48
Kukës	0	4	2	8	1	0	15
Lezhë	0	3	3	6	1	0	13
Shkodër	1	5	5	16	5	4	36
Tiranë	7	21	17	12	8	1	66
Vlorë	1	9	8	19	4	0	41

Ashtu si në studimin në Kosovë të vitit 2010 (Shoqata e Njerëzve që nuk Dëgjojnë në Kosovë dhe Shoqata Finlandeze e Njerëzve që nuk Dëgjojnë 2010, 8-9), edhe në grupin e kampionit në Shqipëri, shumica e të anketuarve janë meshkuj (61%) dhe pak më pak se gjysma (39%) janë femra. Ka një mospërputhje me Censusin, sipas të cilit janë përafërsisht 5% më shumë gra se sa burra me humbje totale të dëgjimit. Në këtë aspekt, raporti mes pjesëmarrësve meshkuj dhe femra në kampion nuk është në përputhje me shpërndarjen demografike sipas Censurit. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht nga fakti se personat që punuan në terren jo gjithmonë u lejuan të intervistonin vajza apo gra që nuk dëgjonin. (Shih gjithashtu ekstraktet nga raportet e punës në terren.) Megjithatë, ashtu siç paraqitet në statistikat e Censurit (INSTAT 2012, 47; 90), diferencat në numrin e grave dhe burrave janë më të mëdha te grupet më të moshuara, ku gratë përbëjnë pjesën më të madhe dhe ku një e treta e popullsisë vuan nga humbja e dëgjimit për shkak të moshës.

Në këtë studim, ashtu si në Censurin e vitit 2011, pjesëmarrësve iu kërkua të përshkruanin veten (pyetja nr. 7, shih pyetësin në shtojcën 1) duke përdorur disa përkufizime të zakonshme të gjuhës “nuk dëgjoj - probleme në dëgjim - humbje dëgjimi me kalimin e moshës” ose “Dëgjoj por nuk mund të flas”. Për shkak se pjesëmarrësit ishin përzgjedhur kryesisht mes anëtarëve të ANAD-it (n=305), shumica e të anketuarve e përkufizuan veten se i përkisnin kategorisë “nuk dëgjoj” (n=412); vetëm 18 persona deklaruan se kishin “probleme në dëgjim”. Askush prej tyre nuk e klasifikoi veten në kategorinë “humbje dëgjimi me kalimin e moshës”. Megjithatë, katër (4) persona të cilët “mund të dëgjonin por nuk mund të flisnin”, supozohet se vuanin nga *disfasia*.

Meqenëse anëtarët e ANAD-it përdorin komunikimin pamor dhe gjuhën e shenjave, kjo shpjegon arsyen pse në grupin e kampionit nuk përfshihet ajo pjesë e popullsisë që e ka humbur dëgjimin në moshë më të madhe. Personat që kanë humbur dëgjimin me kalimin e moshës kanë mësuar gjuhën e folur (d.m.th shqipen) si gjuhë amtare që në fëmi-

jëri të hershme dhe kanë ndjekur një rrjedhë normale arsimimi. Kështu që ata nuk e klasifikojnë veten e tyre si minoritet gjuhësor, i cili përcaktohet nga gjuha amtare e mësuar.

Meqenëse anëtarët e ANAD-it përdorin komunikimin pamor dhe gjuhën e shenjave, kjo shpjegon arsyen pse në grupin e kampionit nuk përfshihet ajo pjesë e popullsisë që e ka humbur dëgjimin në moshë më të madhe. Personat që kanë humbur dëgjimin me kalimin e moshës kanë mësuar gjuhën e folur (d.m.th shqipen) si gjuhë amtare që në fëmijëri të hershme dhe kanë ndjekur një rrjedhë normale arsimimi. Kështu që ata nuk e klasifikojnë veten e tyre si minoritet gjuhësor, i cili përcaktohet nga gjuha amtare e mësuar.

Studimet kërkimore demografike për mungesën e dëgjimit (veçanërisht në lidhje me fëmijët) raportojnë normalisht edhe aftësi të tjera të kufizuara që shoqërojnë problemet me dëgjimin dhe mungesën e dëgjimit. Sipas Fortnum dhe Davis (1997), rastet mund të arrijnë deri në 39%. Në një shqyrtim të fundit të literaturës të kryer në Britaninë e Madhe (Shoqata Kombëtare e Fëmijëve që nuk Dëgjojnë, 2010) tregon se rreth 20% e fëmijëve që nuk dëgjojnë kanë nevojë për një formë shtesë të specializuar arsimimi. Megjithatë, sipas këtij studimi, vetëm 9% nga 427 persona që iu përgjigjen pyetjeve 12-13 deklaruan se vuanin nga një aftësi tjetër e kufizuar: 3 kishin probleme motorike, 6 kishin probleme me shikimin; 12 deklaruan se kishin aftësi të kufizuara intelektuale; 20 të anketuar u përgjigjën se kishin probleme të tjera të pacaktuara.⁹

Kur të anketuarit në këtë studim u pyetën “A ka ndonjë prej anëtarëve të familjes suaj vështirësi me dëgjimin apo që nuk dëgjon” (pyetja nr. 10), pak më shumë se gjysma (56%) deklaruan se jetojnë me bashkëshortin/en që nuk dëgjon ose me probleme në dëgjim. Tabela 9 tregon anëtarët e tjerë të familjes që nuk dëgjojnë/me vështirësi në dëgjim. Megjithatë, kategoritë mbivendosen pjesërisht; p.sh. një person mund t'i ketë të dy prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët që nuk dëgjojnë. Për më tepër, 51 prej të intervistuarve kishin (gjithashtu) të afërm të tjerë që nuk dëgjojnë (kushërinj, halla, xhaxhallarë; pyetja nr. 11) në krahasim me ata të përmendur në tabelën 9.

Në këtë studim, ka pasur një pyetje edhe për etiologjinë e problemeve me dëgjimin (pyetja nr. 9.). Vetëm 5% e të anketuarve deklaruan në këtë pikë se mungesën e dëgjimit e kishin të trashëguar nga anëtarët e tyre të afërm të familjes, çka është në përputhje me gjetjet e tjera të këtij studimi. Sipas studimeve nga Mitchell dhe Karchmer (2004) mungesa e trashëguar e dëgjimit pritet të gjendet në 5 deri 8% të popullsisë që nuk dëgjon. Shumica e të anketuarve (67%) kishin humbur dëgjimin për shkak të ndonjë lëndimi, sëmundjeje apo sëmundjeje të nënës gjatë shtatzënisë së saj. 16% deklaruan arsye të tjera, 15% nuk e dinin etiologjinë e tyre të mungesës së dëgjimit. Vetëm 2 persona kishin humbur dëgjimin/kishin probleme në dëgjim (D/HH) në mënyrë graduale.

⁹ Ka një dallim shumë të madh kur ky informacion i marrë nga vetë të anketuarit që nuk dëgjojnë krahasohet me të dhënat e siguruar nga Censusi kombëtar i vitit 2011 (Shtojka 2, Tabelat I-IV): 60% e atyre personave 15 vjeç e sipër; të cilët nuk mund të komunikonin dhe dëgjonin deklaruan se “nuk mund të shikonin” dhe 62% kishin “aftësi të kufizuara intelektuale” - Megjithatë, diskutimi në lidhje me burimin e mundshëm të njëanshmërisë që shkakton këto diferenca qëndron përtej qëllimit të këtij studimi.

Tabela 9. Anëtarët që nuk dëgjojnë apo ata me probleme në dëgjim në familjet e të anketuarve.

Anëtarët që nuk dëgjojnë (me probleme në dëgjim në kllapa) në familje	Të anketuarit që nuk dëgjojnë	Të anketuarit me probleme në dëgjim
Prindërit	12 (+1)	-
Bashkëshorti/ja	237 (+6)	7
Vëllezërit e motrat	71 (+6)	2
Fëmijët	19 (+2)	-
Gjyshërit	3 (+1)	-
Vjehri/vjehrra	-	-

Shumica e të intervistuarve (67%; N=434) ishin të martuar, kryesisht me një person tjetër që nuk dëgjon (86%). 3% e të anketuarve ishin të divorcuar dhe 1% të ve. Gjysma e totalit prej 170 të të anketuarve femra ishin shtëpiake, që nuk punonin jashtë shtëpisë. Shumica e të anketuarve të martuar (93%) kishin edhe fëmijë, 72% e tyre kishin më shumë se një. Një e katërta (26%) ishin të pamartuar, 1% në grupin e kampionit ishin të fejuar. Vetëm 4% e të anketuarve jetonin vetëm. Pothuajse gjysma e tyre jetonin me prindërit (49%); 18% me vëllezërit e motrat; 62% me bashkëshortin/en dhe fëmijët dhe 12% jetonin me vjehrrin/vjehrrën. (Shuma e përqindjeve shkon më shumë se 100%, për shkak se këto kategori mbivendosen pjesërisht. P.sh. një person mund të jetojë me prindërit e tij/saj dhe me vëllezërit e motrat e tij/saj.)

4.2 Arsimi

431 pjesëmarrës nga totali i grupit të kampionit prej 434 personash iu përgjigjën pyetjeve (34-45) në lidhje me nivelin e tyre të arsimimit. 83% (358) kishin ndjekur arsimin 9-vjeçar në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, prej të cilëve 319 madje e kishin mbaruar shkollën: Të dhënat e Censurit kombëtar (INSTAT 2012, 15) tregojnë se 56% e popullsisë me aftësi të kufizuara të moshës 15 vjeç e sipër e kishin përfunduar arsimin bazë. 3% kishin përfunduar arsimin e lartë dhe pasuniversitar, ndërsa 24% nuk kishin shkuar asnjëherë në shkollë. Niveli arsimor në grupin e synuar të këtij studimi mbetet shumë më i lartë sesa në studimin për personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi, por edhe duke e krahasuar me popullsinë me vështirësi në dëgjim, ku vetëm gjysma e fëmijëve ndjekin shkollën (Ferré, Galanxhi dhe Dhono 2015, 19–20). Krahasuar me statistikat e paraqitura në shtojcën 2 (Tabelat V-VIII) ku të dhënat e grumbulluara në Censurin kombëtar të vitit 2011 në lidhje me arsimimin janë ndër-tabuluar me ata persona të moshës 15 vjeç e sipër, të cilët e kanë fare të pamundur të dëgjojnë dhe komunikojnë, niveli arsimor i personave që nuk dëgjojnë është mjaft i lartë: 60% nga këta 3015 persona nuk kanë ndjekur kurrë shkollën. (Megjithatë, diskutimi në lidhje me burimin e mundshëm të njëanshmërisë që shkakton këto diferenca qëndron përtej qëllimit të këtij studimi.)

Të gjithë, përveç njërit (1) nga këta persona të anketuar të regjistruar në institutin për nxënësit që nuk dëgjojnë (n= 363), kanë ndjekur institutin në Tiranë. Shtatë (7) prej tyre ishin arsimuar në shkolla për persona që dëgjojnë (gjashtë persona për 1-4 vjet, një

person për 8 vjet); 14 persona kishin ndjekur shkollën vetëm për nxënës që dëgjojnë (7 persona 7-9 vjet, 6 persona më pak se 3-5 vjet, përgjigjja e një personi mungon). Disa të tjerë e kishin lënë shkollën më herët, për shkak të arsyeve të mëposhtme: 22 për arsye të bulizmit (talljeve); 5 prej tyre nuk mund të përballonin shpenzimet e shkollës; 2 prej tyre nuk ishin të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies; 3 ishin transferuar në një shtet tjetër; 18 për arsye të tjera). - Shumatorja është më shumë se sa numri total i atyre që nuk e kanë përfunduar shkollën sepse këto kategori mbivendosen pjesërisht; p.sh. një person mund ta ketë lënë shkollën për më shumë se një arsye.

Shumëllojshmëria e mënyrave të komunikimit të përdorura në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë përshkruhet në tabelën 10. Përveç gjuhës së folur, mësimi kryhet përmes daktilimit (gjuha shqipe e transliteruar në alfabetin me forma dore) shoqëruar me gjeste. Vetëm katër të anketuar pohojnë se janë arsimuar në gjuhën e shenjave. Kur të anketuarve iu kërkua të vlerësonin aftësitë komunikuese të mësuesve, 97% e të anketuarve pretenduan se aftësitë komunikuese të tyre ishin “të dobëta”; sipas 3% të tyre, komunikimi ishte i kuptueshëm (“mesatar”), por asnjë i anketuar nuk arriti të jepte një vlerësim pozitiv (“mirë”).

Tabela 10. Mënyra e komunikimit e përdorur në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë.

Mënyrat e komunikimit të përdorura në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë.	Shpeshtësia (n=363) *)
Gjestet	332
Daktilimi	232
Të folurit	128
Të shkruarit	5
Gjuha shqipe e shenjave	4
Tjetër	2

*) Shumatorja e shpeshtësive është më e lartë sesa numri i të anketuarve për shkak se mund të përdoren metoda të ndryshme në të njëjtën klasë

Në grupin e kampionit ishin 16 persona që kishin ndjekur shkollën e mesme; 13 prej tyre pretendojnë se kanë hasur vështirësi të mëdha (3 më pak vështirësi) gjatë studimit. 14 persona deklaruan se kjo ishte për shkak të aftësive të tyre të dobëta në lexim dhe në shkrim. Nëse do të kishte interpretë të gjuhës së shenjave, 11 të anketuar do të kishin preferuar përkthimin. Gjithashtu, tre të anketuar kishin ndjekur arsimin e lartë pas shkollës së mesme, njëri prej tyre në shkollën e artit dhe dy të tjerë (pa specifikuar fushën e studimit) në vendet fqinje, Itali dhe Greqi.

4.2.1 Arsimi dhe alfabetizmi

Për të pasur një përshtypje diagnostifikuese të aftësive gjuhësore aktuale në gjuhën shqipe të shkruar mes të anketuarve që nuk dëgjojnë, gjatë studimit u prezantua një test i shkurtër. U prezantua një histori që përmbante shtatë fjali (shih më poshtë) bashkë me nëntë vizatime (shih pyetjen nr. 33 të vrojtimit, Shtojca 1).

Teksti që iu prezantua të intervistuarve ishte si më poshtë:

Na ishte një herë një sorrë që jetonte në skajin e pyllit, pranë një livadhi ku po kullose një tufë me dele. Një mëngjes, sorra ishte ulur në degën e një pishë dhe po shikonte qiellin. Ajo pa një shqiponjë që fluturonte në qiell. Papritur, shqiponja u turr në mes të tufës. Shqiponja rrëmbeu një qengj dhe u largua fluturimthi. Sorra vendosi të bënte të njëjtën gjë. Sorra u lëshua fluturimthi drejt tufës.

Pasi lexuan tekstin, të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin tre figura nga nëntë dhe t'i vendosnin ato mbi tavolinë (ose në pyetësorin në faqen e internetit) sipas një renditje që të ishte sipas rrjedhës së historisë. 38% e të gjithë të anketuarve (164/434) deklaruan menjëherë se ishin analfabetë në gjuhën shqipe dhe se nuk dëshironin t'u përgjigjeshin kësaj pyetjeje të studimit. Nga 270 personat që shprehën dëshirën të vazhdonin detyrën (62% e grupit të kampionit), vetëm shtatë (7) persona (3% e këtij nëngrupi) ishin në gjendje të zgjidhnin vizatimet që lidheshin disi me rrjedhën e historisë dhe t'i rendisnin ato në mënyrë të pranueshme. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk mundi të zgjidhte renditjen e duhur që të pasqyronte rrjedhën e ngjarjes së historisë.

Pak më shumë se një e treta (105) e personave që morën pjesë në testin e të lexuarit zgjodhën figura krejtësisht të gabuara që nuk lidheshin semantikisht me historinë. Edhe këta persona mund të konsiderohen analfabetë, njëlloj si ata që refuzuan të merrnin pjesë në këtë test. Kur të anketuarit u pyetën për përshtypjet e tyre për vetë aftësitë e tyre gjuhësore kur shkruanin gjuhën shqipe (pyetja 32: "A është e thjeshtë të shkruani në gjuhën shqipe"), 380 persona nga 432 (88%) që iu përgjigjën kësaj pyetje (2 përgjigje mungonin) pohuan se nuk ishin fare në gjendje të shkruanin në gjuhën shqipe. Këto shifra mund të krahasohen me Censusin kombëtar të vitit 2011 (INSTAT 2012, 12), sipas të cilit shkalla e analfabetizmit në popullsinë me aftësi të kufizuara 10 vjeç e sipër është 2,8%. Kjo do të thotë se numri i personave analfabetë mes popullsisë që nuk dëgjon është jashtëzakonisht i lartë, por ky numër mbetet i lartë edhe në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë me aftësi të kufizuara, ku sipas Ferré, Galanxhi dhe Dhono (2015, 21) mesatarisht një person në pesë është analfabet.

Duke përdorur metodën e triangulimit, ekipi i studimit donte të mblidhte informacion mbi aspekte të ndryshme të aftësive në lexim dhe në shkrim në komunitetin shqiptar të personave që nuk dëgjojnë, pasi anëtarët e këtij komuniteti deklarojë se analfabetizmi është një fenomen i zakonshëm mes tyre. Ne ju drejtuam të anketuarve pyetjet e mëposhtme që kishin të bënin me leximin dhe shkrimin gjatë jetës së tyre të përditshme (shih pyetjet 28-32, Shtojca 1). Si kuptohen mesazhet me shkrim dhe a kanë nevojë për ndihmë nëse këto mesazhe u dërgohen apo lexohen nga persona të jashtëm (d.m.th. jo nga miqtë apo nga anëtarët e familjes, të cilët janë të njohur me problematikat e analfabetizmit). Gjithashtu, ne i pyetëm se sa e lehtë u dukej të anketuarve të shkruanin në gjuhën shqipe në përgjithësi (pyetja nr. 32).

251 persona nga 327 iu përgjigjën pyetjes nr. 30. Nga ky nëngrup, 76% pohuan se personat që dëgjojnë nuk i kuptojnë fare mesazhet e tyre, ndërsa 7% deklaruan se mesazhet e tyre ishin disi të kuptueshme. Vetëm 2 persona nga të gjithë të intervistuarit pohuan se mesazhet e tyre me shkrim kuptoheshin nga personat e jashtëm. 16% e grupit (n=52) nuk ishin në gjendje t'i përgjigjeshin pyetjes. not able to answer this question.

89% e të gjithë grupit të kampionit (N=434) u përgjigjën se nuk i kuptonin fare mesazhet me shkrim që merrnin, dhe 11% deklaruan se kishin vështirësi. Vetëm një (1) person konfirmoi se ishte në gjendje të kuptonte shumë mirë mesazhet me shkrim. Kur krahasojmë këto rezultate me testin e leximit përmes ndër-tabulimit, mund të vërtetojmë se shumica e të anketuarve i kuptojnë në mënyrë koherente aftësitë e tyre gjuhësore në gjuhën shqipe: mesatarisht 87% të këtij nëngrupi që zgjodhi vizatime krejtësisht të gabuara në testin e leximit deklaruan se nuk i kuptonin mesazhet me shkrim të “personave të jashtëm që dëgjonin” dhe se nuk i kuptonin programet me titra në televizor (korrelacioni është i konsiderueshëm: $r=.985$, $p < .000$). Gjithashtu, kur u shkruajnë mesazhe njerëzve që nuk janë anëtarë të familjes së tyre, këto mesazhe nuk mund të deshifrohen nga të jashtëm. Ka një korrelacion të konsiderueshëm mes aftësive në shkrim (të perceptuara negativisht) të vetë të anketuarve dhe pretendimit të tyre që mesazhet me shkrim në gjuhën shqipe nuk kuptohen nga njerëzit e tjerë ($r=.795$; $p < .000$).

Gjithashtu, ne analizuam të dhënat e studimit duke krahasuar edhe aftësitë gjuhësore të shqipes me formimin arsimor të pjesëmarrësve. Tabela 11 tregon se as ndjekja e instituti të nxënësve që nuk dëgjojnë dhe as ndjekja e ndonjë shkolle tjetër të zakonshme, nuk i përgatit personat që nuk dëgjojnë të kuptojnë shqipen e shkruar. Arsimi bazë nuk u ofron atyre aftësitë e duhura për të shkruar gjuhën shqipe (Tabelat 12 dhe 13) pavarësisht faktit se përveç gjesteve, metoda më e zakonshme për të përcjellë përmbajtjen arsimore (duke përfshirë gramatikën e gjuhës shqipe) në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë është daktilimi i fjalëve.

Tabela 11. Formimi arsimor dhe të kuptuarit e teksteve të shkruara.

Formimi arsimor	A i kuptoni mesazhet e shkruara që ju dërgojnë personat që dëgjojnë?					
	I kuptoj shumë mirë		I kuptoj me vështirësi		Nuk i kuptoj fare	
	N	%	N	%	N	%
Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë	1	1	31	11	251	89
Shkolla për personat që dëgjojnë	1	14	-	0	6	86
Të anketuarit që ndjekin Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë dhe shkollën për personat që dëgjojnë	-	0	3	43	4	57

Tabela 12. Aftësitë në të shkruar të vlerësuara nga vetë të anketuarit, të ndër-tabuluara me formimin arsimor.

Formimi arsimor	A është e thjeshtë të shkruani në gjuhën shqipe?					
	Është e thjeshtë		E kam pak të vështirë		Nuk di fare	
	N	%	N	%	N	%
Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë	1	1	48	13	308	86
Shkolla për personat që dëgjojnë	1	7	-	0	13	93
Të anketuarit që ndjekin Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë dhe shkollën për personat që dëgjojnë	-	0	4	57	3	43

Tabela 13. Aftësitë në të shkruar të të anketuarve të vlerësuara nga persona të jashtëm, të ndër-tabuluara me formimin arsimor.

Formimi arsimor	A i kuptojnë personat që dëgjojnë mesazhet që ju i përcillni?							
	I kuptojnë shumë mirë		I kuptojnë me vështirësi		Nuk i kuptoj fare		Nuk e di	
	N	%	N	%	N	%	N	%
Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë	1	1	20	7	217	77	43	15
Shkolla për personat që dëgjojnë	1	14	-	0	6	86	-	0
Të anketuarit që ndjekin Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë dhe shkollën për personat që dëgjojnë	-	0	2	29	5	71	-	0

4.2.2 Arsimi dhe punësimi

Në këtë studim, dëshirojmë të analizojmë lidhjen mes formimit arsimor dhe shkallës së punësimit të personave që nuk dëgjojnë (Tabela 14). Në bazë të rezultateve të analizës “chi-kuadrat” me këto tregues, mund të thuhet se faktorët e mëposhtëm janë të lidhur nga pikëpamja statistikore ($\chi^2(2) = 6,091; p < .048$): Ata persona që kanë ndjekur Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë dhe e kanë përfunduar atë, kanë pasur më shumë mundësi për t’u punësuar se sa ata që nuk e kishin përfunduar shkollën ose ata që kishin ndjekur shkollën për personat që dëgjojnë.

Tabela 14. Punësimi dhe formimi arsimor.

		Punësimi			Totali
		me kohë të plotë	me kohë të pjesshme	nuk punoj *)	
Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë i përfunduar	JO	13	13	88	114
		11 %	11 %	77 %	100 %
	PO	69	39	212	320
		22 %	12 %	66 %	100 %
Totali		82	52	300	434
		19 %	12 %	69 %	100 %

*) Kategoria “nuk punoj” përfshin të dy grupet e të anketuarve: të papunët dhe shtëpiaket

4.3 Punësimi

Në studim, kishte katër pyetje (nr.14-17 në pyetësor) lidhur me pjesëmarrjen në tregun e punës. Për të qenë më të qartë, periudha kohore ishte e kufizuar duke filluar një muaj përpara momentit të studimit (d.m.th. 20 dhjetor 2014 - 21 shkurt 2015, në varësi të momentit të studimit). Gjatë kësaj kohe, 300 të anketuar nuk punonin, madje as edhe një orë, 201 prej tyre ishin, de facto, të papunë.

Nga 300 persona që nuk punonin, 1/3 ishin jashtë tregut të punës: 92 ishin shtëpiake (që përfaqësojnë rreth gjysmën e 170 grave pjesëmarrëse në këtë studim). Katër (4) të anketuar po kryenin studimet dhe gjashtë (6) persona dhanë arsye të tjera se pse nuk ishin në gjendje të punonin. (Mungon informacioni për 2 persona nga totali prej 434 persona të intervistuar.)

Ndërkohë që shkalla e papunësisë ishte 61% te personat që mund të merrnin pjesë në tregun e punës (n=249), 39% ishin të punësuar - me kohë të plotë (77 persona) ose me kohë të pjesshme (52 persona). Shih Tabelën 15, ata që nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në tregun e punës (studentët, shtëpiaket, dhe personat 65 vjeç (studentët, shtëpiaket, dhe personat 65 vjeç - gjithsej 102 persona).

Tabela 15. Punësimi në grupin e synuar (dhjetor 2014 - shkurt 2015).

Statusi i punësimit	Shpeshtësia	Përqindja	Përqindja e vlefshme
Në punë me kohë të plotë	77	18	23
Në punë me kohë të pjesshme	52	12	16
I papunë	201	47	61
Totali	330	76	100
Të anketuarit studentë, shtëpiake dhe të moshuar	102	24	
Totali i përgjithshëm	432 *)	100	

*) Mungojnë dy persona.

Tabela 16 tregon shpërndarjen në fushat e ndryshme të punës. Numri i të anketuarve për këtë pyetje (Nr.16) në lidhje me fushën ku punon personi është disi më i lartë sesa numri i të punësuarve në Tabelën 15, pasi përgjigjet janë dhënë edhe nga njerëzit që nuk punonin gjatë muajit paraardhës.

Kategoria “tjetër” është shumë më e gjerë sesa profesionet e përmendura në pyetjen që përfaqësojnë ato që nga komuniteti i personave që nuk dëgjojnë konsiderohen si më të shpeshta mes anëtarëve të tyre. Më pas, Florjan Rojba ka kërkuar informacion shtesë nga personat që punuan në terren. Sipas komunikimeve të tij personale (18 mars 2016) profesionet e mëposhtme përfaqësoheshin në këtë kategori, si për shembull: *Hidraulik, barist, pronar kafeneje, pjatolarës, shitës ambulant, shpërndarës me motoçikletë, edukatore në kopsht, portier, riciklues metalesh, shitës rrobash* (në tregun e mallrave të lira). - Shumë prej tyre ishin të vetëpunësuar dhe disa madje kishin punësuar njerëz të tjerë në sipërmarrjen e tyre (p.sh. pronarët e kafeneve dhe personat që zotëronin ofiçina për mirëmbajtjen e makinave).

Tabela 16. Statusi i punësimit në fusha të ndryshme pune (n=134).

Fusha e punës	Statusi i punësimit		Totali
	Me kohë të plotë	Me kohë të pjesshme	
Bujqësi	2	3	5
Ndërtim	2	7	9
Marangoz	4	3	7
Argjendar	2	0	2
Rrobaqepës	16	6	22
Mekanik për makina	0	2	2
Këpuçar	14	3	17
Parukier	4	1	5
Në shtypshkronjë	3	0	3
Pastrues	3	0	3
Larje makinash	1	1	2
Arredim	0	1	1
Tjetër	31	25	56

Shifrat lidhur me nivelin e punësimit në komunitetin e personave që nuk dëgjojnë janë më interesante në krahasim me ato të popullsisë me aftësi të kufizuara në përgjithësi. Sipas studimit të Ferre, Galanxhi dhe Dhono (2015, 22), shkalla e punësimit në popullsinë pa aftësi të kufizuara (mosha 15-64) është 36%; jashtë forcës së punës janë 49% e qytetarëve dhe 15% e popullsisë pa aftësi të kufizuara janë të papunë. Brenda së njëjtës grupmoshe të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, 81% e tyre janë jashtë forcës punëtore, 8% janë të papunë.

Megjithatë, njerëzit me probleme shikimi, dëgjimi dhe lëvizjeje kanë më shumë gjasa të punojnë dhe të punësohen se sa njerëzit me vështirësi të tjera: Ferré, Galanxhi dhe

Dhono (2015, 22) konstatuan gjithashtu se në grupin e qytetarëve të moshës 25-64 vjeç **me** aftësi të kufizuar në dëgjim, 82% ishin jashtë forcës punëtore, 13% ishin të punësuar dhe 5% të papunë.¹⁰ Është e vërtetë që studimi ynë tregon se qytetarët që nuk dëgjojnë janë më shumë të integruar në tregun e punës sesa qytetarë të tjerë në grupin e personave me aftësi të kufizuara: **në** grupin e 330 personave që nuk dëgjojnë të përfshirë në tregun e punës, 23% janë të punësuar me kohë të plotë dhe 16% me kohë të pjesshme. (Gjithashtu, shih kapitullin tjetër, ku paraqiten lidhjet mes punësimit dhe aftësive gjuhësore.)

Për fat të keq, ky studim nuk ofron të dhëna për nivelin e të ardhurave sepse objektivi i tij ishte të përqendrohej kryesisht në aksesueshmërinë arsimore dhe gjuhësore. Gjatë kryerjes së studimit, personat që punuan në terren konstatuan edhe varfëri të thellë dhe skamje mes atyre personave që nuk dëgjojnë të papunë dhe që jetonin në prefektura të thella. (Shih Ekstraktet nga raportet e punës në terren në këtë studim.) Në fakt, të dhënat e mbledhura për këtë studim tregojnë diferenca të konsiderueshme nga pikëpamja statistikore në shkallën e punësimit të njerëzve që jetojnë në zona të ndryshme gjeografike (burra: $\chi^2(46)=63,48$, $p<.045$; gra: $X^2(40)=74,45$, $p<.001$). Sipas të dhënave tona, rezultoi se personat që nuk dëgjojnë që jetojnë p.sh. në Berat, Durrës dhe Tiranë kanë më shumë mundësi të gjejnë punë sesa banorët e Shkodrës dhe Vlorës. Gjithashtu, në Berat dhe në Tiranë, gratë kanë pasur pak më shumë mundësi të punësohen. Megjithatë, nuk ka ndryshime të konsiderueshme statistikore mes gjinive në lidhje me punësimin e personave aktiv në tregun e punës. Shih Tabelën 17 ku, për arsye statistikore dhe privatesie, janë përjashtuar rrethet ku informacioni është marrë nga më pak se 9 persona.

¹⁰ Shifrat ndryshojnë disi, kur shohim të dhënat e grumbulluara në Censusin kombëtar të vitit 2011: 3% e popullsisë të moshës 15 vjeç që nuk është në gjendje të dëgjojë dhe të komunikojë janë të punësuar, ndërsa 96% nuk janë aktiv. Shih Shtojcën 2, Tabelat IX-X. Megjithatë, diskutimi në lidhje me burimin e këtyre diferencave qëndron përtej objektivit të këtij studimi.

Tabela 17. Vendbanimi dhe statusi i punësimit në momentin e intervistës (të dyja gjinitë). Fushat e përfaqësuar nga më pak se 9 të anketuar nuk janë paraqitur.

	Statusi i punësimit dhjetor-shkurt 2015 ^{*)}			Totali
	Në punë me kohë të plotë	Në punë me kohë të pjesshme	I papunë	
Berat	10 44 %	4 17 %	9 39 %	23 100 %
Durrës	9 38 %	4 17 %	11 46 %	24 100 %
Elbasan	2 7 %	6 21 %	21 72 %	29 100 %
Fier	5 12 %	6 15 %	30 72 %	41 100 %
Korçë	4 27 %	4 27 %	7 47 %	15 100 %
Lushnje	2 11 %	5 26 %	12 63 %	19 100 %
Pogradec	1 5 %	1 5 %	17 90 %	19 100 %
Shkodër	3 11 %	6 21 %	19 68 %	28 100 %
Tiranë	26 62 %	7 17 %	9 21 %	42 100 %
Vlorë	6 23 %	2 8 %	18 69 %	26 100 %

^{*)} Të dhënat përfshijnë vetëm persona aktiv në tregun e punës; shtëpiaket, studentët dhe personat mbi 65 vjeç janë përjashtuar.

4.4 Mjedisi gjuhësor dhe njohuritë mbi gjuhën shqipe të shenjave

Sipas Mitchell dhe Karchmer (2004) mungesa e trashëguar e dëgjimit pritet të gjendet në 5 deri 8% të popullsisë që nuk dëgjon. Kjo do të thotë se rreth 95% e personave që nuk dëgjojnë kanë lindur nga prindër që dëgjojnë. Në përputhje me vlerësimin e Mitchell dhe Karchmer, 96% e të gjithë pjesëmarrësve (N=434) në këtë vërtetim kanë prindër që dëgjojnë (shih Kapitullin 4.1). Kjo do të thotë se këta prindër nuk kanë eksperiencë të mëparshme, për shembull, se si të kenë një komunikim të suksesshëm me fëmijën e tyre që nuk dëgjon. Në fakt, problemet që lindin gjatë komunikimit mes prindërve që dëgjojnë dhe fëmijëve që nuk dëgjojnë kanë qenë një nga çështjet kryesore që nga fillimi i studimeve dhe kërkimeve në lidhje me mungesën e dëgjimit dhe përsëri janë të tilla (shih p.sh. Argillander 1999 [1762, 1771], Itard 1801 deri në Lane 1984; Sacks 1989; Marschark dhe Hauser 2012).

Megjithatë, në këtë studim, nuk arritëm të studiojmë aspekte të ndryshme të zhvillimit gjuhësor dhe të aftësisë në shkrim dhe lexim në popullsinë që nuk dëgjon. Objektivi ka

qenë të përshkruhet në mënyrë konkrete mjedisi gjuhësor ku personat që nuk dëgjojnë jetojnë sot. Kjo është kryer duke i pyetur të anketuarit se si komunikojnë me anëtarët që dëgjojnë të familjes së tyre (pyetja 22), si komunikojnë me persona të tjerë që dëgjojnë (pyetja 23); a e kanë të lehtë të anketuarit të kuptojnë personat që dëgjojnë dhe anasjelltas (pyetjet 24-25) ose a kanë nevojë për ndihmë gjatë veprimtarive të tilla si p.sh. kur shkojnë në bankë dhe kujt ia kërkojnë këtë ndihmë (pyetja 26).

Gjithashtu, i kemi pyetur të intervistuarit nëse kanë pasur ndonjëherë interpret profesional të gjuhës së shenjave (pyetja nr. 27). Për shumicën e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri, kjo është një pyetje hipotetike sepse kursi i vetëm për interpretët e gjuhës së shenjave - niveli bazë - është zhvilluar në Tiranë në vitet 2007–2009. Dy nga ata persona që e përfunduan kursin aktualisht punojnë pranë ANAD-it; katër prej tyre punojnë herë pas here si interpretë, kryesisht në kontakt me ANAD-it. Megjithatë, 18 persona deklaruan se ndonjëherë kanë pasur interpret profesional në dispozicion. (Nuk u pyetën për hollësi, këto raste mund të kenë qenë aktivitete të organizuara nga sektori publik ose ANAD-i, ose në gjykatë, ku ANAD përpiqet të sigurojë interpretë të gjuhës së shenjave).

Sipas të intervistuarve, gjuha që ata përdorin në shtëpi është një formë e folur ose e shkruar e gjuhës shqipe, e cila mund të prodhohet nga alfabeti me forma dore për të treguar fjalë të shkëputura. Ky rezultat është mjaft befasisht, sepse 88% e të anketuarve janë analfabetë në gjuhën shqipe të shkruar (shih Kapitullin 4.2). Në fakt, kur iu përgjigjen pyetjes nr. 22, ata deklaruan se kryesisht mbështeteshin në komunikimin me gjeste (N. B. ato nuk janë shenja të konvencionalizuara të gjuhës shqipe të shenjave) si mjet komunikimi me anëtarët e familjes (Tabela 18). Vetëm nëntë persona të anketuar ishin në gjendje të përdornin gjuhën shqipe të shenjave me anëtarë të familjes që dëgjojnë. Katër persona deklaruan se nuk komunikojnë fare me anëtarët e tjerë të familjes.

Tabela 18. Komunikimi me anëtarë të familjes që dëgjojnë.

Mënyrat e komunikimit	Numri i të anketuarve
Gjuha shqipe e folur	185
Gjuha shqipe e shkruar	21
Gjestet	401
Daktilimi	149
Gjuha shqipe e shenjave	7
Nuk komunikoj me anëtarët e familjes sime	4

Kur komunikojnë me njerëz jashtë familjeve të tyre, të intervistuarit përdorin kryesisht komunikimin jo gjuhësor me gjeste dhe të treguarit me gisht ose përpiqen të shqiptojnë fjalë në shqip (Tabela 19). Megjithatë, 375 nga 423 persona që iu përgjigjen pyetjes nr. 23 (nëse kuptohen apo jo nga personat që dëgjojnë) pohuan se personat jashtë familjes së tyre nuk i kuptojnë fare; 48 mendonin se kuptoheshin në një farë mënyre. Asnjëri nuk e konsideronte komunikimin si plotësisht të suksesshëm me personat e jashtëm. Nga ana tjetër, 405 (94%) nga ata 429 të anketuar të cilët vlerësuan të kuptuarit e të folurit ndaj tyre (pyetja nr. 25) deklaruan se nuk ishin aspak në gjendje të ndiqnin mesazhet e folura, ndërsa 6% (n=24) pohuan se mesazhet e folura ishin të komplikuar. Asnjë nga të anketuarit nuk e vlerësoi të lehtë komunikimin mes tyre dhe personave që dëgjojnë.

Tabela 19. Përgjigjet ndaj pyetjes “Si komunikoni me persona të tjerë që dëgjojnë (jo anëtarë të familjes)?” (Të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin të gjitha alternativat e vlefshme.)

Mënyrat e komunikimit	Numri i të anketuarve
Gjuha shqipe e folur	116
Gjuha shqipe e shkruar	53
Përdorimi i imazheve dhe vizatimeve	7
Duke treguar me gisht, me gjeste	369
Gjuha shqipe e shenjave	1
Interpret i gjuhës së shenjave	1
Duke kërkuar ndihmë nga një i afërm apo një mik	187
"Nuk di se si të komunikoj me ta"	32

Për shkak të vështirësive të njohura në komunikim dhe mungesës së shërbimeve të përkthimit, të anketuarit u pyetën se kujt u drejtohen nëse, për shembull, kanë nevojë për të kryer ndonjë porosi ose kur shkojnë në bankë. Shpesh ishin prindërit e vetë të anketuarve përveç motrave dhe vëllezërve, fëmijëve të rritur dhe bashkëshortëve të cilët u vinin në ndihmë me përkthimin, por edhe persona të tjerë të paspecifikuar (Figura 8).¹¹ Gjatë ndër-tabulimit të këtyre rezultateve, konstatoam se, p.sh.12 të anketuar pohuan se ishin të martuar me një person që dëgjon/me probleme në dëgjim dhe gjashtë (6) me një person që nuk dëgjon, i cili do t'i ndihmonte ata gjatë bisedave me persona që dëgjojnë. Madje, 12 të anketuar u përgjigjën se fëmijët e tyre të rritur *që nuk* dëgjojnë i ndihmojnë kur kanë për të kryer ndonjë porosi me njerëzit që dëgjojnë.

Personat që ndihmojnë

Personat që ndihmojnë personat që nuk dëgjojnë në komunikimin me të tjerë (186/434 përgjigje)




Figura 8. Personat që ndihmojnë të anketuarit në komunikim.

¹¹ Çfarë të bën përshtypje në pyetjen nr. 26 është se vetëm 186 persona nga i gjithë grupi i kampionit mund të jepnin një përgjigje. Kur studiuesit e këtij studimi pyetën më pas personat që punuan në terren se si reagojnë të anketuarit e tjerë dhe si përballeshin me situata të ngjashme, përgjigjja ishte: “Nëse nuk iu përgjigjën pyetjes, do të thotë se ata nuk shkojnë kurrë në bankë.” (Florjan Robja, komunikimi personal me Päivi Rainò 25.10.2015). - Fatkeqësisht, kjo mundësi nuk u morr në konsideratë gjatë përgatitjes së pyetjeve të vrojtimit dhe përzgjedhjes së përgjigjeve.

Siç u përmend më sipër, shumica e të anketuarve përmendën të folurit dhe daktilimin të shoqëruar me gjeste si mënyra kryesore komunikimi në familje dhe në shkollë (shih Kapitullin 4.2). Në kundërshtim me historinë tradicionale sociale dhe kulturore të popullsisë që nuk dëgjon të dokumentuar në shumë vende të tjera, vetëm disa nga pjesëmarrësit në studimin tonë (13 nga 139) që deklaruan se e njihnin gjuhën shqipe të shenjave, e kanë mësuar atë nga shokë të tjerë klase që nuk dëgjojnë në shkollë. Përpara viteve 1990, ishte pothuajse e pamundur për shkak të regjimit komunist që gjuha shqipe e shenjave të lulëzonte dhe procesi natyror i homogjenizimit filloi vetëm në fillim të mijëvjeçarit (shih Hyrjen dhe Hoyer 2007). Me sa duket, nuk ka ekzistuar asnjë mundësi as për komunikim pamor i cili mund të jetë përdorur mes të afërmeve që nuk dëgjojnë dhe që mund të jetë trashëguar nga një brez në tjetrin, dhe as të ketë ekzistuar ndonjë mundësi reale për t'ua mësuar atë personave të tjerë që nuk dëgjojnë. Kjo konfirmohet duke kryer ndër-tabulimin e të gjithë informacionit të mbledhur nga ata që kanë pohuar se mungesën e dëgjimit e kanë të trashëguar (n=23), ata që kanë një prind që nuk dëgjon (n=13), ata që kanë motra e vëllezër që nuk dëgjojnë apo të afërm të tjerë që nuk dëgjojnë (n=52)¹² dhe nga përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve “A e njihni gjuhën shqipe të shenjave?” (pyetja nr. 18, shih Figura 9) dhe “Ku e keni mësuar gjuhën shqipe të shenjave?” (pyetja nr. 20). Në secilën prej këtyre kategorive, rreth 60-70% e tyre pohuan se nuk e njohin fare gjuhën shqipe të shenjave dhe vetëm 2-4 persona në çdo kategori pohuan se e njihnin shumë mirë atë.

Megjithatë, duhet të theksohet se 68% (295; N=434) e të gjithë pjesëmarrësve në studim kanë deklaruar se nuk e njohin gjuhën shqipe të shenjave (nuk ka pasur ndryshime statistikore mes të anketuarve meshkuj dhe femra). Kjo është e kuptueshme sepse kjo gjuhë e filloi procesin e saj të ngadaltë nga idiolektet individuale drejt një gjuhe shenjash të përbashkët dhe të zakonshme vetëm në fillim të mijëvjeçarit të ri (shih Hoyer 2007; dhe kapitullin 1.1 (Hyrje);



Figura 9. Zotërimi i gjuhës shqipe të shenjave mes të anketuarve.

¹² Këto kategori mund të kenë mbivendosje, d.m.th i njëjti person mund të ketë deklaruar që ka prindër dhe vëllezër e motra që nuk dëgjojnë. Nga ana tjetër, jo të gjithë ata që kanë p.sh. vëllezër e motra apo kushërinj që nuk dëgjojnë kanë deklaruar se mungesën e dëgjimit e kanë të trashëguar.

Shumica e 139 personave që deklaruan se e njihnin gjuhën shqipe të shenjave, e kanë mësuar atë pas moshës 15 vjeçare (vetëm 13% e kanë mësuar më parë); gjysma e nëngrupit ndërmjet moshës 16 - 25 vjeç dhe 37% ndërmjet moshës 26-48 vjeç. Vetëm 32 persona nga të gjithë të intervistuarit pohuan se e zotëronin mirë gjuhën shqipe të shenjave; 107 deklaruan se e njihnin pak (shih Figura 9). Këta persona e kanë mësuar atë kryesisht nga persona të tjerë që nuk dëgjojnë dhe duke qenë në kontakt me ANAD-in, por edhe nga të afërm të tjerë që nuk dëgjojnë, shih Figurën 10. (Në këtë kategori përfshihen edhe bashkëshortët; 86% e të intervistuarve të martuar janë martuar me një person tjetër që nuk dëgjon; shih Kapitullin 4.1).




Figura 10. Ku e keni mësuar gjuhën shqipe të shenjave? (Disa zgjedhje ishin të mundshme.)

Gjithashtu, ka disa diferenca të konsiderueshme nga pikëpamja statistikore mes zonave gjeografike se sa mirë njihet gjuha shqipe e shenjave ($\chi^2(46)=142,87, p<.000$). Meqenëse shumica e personave e kanë mësuar gjuhën duke qenë në kontakt me ANAD-in, këto zona ku gjuha shqipe e shenjave njihet më mirë presupozohet se janë zonat ku ANAD-i ka mundur të punojë në mënyrë aktive. Për shembull, në kryeqytetin e Shqipërisë, në Tiranë, përafërsisht 60% dhe në qytete të tilla si Durrësi, Lushnja ($n>20$) përafërsisht 40% e të anketuarve e zotëronin disi gjuhën shqipe të shenjave. Në Berat dhe në Pogradec, më shumë se 90% e të anketuarve ($n>20$) deklaruan se nuk i njihnin fare shenjat konvencionale.

Megjithatë, një nga gjetjet më interesante është lidhja pozitive mes aftësive të duhura në gjuhën shqipe të shkruar dhe zotërimit të mirë të gjuhës së shenjave: ata që njohin gjuhën shqipe të shenjave kanë aftësi më të mira në gjuhën shqipe të shkruar sesa të tjerët që nuk e njohin gjuhën shqipe të shenjave ($r=.471, p<.000$). Për më tepër, ka një lidhje të konsiderueshme statistikore mes zotërimit të gjuhës shqipe të shenjave dhe statusit të punësimit ($\chi^2(4)=31.472, p<.000$): personat që e njohin shumë mirë gjuhën shqipe të shenjave kanë më shumë mundësi për t'u punësuar sesa personat me njohuri të dobëta të kësaj gjuhe (Tabela 20).

Dy ditë në jetën e secilit prej nesh

Florjan Rojba

Përkthimi nga gjuha shqipe e shenjave në anglisht

Bekim

Nëna e Bekimit [emri i shpikur] e zgjon atë në mëngjes, sepse ai nuk mund ta dëgjojë zilen e alarmit. Gjatë rrugës për në punë në një fabrikë këpucësh, ai ndalon pranë një kioske për të lexuar gazetën, por ai arrin të kuptojë shumë pak: vetëm rezultatet sportive dhe disa fjalë që i njejnë nëpër tituj. Në punë, kolegët që dëgjojnë flasin me njëri-tjetrin. Bekimi nuk është në gjendje të ndjekë bisedën dhe përjashtohet automatikisht. Edhe nëse ai i pyet se për çfarë po flasin, njerëzit që dëgjojnë nuk mund ta përfshijë atë - ata nuk e dinë se si. Ata nuk e dinë gjuhën e shenjave dhe prandaj përpiqen të daktulojnë ose të përdorin gjeste për të treguar fjalët, por është shumë e vështirë për të dyja palët të komunikojnë në këtë mënyrë. Bekimi punon duke mos ndërvepruar shumë me të tjerët. Kolegët që dëgjojnë mund ta ftojnë t'u bashkohet për një kafe në fund të ditës, por Bekimi refuzon me pretekste të ndryshme. Ai nuk ndihet rehat kur ulet në shoqërinë e të tjerëve pa marrë pjesë në bisedë.

Bekimi kthehet në shtëpi dhe prindërit e pyesin, me shenja të thjeshta, se si i shkoi dita në punë. Ai ua kthen me shenja duke u thënë 'mirë'. As prindërit nuk e njohin gjuhën e shenjave, kështu që ai nuk ka asnjë mënyrë se si ta ndajë me ta përvojën e ditës së punës. Pas drekës, ai shikon lajmet në televizor, por nuk arrin të ndjekë përmbajtjen. Bekimi e pyet nënën se çfarë po thuhet. Ajo i tregon me gjeste se nuk është e rëndësishme.

Pasditë, Bekimi i thotë nënës e tij, përmes gjesteve që i përdorin bashkërisht, se po shkon të takojë një mik që nuk dëgjon në një kafene. Kur takohen, ata fillojnë të diskutojnë mbi lajmet. Bekimi i tregon se nuk i ka kuptuar ato që kishte parë në televizor dhe se nëna e tij i kishte thënë se nuk kishte asgjë me rëndësi. Miku i tij fillon t'i tregojë plot zell me shenja se lajmet ishin për një vendim të parlamentit. Ai mund t'ia shpjegojë lajmet mjaft mirë, sepse ai ka një motër që e di gjuhën e shenjave.

Kur një mik që dëgjon ulet në të njëjtën tavolinë me ta, Bekimi e prezanton atë me personin tjetër që nuk dëgjon. Por miku që dëgjon nuk qëndron gjatë, sepse ai

nuk e njejnë gjuhën e shenjave dhe nuk mund të ndjekë bisedën. Pas një bisede të gjatë me shenja me mikun e tij që nuk dëgjon, Bekimi kthehet në shtëpi.

Elvira

Elvira [emër i shpikur] po kërkon punë në mënyrë aktive dhe është mjaft e irrituar, por deri më tani e kanë refuzuar kudo. Punëdhënësit nuk duan të punësojnë persona që nuk dëgjojnë sepse e kanë të vështirë të komunikojnë me ta. Elvira shkon në qendër të qytetit për të takuar miken e saj. Ato ulen për një kafe dhe fillojnë të diskutojnë lajmet. Elvira i bën me shenja se kishte parë një fotografi në gazetë, ku, me sa duket kishin arrestuar dikë. Shoqja e saj i thotë se arrestimi ishte për shkak të vjedhjes së parave. Ajo thjesht supozon sepse ajo nuk di të lexojë. Ato vendosin të pyesin kamerierin, duke qenë se e pinin kafën në të njëjtin lokal, ku kamerieri kishte mësuar disa shenja kryesore. Ato e pyesin nëse ai mund t'ju shpjegojë arsyen e arrestimit. Kamerieri i tregon me gjeste se personi i arrestuar është i implikuar në disa vrasje mafioze që kanë ndodhur në të shkuarën. Kështu që ato të dyja e kuptojnë se tema e lajmit nuk kishte të bënte fare me vjedhje.

Pas një bisede të gjatë me miken e saj, Elvira kthehet në shtëpi për drekë. Nëna e pyet se çfarë kishte bërë dhe Elvira i përgjigjet me gjeste dhe daktilon fjalët "shoqe", "takova" dhe "kafene". Pas drekës, ajo sheh lajmet shkurt në televizor. Elvira përpiqet të mësojë më shumë rreth lajmeve nga nëna e saj. Nëna përgjigjet se një parti politike është e korruptuar dhe po vjedh para, por nuk arrin ta shpjegojë temën me detaje. Ajo bën vetëm disa shenja të zakonshme që njejnë: "parti politike" dhe "vjedhje".

Në mbrëmje, duke ngrënë darkë me anëtarët e familjes, nëna, babai dhe vëllezërit e motrat po flasin me njëri-tjetrin. Elvira mbështetet në karrige dhe vetëm i shikon: ata duken të kënaqur për diçka, por ajo nuk kupton asgjë nga ato që po thuhet.

Tabela 20. Ndër tabulimi mes aftësive në gjuhën e shenjave dhe punësimit.

			Punësimi			Totali
			Me kohë të plotë	Me kohë të pjesshme	Nuk punoj	
A e njihni gjuhën shqipe të shenjave?	Po, shumë mirë	Të anketuarit (f)	15	1	16	32
		%	47 %	3 %	50 %	100 %
	Po, pak	Të anketuarit (f)	30	15	63	108
		%	28 %	14 %	58 %	100 %
	Aspak	Të anketuarit (f)	37	36	221	294
		%	13 %	12 %	75 %	100 %
Total	Të anketuarit (f)	82	52	300	434	
	%	19 %	12 %	69 %	100 %	

Kapitulli tjetër vijon me analizimin e të dhënave të aftësive në shkrim dhe lexim nga perspektiva të shumta. Është përdorur metoda e triangulimit për të kontrolluar më tej vlefshmërinë e rezultateve, pamundësinë për të funksionuar me gjuhën e shkruar dhe si ndikon kjo në aksesin në informacion.

4.5 Aksesin në informacion

Në këtë studim, pyetjet përfundimtare në pyetësor kishin të bënin me të qenit të informuar për lajmet në gjuhën shqipe të shenjave në kanal televiziv kombëtar TVSH, të transmetuara gjatë ditëve të javës. 375 nga të gjithë 434 personat e intervistuar (86%) dhanë përgjigje pozitive për pyetjen (nr 46): “A i keni parë lajmet me shenja në televizor gjatë muajit të kaluar?” (gjatë periudhës janar-shkurt 2015); 59 të anketuar nuk i kishin parë lajmet. Kur u krye analiza “chi-kuadrat” në rrethet ku jetonin të anketuarit dhe në lidhje me shpeshësinë e ndjekjes së lajmeve me shenja, u konstatuan diferencat gjeografike të konsiderueshme nga pikëpamja statistikore ndërmjet prefekturave ($\chi^2(23)=51,197$, $p<.001$). Për shembull, në Gjirokastrë, Kuçovë dhe Bulqizë numri i atyre që i kishin parë lajmet ishte i njëjtë me ata që nuk i kishin parë. Në të gjitha zonat e tjera, më shumë se 75% e të intervistuarve i ndiqnin lajmet me shenja (75-100%). Gjithashtu, i pyetëm edhe në lidhje me shpeshësinë e ndjekjes së lajmeve me shenja (pyetja nr. 47): Mesatarisht, lajmet ndiqeshin disa herë në muaj (82%) dhe vetëm 5% e të gjithë të anketuarve i ndiqnin lajmet përditë.

Të anketuarit u pyetën gjithashtu edhe për kanalet e ndryshme që ata përdornin për të ndjekur atë çka ndodh në Shqipëri dhe në pjesë të tjera të borës (pyetja nr. 48): a i shikojnë lajmet me shenja në televizor apo në faqet e internetit ku përdoret gjuha e shenjave, apo lexojnë gazetën dhe lajmet e shkruara në faqet e internetit? Gjithashtu, ata mund të zgjidhnin edhe opsione si për shembull, informohem vetëm duke parë televizor ose nga njerëzit e tjerë - nga njerëzit që e njohin ose që nuk e njohin gjuhën e shenjave. - Shumi-

ca e të anketuarve (87%, n=244/280) deklaruan se informacionet i merrnin nga lajmet në gjuhën e shenjave në televizor; 153 persona kërkojnë lajme në gjuhën e shenjave edhe në faqet e internetit; 120 të anketuar mbështeten te miqtë e tyre që njohin gjuhën e shenjave. Askush nuk u përgjigj se merrte informacion për lajmet nga njerëz që nuk e njohin gjuhën e shenjave.

Megjithatë, 174 persona u përgjigjën se mundohen të deshifrojnë përmbajtjen e lajmit duke parë imazhet në televizor. Kjo tregon jo vetëm nevojën për të marrë informacion nga çdo burim i mundshëm, por edhe që personat që nuk dëgjojnë mbështeten natyrshëm në çdo lloj media vizive. A i ndihmojnë lajmet me titra në shqip këta persona për të kuptuar më shumë lidhur me përmbajtjen? Meqenëse shumë kanale televizive në vendet perëndimore i transmetojnë programet e tyre me titra për personat me probleme në dëgjim, në të vërtetë ne e pyetëm audiencën që nuk dëgjon nëse titrat ishin të dobishme për të deshifruar përmbajtjen e programeve televizive. 387 persona (91%) nga 426 që iu përgjigjën pyetjes (nr. 28 në pyetësor), nuk i kuptonin fare ato. Vetëm dy (2) persona pohuan se i kuptonin shumë mirë dhe 37 me pak vështirësi. Megjithatë, për brezin e ri programet me titra janë më të kuptueshme sesa për brezin e vjetër (Tabela 21); dallimi mes grupmoshave është i konsiderueshëm edhe nga ana statistikore ($\chi^2(10)=19,217, p<.038$). Gjithashtu, duke i grupuar të anketuarit që iu përgjigjën pyetjes nr. 48 sipas moshës, mund të shohim se sa më i ri të jetë personi aq më shumë ai ose ajo i ndjek lajmet në gjuhën e shenjave. Gjithashtu, mund të shohim se përveç të qenit në kontakt me persona që njohin gjuhën e shenjave, të rinjtë janë më të interesuar të kërkojnë informacion nga të gjitha kanalet e mundshme krahasuar me brezin e vjetër (Tabela 22).

Tabela 21. Mosha e të anketuarve dhe të kuptuarit e titrave.

		Grupmoshat						Totali
		18-20	21-30	31-40	41-50	51-60	61-	
A i kuptoni titrat në gjuhën shqipe?	I kuptoj shumë mirë	0	0	1	1	0	0	2
		0%	0%	1%	1%	0%	0%	0%
	I kuptoj me vështirësi	5	9	7	7	4	0	32
		33%	9%	8%	4%	8%	0%	8%
	Nuk i kuptoj fare	10	88	84	146	48	12	388
			91%	91%	95%	92%	100%	92%
Total		15	97	92	154	52	12	422
		100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 22. Burimet e lajmeve për të anketuarit sipas grupmoshave. Shpërndarja e përgjigjeve pozitive e paraqitur në përqindje. (Disa zgjedhje ishin të mundshme.)

Si informoheni për lajmet?	18-20	21-30	31-40	41-50	51-60	61-
Duke lexuar gazetat dhe lajmet në internet	33 %	24 %	28 %	25 %	24 %	14 %
Nga faqe interneti që përdorin gjuhën e shenjave	93 %	58 %	38 %	26 %	9 %	7 %
Nga persona që përdorin gjuhën e shenjave	73 %	40 %	28 %	19 %	11 %	7 %
Kryesisht duke parë televizor	47 %	51 %	39 %	35 %	36 %	21 %

Në pikën e fundit të studimit tonë, mbetet për t'i dhënë përgjigje pyetjes së mëposhtme: A i përdorin të anketuarit krejtësisht analfabetë apo personat që lexojnë me vështirësi p.sh. gazetatat si burimet e tyre për lajme - siç përshkruhet në dy profilet e personave që nuk dëgjojnë të parashtruara nga Florjan Rojba në fund të Kapitullit 4.4? Nëse kryejmë ndër-tabulimin e rezultateve nga pyetja nr. 33 (detyra për lexim) dhe pyetja nr. 48, mund të dalim në përfundimin që më shumë se një e treta e të anketuarve analfabetë përpiqen disi të marrin informacion edhe nga tekstet me shkrim (shih Tabelën 23). Çfarë të bën më shumë përshtypje është se 10% e atyre personave të cilët u vetë deklaruan analfabetë (17 nga 163 të anketuar të cilët nuk donin t'i përgjigjeshin pyetjes 33 për shkak se ishin analfabetë, shih kapitullin 4.2.1), gjithashtu kërkonin informacion nga gazetatat.

Tabela 23. Suksesi në detyrën e leximit dhe marrja e informacionit nga tekstet e lajmeve të shkruara (pyetjet nr. 33 dhe nr. 48 të ndër-tabuluara).

		Të anketuarit që përfunduan detyrën e leximit (pyetja nr. 33 në studim)		Totali
		treguan se lexonin me vështirësi	treguan se nuk ishin të aftë të lexonin	
A lexoni gazeta dhe lajme të shkruara në faqe interneti?	JO	4 57 %	69 66 %	73 65 %
	PO	3 43 %	36 34 %	39 35 %
Totali		7 100 %	105 100 %	112 100 %

Mund të arrihet në përfundimin se për shumicën e të anketuarve në këtë studim, lajmet në gjuhën e shenjave janë burimi më i aksesueshëm dhe më i besueshëm për të mbledhur informacion mbi lajmet.

Mesazhe në grup në WhatsApp

Denis Ploça

Përshëndetje ekipi! Dua të kërkoj mendimin tuaj për pikën nr.34 të pyetësorit ku kërkohet nëse keni ndjekur ndonjëherë arsimin parashkollor dhe kur zgjedh opsionin "Jo", kalon tek pika nr.35 ku kërkohet nëse keni ndjekur ndonjëherë arsimin tetëvjeçar (në shkollën e nxënësve që nuk dëgjojnë). Kemi marrë disa përgjigje dhe nuk dimë se në cilën kategori t'i grupojmë. Disa nga personat e intervistuar kanë thënë se kanë shkuar në shkollë vetëm 2-3 ditë dhe më pas e kanë lënë sepse nuk u pëlqente, ishin mërzitur ose kishin filluar të ziheshin me njëri tjetrin dhe kështu ishin kthyer në shtëpi. Në këto kushte, nuk dimë se ku ti kategorizojmë përgjigjet e tyre. Mendoj se pika e fundit është më e përshtatshme, por do të doja të dija edhe mendimin tuaj.

Valmira Avdullaj

Përshëndetje. Unë dhe Jetmiri mbërritëm përpara një ore së bashku me V., personin që na shoqëroi. I përfunduam intervistat dhe brenda dy ditëve kryem tre intervista. Dje takuam disa persona që nuk dëgjojnë, të cilët ishin në klasë të gjashtë dhe të shtatë në shkollë dhe ishin shumë të vegjël për t'u intervistuar. Arritëm të intervistonim një 23-vjeçar që nuk dëgjonte, i cili kishte ndjekur shkollën. Ai përballej me shumë probleme komunikimi në familjen e tij. I kemi përshkruar problemet e tij në raport. V. na tregoi për një person që nuk dëgjonte, i cili me kalimin e moshës kishte humbur edhe shikimin. Ne arritëm ta intervistonim këtë person, sepse ai mund të komunikonte përmes alfabetit daktil. Më bëri shumë përshtypje sepse ishte hera e parë që takoja një person të tillë (që nuk shikon dhe nuk dëgjon), dhe u gëzova shumë. E nxita edhe Denisin që të fillojë të komunikojë me ta duke përdorur shenjat me prekje dhe ato manuale. - Harrova t'ju them se Denis dhe Irena ishin këtu. Pimë kafe së bashku, por u larguan sepse duhet të vazhdonin punën.

Florjan Rojba

Përshëndetje! Jam duke qarë dhe jam shumë e tronditur për shkak të kushteve të vështira të jetesës që Edi dhe Denisin më rrëfyan për këta persona që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. E falënderoj shumë Edin sepse ai bëri të mundur komunikimin me këta persona. Kjo gjë më gëzoi shumë. E falënderoj përsëri Edin dhe Denisin që raportuan për kushtet e vështira të këtyre personave. Kjo na detyron që t'i ndihmojmë ata që të dalin nga shtëpitë e tyre, të vijnë në shoqatën tonë, të përfshihen në veprimtari dhe t'u japim atyre të drejtën për një jetë më të mirë. Për të arritur këtë objektiv, duhet të punojmë dhe të këmbëngulim më shumë për ta. Unë dhe S. u tronditëm shumë tek shikonim intervistat. Qamë dhe na erdhi keq për ta, kur e vumë veten në vend të këtyre personave që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë. Ata bëjnë një jetë kaq të vështirë. Duhet të ndihen shumë të vetmuar, pa asnjë aktivitet, thjesht hanë dhe flenë. Kaq. Falënderoj përsëri Edin dhe Denisin. Ju dua kaq shumë.

Denis Ploça

Përshëndetje! Kjo është hera e dytë që komunikojmë bashkë dhe kam disa informacione për të ndarë me ju. Në disa raste, disa prej tyre zgjedhën opsionin "Jo" në pikën 34, në pikën 35 zgjedhën opsionin "Po", ndërsa për pikën 35 zgjedhën opsionin "Kisha frikë të shkoja në shkollë për shkak të dhunës/ngacmimeve". Kështu që pati disa raste kur personat e zgjidhnin këtë opsion sepse ndiheshin të dhunuar ose kishin frikë të qëndronin qoftë edhe një ditë në shkollë, ose nuk arrinin të mësoheshin me shkollën dhe ktheheshin në shtëpi. Dëshiroj ta ndaj këtë me ju si një shembull për të treguar se kjo është bërë shkak që ata të mos shkojnë në shkollë, duke iu mohuar kështu e drejta për arsimim.

Florjan Rojba

Përshëndetje ekipit intervistues. Tema e sugjeruar nga Valmira është shumë e rëndësishme. Ju lutem shkruani në lidhje me çdo situatë që keni hasur gjatë intervistave, për shembull rasti i përmendur nga Valmira Avdullaj për personin e intervistuar që nuk kishte shkuar kurrë në shkollë. Ka disa raste të tjera kur prindërit janë të shqetësuar se kush do të kujdeset për fëmijët e tyre kur ata të ndërrojnë jetë. Duhet t'i përmbledhni të gjitha rastet në raport në mënyrë që ato të përdoren si shembuj për institucionet përgjegjëse rreth situatës së vështirë të personave që nuk dëgjojnë dhe masat që duhet të ndërmerren nga këto institucione për të përmirësuar situatën, sepse personat që nuk dëgjojnë kanë probleme me komunikimin dhe e kanë të pamundur të bëjnë një jetë të pavarur. Ky është një nga shqetësimet e ngritura nga prindërit. Ju lutem, shënoni të gjitha rastet që keni hasur sepse kjo është detyra juaj dhe është shumë e rëndësishme. Ju uroj suksese në punën tuaj dhe mirupafshim!

Denis Ploça

Përshëndetje! Kam një pyetje për ju. E hasëm këtë problem gjatë intervistave dhe lidhet me pyetjen nr. 26 në pyetësor e cila thotë "kur shkoni në bankë...". Nga të tre personat e intervistuar për këtë pyetje, ata thanë se shkojnë vetëm në bankë. Ne i pyetëm se pse shkojnë vetëm. Ata u përgjigjën se baballarët e tyre ishin të gatshëm t'i ndihmonin, por ata kishin frikë se mos ata u vidhnin pensionin. Kjo ishte arsyeja pse ata preferonin të shkonin vetëm. Ne i pyetëm se si komunikonin në bankë dhe ata thanë se komunikonin përmes formularit. Në këto kushte, nuk e di se ku ta kategorizoj përgjigjen e tyre në formular. Ndoshta pika e fundit është më e përshtatshme "persona të tjerë". Kështu që pyetja është nëse duhet ta kategorizoj në këtë pikë apo jo.

Erkid Hatia

Përshëndetje ekipit intervistues! Dje përfunduam 5 intervista, ndërsa sot intervistua 4 vajza dhe 4 djem, 8 persona në total. Si përfundim, në total janë 13 persona që nuk dëgjojnë për dy ditë. Jemi të kënaqur me punën e bërë deri më tani. U lodhëm shumë në fshatrat e thellë të Korçës sepse ishte shumë ftohtë. Shoqëruesi ynë na tha se nesër do të shkojmë në Maliq ku do të mund të intervistojmë 5 ose 6 persona që nuk dëgjojnë. U gëzuam shumë për këtë. Shpresoj të kryej 10 intervista nesër. Gjithashtu, shpresoj të kryej 36 intervista në total. Ju uth dhe ju përqafoj.

Valmira Avdullaj

Kjo është videoja e dytë. Intervistat me personat që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë ishin shumë të rëndësishme. Ishte një sukses i madh që i intervistua mes këtij numri kaq të madh personash që nuk dëgjojnë. Pavarësisht vështirësive në komunikim dhe ngarkesës së dyfishtë me punë sepse nuk shikonin dhe njëkohësisht nuk dëgjonin, ne u përpoqëm disa herë të arrinim komunikim bazë, madje duke i ftuar edhe për kafe për të krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe për të krijuar një lloj marrëdhënieje mes nesh. Takimi dhe komunikimi me personat që nuk dëgjonin dhe nuk shikonin ishte shumë i rëndësishëm dhe emocionues. Për herë të parë këta persona ishin në qendër të vëmendjes, duke qenë se janë mësuar të qëndrojnë të izoluar brenda shtëpive të tyre. Komunikimi dhe intervistat me ta duhet të konsiderohen si sukses për ne. Kur të vijë Denisi, ai mund t'ju japë më shumë hollësi dhe informacione për punën e tij. Ju falënderoj për komentet pozitive në lidhje me videon. Ndërkohë, ne po presim bashkëshorten e I. këtu në kafene për një intervistë. Mirupafshim!



5

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Florjan Rojba dhe Inkeri Lahtinen



Qëllimi i këtij studimi ishte sigurimi i informacionit për personat e rritur që nuk dëgjojnë në Shqipëri, mundësitë e tyre për ndërveprim me njerëzit në jetën e përditshme, statusin e gjuhës së shenjave dhe gjuhës së shkruar në jetën e tyre, aksesin e tyre në informacion dhe shërbimet e interpretimit dhe në çfarë mënyre ka shërbyer arsimit i ofruar në shkollën e veçantë për personat që nuk dëgjojnë në aftësitë e tyre gjuhësore me qëllim që të përmbushin kërkesat e shoqërisë që i rrethon, në kuadër të neneve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) lidhur me personat që nuk dëgjojnë dhe gjuhën e shenjave.

Bazuar në rezultatet e studimit mund të deklarohet, si konkluzion i përgjithshëm, se popullsia që nuk dëgjon në Shqipëri nuk gëzon mundësi të njëjta si personat që dëgjojnë në lidhje me jetesën e pavarur, të drejtën për arsim të përgjithshëm dhe studime të mëtejshme, të drejtën për punësim që i përshtatet potencialit dhe informacion.

Paragrafët në vijim japin një vështrim të shkurtër mbi kuadrin ligjor në lidhje me zbatimin e KDKPAK-së, më pas pasqyrohet situata aktuale në çdo fushë të studimit dhe në fund parashtrohen rekomandimet për masat që përqendrohen në fazat kyçe gjatë jetës së një personi që nuk dëgjon. Rekomandimet përbëjnë një kuadër dhe një udhërrëfyes që mund të përdoren në bashkëpunime të mëtejshme ndërmjet grupeve përkatëse të interesit dhe ANAD-it, si aktori kyç që përfaqëson grupin e fokusit.

5.1 Komente të përgjithshme

Pas ratifikimit të KDKPAK-së në vitin 2013, ministritë dhe institucionet përgjegjëse shqiptare kanë punuar në mënyrë aktive për të analizuar dhe rishikuar legjislacionin aktual dhe gradualisht kanë përfshirë gjithmonë e më tepër si ekspertë gjatë procesit organizatat që përfaqësojnë aftësinë e kufizuar. Kjo vlen për t'u përhëndetur dhe bashkëpunimi pritet që të zhvillohet në një dialog më të strukturuar në planifikimin afatgjatë dhe përgatitjen e nismave. Ratifikimi i Protokollit Opsional vijon ende në punë e sipër. Kjo mund të shikohet si një shenjë e cila tregon se Shqipëria e ka marrë seriozisht detyrën për të ndryshuar dhe harmonizuar legjislacionin e saj në përputhje me KDKPAK-në përpara ratifikimit të tij.

Gjuha e shenjave është njohur zyrtarisht në Shqipëri në vitin 2014, gjë e cila i jep kësaj gjuhe status juridik, megjithatë, formulimi nuk e përcakton atë si gjuhë minoritare. Ligji *Për arsimin parauniversitar*¹³ i vitit 2012 u garanton studentëve të drejtën për të ko-

¹³ Ligji nr. 69/2012, neni 63 <http://www.crca.al/albanian-legislation/national-laws>

munikuar në gjuhën e shenjave. Megjithatë, formulimi është shumë i vakët dhe neni nuk është vënë në zbatim. Situata juridike e personave me aftësi të kufizuara është rishikuar në korrik të vitit 2014 kur Shqipëria miratoi ligjin kuadër *Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*¹⁴. Në dhjetor të vitit 2014 u miratuan katër akte nënligjore sipas këtij ligji kuadër, ku njëri përcaktonte rolin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar përgjegjës për monitorimin e zbatimit, dhe në këshill janë të përfaqësuara edhe organizatat për aftësinë e kufizuar.

Akti nënligjor *Përcaktimi i masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara* pas nenit 11 të ligjit kuadër, i specifikon për herë të parë personat që nuk dëgjojnë si një grup në nevojë për masa dhe shërbime në lidhje me aksesueshmërinë (paragrafët 1.2 a dhe 1.3 c). Në rregullat e tij të veçanta nr. 12-18 akti nënligjor parashikon masa për shërbime përkthimi në gjuhën e shenjave, mësimdhënien në gjuhën e shenjave në arsim, trajnimin e interpretëve, botimin e fjalorit për gjuhën e shenjave dhe ofrimin e transmetimeve të rregullta të lajmeve me titra por edhe në gjuhën e shenjave në televizionin kombëtar.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020 u hartua në bashkëpunim me komunitetin e aftësisë së kufizuar në Shqipëri dhe u përfundua në prill 2016. Në kohën e formulimit të këtij raporti ky plan pret të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Në planin e veprimit janë përfshirë masa konkrete me indikatorë për trajnimin e instruktorëve dhe asistentëve në klasa për gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë dhe në një fazë të mëvonshme edhe i interpretëve të gjuhës së shenjave.

Më pas parashtrihen rekomandime për nivelin e zbatimit se si mund të garantohen më tej përgjegjësitë e deklaruar në nenet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) për personat që nuk dëgjojnë dhe gjuhën e shenjave. Zbatimi i rekomandimeve do të kërkojë një angazhim të fortë nga disa ministri të linjës për një bashkëpunim ndërministror si edhe bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë ANAD si eksperte dhe përfaqësuese e nevojave të komunitetit të personave që nuk dëgjojnë. Përveç ndryshimit të mëtejshëm të legjislacionit të nevojshëm, nismat duhet të marrin burimet e kërkuara buxhetore dhe të garantohet zbatimi i tyre përgjatë periudhave të mandatit elektoral.

5.2 Rekomandime

Ekziston nevoja për të ndryshuar paradigmen nga konsiderimi i mungesës së dëgjimit vetëm si gjendje mjekësore në një model shoqëror të mungesës së dëgjimit ku gjuha e shenjave të njihet si gjuha e parë mëmë e popullatës së personave që nuk dëgjojnë. Një hap drejt kësaj qasjeje është që gjuha shqipe e shenjave të marrë statusin e gjuhës minoritare. Në momentin që popullsia e personave që nuk dëgjojnë nuk do të shihet më vetëm si një grup me aftësi të kufizuara por edhe si një minoritet gjuhësor, të gjitha palët përgjegjëse do të përftojnë instrumente më të mira për të trajtuar pengesat gjuhësore me të cilat popullsia e personave që nuk dëgjojnë përballet gjatë gjithë jetës dhe që konfirmohen qartësisht në këtë studim.

¹⁴ Ligji nr. 93/2014 http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/ligj_nr_93_dt_24_7_2014.pdf

5.2.1 Zbulimi dhe ndërhyrja e hershme

Rezultatet e vrojtimit në kapitullin 4 tregojnë se fëmijët që nuk dëgjojnë kanë komunikim të pakët brenda familjes së tyre. Kjo përshkruhet edhe në seksionin që përshkruan jetën e përditshme të personave që nuk dëgjojnë, i përgatitur nga Florjan Rojba, dhe në shumë raporte nga terreni lidhur me gjuhën e shenjave. Shumica e fëmijëve që nuk dëgjojnë lindin në familje që nuk kanë probleme të tilla dhe fëmijët me këto probleme, ndryshe nga anëtarët e minoriteteve të tjera që përdorin gjuhën e folur, nuk mund ta mësojnë gjuhën e shenjave në mënyrë të natyrshme në familjet ku rriten. Prindërit nuk mund të komunikojnë me fëmijët që nuk dëgjojnë përveç se nëpërmjet gjesteve dhe shenjave bazike që përdoren në shtëpi. Duke qenë se fëmijët nuk ekspozohen ndaj gjuhës së shenjave gjatë viteve të hershme të jetës, mësimi i gjuhës nga ana e tyre nuk zhvillohet normalisht. Fëmijët që nuk dëgjojnë mund të arrijnë moshën shkollore pa pasur në fakt asnjë aftësi gjuhësore, gjë që ndikon negativisht në mundësitë e tyre për t'u zhvilluar dhe për të mësuar.¹⁵

Aktualisht, fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe që janë në moshë parashkollore në Shqipëri nuk u ofrohet mjedisi i nevojshëm me shenja që mbështet të drejtat e tyre gjuhësore dhe zhvillimin e tyre, ndaj situata e tyre nuk është në pajtim me legjislacionin shqiptar; Ligji *Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve* (2010)¹⁶ nen 5 “Parime të përgjithshme”, kapitulli 2 ndër të tjera parashikon “Barazi dhe mosdiskriminim pavarësisht... aftësisë së kufizuar, gjuhës ose ndonjë statusi tjetër të fëmijës ose prindërve të tij/saj.” Në nenin 30 “Fëmijët me aftësi të kufizuara”, kapitulli 3, parashikohet se: “...për fëmijët me aftësi të kufizuara përcaktohet kujdes i veçantë për të garantuar pjesëmarrjen e tij/saj efikase... duke zhvilluar siç duhet kapacitetet e tij/saj individuale për të arritur integritetin social, kulturor dhe shpirtëror në masën më të madhe të mundshme” (theksuar nga redaktuesi). Gjithashtu, ndërkohë që fëmijët që nuk dëgjojnë nuk njihen nga ana juridike si anëtarë të një minoriteti gjuhësor ose etnik, situata e tyre mund të krahasohet me atë të fëmijëve të minoriteteve etnike, të cilët sipas nenit 31 të ligjit të mësipërm “kanë të drejtë të shprehin plotësisht dhe lirisht trashëgiminë e tyre kulturore dhe gjuhësore”.

Neni 23 i KDPAK-së “Respekti për shtëpinë dhe familjen” kërkon që autoritetet shtetërore të garantojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë të drejta të barabarta për sa i përket jetës familjare. Prindërit duhet të marrin informacione, shërbime dhe mbështetje të hershme dhe gjithëpërfshirëse për përgjegjësitë e tyre për rritjen e fëmijës, duke garantuar marrëdhënien prind-fëmijë, duke përfshirë mbështetje të aksesueshme dhe përfshirëse nga komuniteti. Neni 30 i KDPAK-së “Pjesëmarrja në veprimtaritë kulturore, zbavitëse, të kohës së lirë dhe sportive”, në paragrafin 4 e specifikon këtë më qartësisht kur shprehet se: “Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtë, në mënyrë të barabartë me të tjerët, që t'u njihet dhe mbështetet identiteti i tyre specifik kulturor dhe gjuhësor, duke përfshirë gjuhën e shenjave dhe kulturën e personave që nuk dëgjojnë”.

¹⁵ Studimi i aftësive të kufizuara shtesë për popullsinë që nuk dëgjon nuk ka qenë qëllimi i këtij vrojtimi. Megjithatë, mund të pritet që mungesa e një zhvillimi gjuhësor normal rrit prevalencën e aftësive të tjera të kufizuara - vështirësi konjitive dhe të të mësuarit etj. - që vëzhgohen në shkollë.

¹⁶ Ligji nr. 10347/2010 <http://www.crca.al/albanian-legislation/national-laws>

Federata Botërore e Personave që nuk Dëgjojnë (WFD) aktualisht po përgatit një Deklaratë zyrtare për të Drejtat Gjuhësore të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë.¹⁷ Drafti paraqet literaturë kërkimore gjithëpërfshirëse ku tregohet se mësimi i gjuhës së shenjave që në moshë të hershme është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm gjuhësor dhe kjo ofron mbështetje për kompetencat e fëmijëve që nuk dëgjojnë në gjuhët kombëtare. Ekspozimi i hershëm ndaj gjuhës së shenjave dhe shumëgjuhësisë, kombinuar me një mbështetje të fortë të familjes për gjuhët e shenjave, i përgatit më mirë fëmijët për pjesëmarrje efikase në të ardhmen në shoqëri. WFD i nxit fort qeveritë që të zbatojnë programe që mbështesin mësimin e gjuhës së shenjave për anëtarët e familjes dhe kujdestarët e fëmijëve që nuk dëgjojnë, në bashkëpunim me komunitetet e personave që nuk dëgjojnë dhe mësuesit e gjuhës së shenjave për ata që nuk dëgjojnë.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara aktualisht po harton udhëzime për procedura raportuese të thjeshtësuara për raportimin periodik. Në pajtim me draft-deklaratën për të Drejtat Gjuhësore të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë, WFD i kërkon Komitetit të KDPAK-së të përfshijë pyetje për masat (përfshirë masat buxhetore) që garantojnë mësimin e gjuhës së shenjave, duke përfshirë mësimin e gjuhës së shenjave falas që në moshë të hershme për fëmijët që nuk dëgjojnë dhe familjet e tyre. Udhëzimet e rishikuara për raportimin periodik janë parashikuar që të përdoren që nga viti 2017.

Masat e propozuara kur një fëmijë diagnostikohet se nuk dëgjon janë:

- Prindërve t'u ofrohet informacion mbi mungesën e dëgjimit, gjuhën e shenjave dhe kulturën e personave që nuk dëgjojnë; potencialin e fëmijëve për të mësuar pavarësisht se ata kanë humbur dëgjimin, rolin shumë të rëndësishëm të zhvillimit gjuhësor si dhe mbështetjen dhe mënyrat e arsimit që janë të disponueshme.
- Informacioni duhet të ofrohet në të gjitha nivelet e pikave të kontaktit ku prindërit drejtohen bashkë me fëmijët e tyre që nuk dëgjojnë: qendrat lokale të kujdesit shëndetësor dhe zyrat e mirëqenies sociale dhe në veçanti komisionet mjekësore që vlerësojnë dhe përcaktojnë aftësinë e kufizuar të fëmijës. Prindërve duhet t'u ofrohet këshillim, broshura informuese dhe të dhënat e kontaktit të ANAD-it. Shoqatat e prindërve me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe në veçanti për ata me fëmijë që nuk dëgjojnë janë të rëndësishme për mbështetje nga prindërit e tjerë në të njëjtën situatë, megjithatë, në Shqipëri ende nuk ekzistojnë organizata të tilla.
- Punonjësve të rrjetit të kujdesit shëndetësor dhe social që janë në kontakt me prindër të fëmijëve që nuk dëgjojnë duhet t'u ofrohet trajnim dhe informacione se si të këshillojnë prindërit për temat e lartpërmendura dhe ku t'i drejtojnë prindërit për informacione të mëtejshme.
- Një fëmijë që nuk dëgjon ka nevojë të ekspozohet në mjedisin e gjuhës së shenjave për të maksimizuar zhvillimin e tij/saj dhe potencialin për të mësuar. Prindërit duhet të nxiten që të kontaktojnë me të rritur që nuk dëgjojnë dhe jetojnë brenda vendit që fëmijët të shikojnë gjuhën vendase të shenjave dhe të përmbushin nevojën e natyrshme për të ndërvepruar. Këtu ANAD-i dhe rrjeti i tij lokal mund t'i ndihmojë si për të gjetur modelet më të përshtatshme të gjuhës që përdoret nga të rriturit që nuk dëgjojnë dhe për të mundësuar takimet me ta.

Në terma afatgjatë, pasi të jenë të disponueshme burimet për trajnues të gjuhës së shenjave:

- Prindërve dhe familjeve duhet t'u jepen kurse falas për të mësuar gjuhën e shenjave për të lehtësuar komunikimin me fëmijën e tyre që nuk dëgjon. Mund të vihet në zbatim pasi të jetë trajnuar një numër i mjaftueshëm instruktorësh të gjuhës së shenjave (shih seksionet për arsimin më poshtë).

Të gjitha masat që lidhen me shërbimet e lartpërmendura duhet t'u ofrohen prindërve pa kosto për të garantuar sa më shumë pjesëmarrje dhe sa më pak shpenzime nga prindërit që të jetë e mundur. Ky investim do të sjellë kursime në të ardhmen duke ulur nevojën për arsim dhe terapi për nevojat e veçanta.

5.2.2 Arsimi bazë

KDPAK-ja i detyron autoritetet shtetërore që t'u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë në arsim duke mundësuar mësimin e gjuhës së shenjave dhe promovimin e identitetit gjuhësor të komunitetit të personave që nuk dëgjojnë (neni 24.3 germa b). Personat që nuk dëgjojnë duhet të marrin arsim në gjuhët, mënyrat dhe mjetet e komunikimit që janë më të përshtatshme për individin dhe në mjedise që maksimizojnë zhvillimin akademik dhe social (neni 24.3 germa c). Autoritetet shtetërore duhet të punësojnë dhe trajnojnë mësues që janë të kualifikuar për gjuhën e shenjave (neni 24.4). Personave që nuk dëgjojnë duhet t'u sigurohet përshtatje e arsyeshme në mënyrë që ata të kenë akses në arsimin e mëtejshëm në nivel të barabartë me të tjerët (neni 24.5).

Gjetja më interesante e studimit është se 97% e të rriturve që nuk dëgjojnë janë analfabetë funksionalë. Analfabetizmi në popullsinë e personave që nuk dëgjojnë është pesë herë më i lartë se sa në grupet e tjera të personave me aftësi të kufizuara (20%) dhe 35 herë më i lartë se sa në popullsinë e personave pa aftësi të kufizuara (2,8%). Rezultatet janë edhe më befasuese duke qenë se shumica e personave që nuk dëgjojnë dhe janë analfabetë (74%) të grupit të synuar të studimit ka mbaruar arsimin bazë, duke pasur parasysh që shkak për analfabetizmin në dy grupet e tjera (me aftësi të kufizuara dhe pa aftësi të kufizuara) në pjesën më të madhe mund të shpjegohet nga mosfrekuentimi i arsimit.

Problemi kryesor që qëndron pas këtij fakti mund të jetë komunikimi dhe ndërveprimi i dobët ndërmjet nxënësve dhe mësuesit për shkak se mungon një gjuhë e përbashkët komunikimi. Kjo u raportua në vërtetim nga të rriturit që nuk dëgjojnë kur u pyetën për mënyrën e komunikimit që përdorej nga mësuesit dhe është konfirmuar edhe nga një studim i kohëve të fundit i kryer nga Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë në Tiranë¹⁸.

¹⁸ Zëvendësministri i Arsimit dhe Sporteve (MAS) ngriti një grup pune të përbërë nga MAS, ANAD, Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, Drejtoria Arsimore e Tiranës dhe Universiteti i Tiranës për të studiuar situatën në arsimin e personave që nuk dëgjojnë dhe për të përgatitur rekomandimet për përmirësim. Në shkurt të vitit 2016 Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe ANAD kryen një studim për aftësitë e mësuesve të nxënësve që nuk dëgjojnë për të komunikuar në gjuhën e shenjave dhe për rezultatet e nxënësve në mësimin e gjuhës së shkuruar shqipe dhe matematikë. Si përmbledhje, vetëm 30% (9 nga 31) e mësuesve e kuptuan videon e testimit në gjuhën shqipe të shenjave dhe vetëm 3% (1 në 31) ishin në gjendje të përdornin gjuhën shqipe të shenjave. Nxënësit që nuk dëgjonin patën rezultate mesatare të kënaqshme në testimin e leximit në shqip. Megjithatë, në institut mësohet mesatarisht vetëm gjysma (35-60%) e kurrikulës kombëtare në gjuhë shqipe. Për shkak të kurrikulës së shkurtuar, rezultatet e testimit të nxënësve të institutit të cilët vlerësohen njësoj si në arsimin e përgjithshëm duhet të konsiderohen si shumë më të ulëta. Raporti përfundimtar iu dorëzua zëvendësministrit të MAS në prill 2016 dhe përfshinte rekomandimet afatshkurtra dhe afatgjata.

Vrojtimi për shkollën shpjegon rezultatet e dobëta që kanë në shkollë nxënësit që nuk dëgjojnë, gjë e cila nga ana e saj shpjegon nivelin e ulët të alfabetizimit tek të rriturit që nuk dëgjojnë, të cilët ishin diplomuar nga instituti dhe u intervistuan gjatë vrotimit të popullsisë.

Sipas rezultateve të të dy vrotimeve, aktualisht, sistemi i arsimit për nxënësit që nuk dëgjojnë nuk është në pajtim as me legjislacionin shqiptar dhe as me nenet e KDPAK-së për arsimin. Për shkak të arsimit bazë të dobët, personat që nuk dëgjojnë nuk kanë akses në arsimin e mëtejshëm - arsimi dytësor i lartë ose shkollë e mesme.

Për të ndryshuar situatën aktuale, gjuha e mësimdhënies në arsimin bazë duhet të ndryshohet në gjuhën e shenjave nëpërmjet së cilës studentët që nuk dëgjojnë mund të mësojnë formën e shkruar të gjuhës së folur (metodë e arsimit dygjuhësor). Kjo kërkon trajnimin e instruktorëve të gjuhës së shenjave për personat që nuk dëgjojnë, të cilët duhet të trajnojnë mësuesit që dëgjojnë që ata të komunikojnë rrjedhshëm në gjuhën e shenjave dhe në një afat të gjatë të trajnojnë mësuesit e klasave me nxënës që nuk dëgjojnë. Gjithashtu, nxënësit që nuk dëgjojnë kanë nevojë dhe të drejtë të studiojnë gjuhën e shenjave si gjuhë amtare ose gjuhë të parë, gjë e cila kërkon trajnimin e instruktorëve/mësuesve të specializuar në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë. Për të optimizuar nxënien dhe komunikimin ndërmjet mësueses në klasë (e cila dëgjon) dhe nxënësve, në klasë nevojiten asistentë për nxënësit që nuk dëgjojnë, të cilët komunikojnë rrjedhshëm në gjuhën shqipe të shenjave. Ata shërbejnë edhe si një model i rritur gjuhe për nxënësit që nuk dëgjojnë.

Masat e propozuara për të krijuar mundësi dhe një mjedis optimal nxënieje për studentët që nuk dëgjojnë:

- Ka një nevojë urgjente për të trajnuar përdorues vendas të gjuhës si instruktorë të gjuhës së shenjave për t'i mësuar, si gjuhë të dytë/të huaj, gjuhën e shenjave mësuesve dhe edukatorëve që dëgjojnë të fëmijëve që nuk dëgjojnë.
- Mësuesit dhe edukatorët e fëmijëve që nuk dëgjojnë duhet të mësojnë gjuhën e shenjave si gjuhë të dytë/të huaj. Aftësitë gjuhësore duhet të jenë një kriter për të punuar me fëmijët që nuk dëgjojnë.
- Trajnimi për gjuhën e shenjave për mësuesit dhe edukatorët që dëgjojnë duhet të organizohet si trajnim shtesë gjatë kohës që ata janë në marrëdhënie pune.
- Trajnimi për gjuhën e shenjave për mësuesit që synojnë të specializohen në arsimimin e nxënësve që nuk dëgjojnë duhet të organizohet si trajnim përpara se ata të hyjnë në marrëdhënie pune.
- Trajnimi i asistentëve në klasa për fëmijët që nuk dëgjojnë dhe punësimi i tyre në klasat ku shumica e fëmijëve nuk mund të komunikojnë në një mënyrë tjetër përveç se komunikimit me shenja/pamor.
- Fëmijëve që nuk dëgjojnë duhet t'u mësohet gjuha shqipe e shenjave si lëndë e gjuhës amtare/gjuhës së parë.
- Instruktorët e gjuhës së shenjave për personat që nuk dëgjojnë duhet të trajnohen si instruktorë të gjuhës shqipe të shenjave si gjuhë amtare/gjuhë e parë për fëmijët që nuk dëgjojnë.

- Kostot e transportit nga shtëpia në shkollë duhet të jenë të përballueshme për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve që nuk dëgjojnë në mënyrë që të mos përbëjnë pengesë për arsimimin e tyre.
- Nuk ka të dhëna të mbledhura në mënyrë strukturore për rezultatet në nxënie të fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe atyre që kanë probleme me dëgjimin, të përfshirë në arsimin e përgjithshëm bazë. Për të pasur një këndvështrim gjithëpërfshirës të situatës së arsimit për fëmijët që nuk dëgjojnë në Shqipëri, ekziston nevoja për të kryer një studim edhe në arsimin e përgjithshëm.

Në terma afatgjatë, pasi aftësitë e tyre gjuhësore të jenë zhvilluar mjaftueshëm,

- mësuesve dhe edukatorëve që dëgjojnë duhet t'u ofrohen trajnime në metodat dygjuhëshe të mësimdhënies (për personat që nuk dëgjojnë) si trajnim gjatë kohës që ata janë në marrëdhënie pune.
- mësuesve që synojnë të specializohen në arsimitin e nxënësve që nuk dëgjojnë duhet t'u ofrohen trajnime në metodat dygjuhëshe të mësimdhënies (për personat që nuk dëgjojnë) si trajnim përpara se ata të hyjnë në marrëdhënie pune.

Një pjesë e rekomandimeve të lartpërmendura janë përfshirë në raportin përfundimtar (të papublikuar) të grupit të punës për zhvillimin e arsimit për nxënësit që nuk dëgjojnë (shih shënimin 18 në fund të faqes) që është dorëzuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në prill 2016.

5.2.3 Arsimiti dytësor i lartë, shkolla e mesme dhe arsimiti i lartë

Aktualisht nuk ka mundësi arsimimi në gjuhën e shenjave për nxënësit që nuk dëgjojnë pas klasës së 9-të. Për shkak të nivelit të dobët në shkrim dhe lexim dhe pa pasur mundësinë e interpretëve gjatë mësimin, praktikisht nxënësit që nuk dëgjojnë nuk mund të ndjekin arsimin dytësor të lartë apo shkollën e mesme. Ata përjashtohen de facto nga arsimimi i mëtejshëm. Kjo automatikisht bllokoi mundësitë e tyre për në arsimin e lartë. Është e qartë se në këtë drejtim nxënësit që nuk dëgjojnë nuk janë në një pozicion të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre që dëgjojnë dhe kjo bie drejtpërsëdrejti në kundërshtim me ligjin "Për arsimin parauniversitar" dhe nenin 24 të KDPAK-së, që u diskutua më lart.

Masat e propozuara:

- Ngritjen e një arsimit dytësor të lartë dhe/ose një shkolle të mesme për nxënësit që nuk dëgjojnë me mundësi për trajnim profesional në një gamë më të gjerë profesioneve nga sa ofrohet tani në arsimin bazë (d.m.th. marangoz, këpucari, rrobaqepësi). Mundësitë duhet të përshtatet më mirë me aftësitë, interesat dhe nevojat e nxënësve që nuk dëgjojnë në tregun e ardhshëm të punës.
- Përfshirjen e orëve shtesë në gjuhë shqipe në kurrikulën e arsimit dytësor të lartë dhe/ose shkollës së mesme për nxënësit që nuk dëgjojnë për të garantuar përmirësimin e aftësive të tyre të dobëta në gjuhë shqipe gjatë trajnimit profesional.

- Ofrimin e përkthimit në gjuhën e shenjave në çdo klasë derisa mësuesit që dëgjojnë të komunikojnë rrjedhshëm në gjuhën e shenjave dhe/ose personat që nuk dëgjojnë të trajnohen si mësues.
- Trajnimin e interpretëve në mësim që duhet të ofrohen pa pagesë për të gjithë nxënësit që nuk dëgjojnë në arsimin e mëtejshëm në arsimin e përgjithshëm dytësor të lartë dhe në arsimin e lartë, sipas dëshirës së tyre.

5.2.4 Punësimi

Personat që nuk dëgjojnë të zgjedhur për vrojtimin treguan një shkallë më të lartë punësimi se sa grupet e tjera me aftësi të kufizuara ose grupi i përcaktuar si me pamundësi totale për të dëgjuar në popullsinë e përgjithshme (Census 2011). Megjithatë, personat që nuk dëgjojnë që ishin punësuar ose vetëpunësuar ushtronin profesione të pakualifikuara, me pagë të ulët dhe joakademike. Kjo është e kuptueshme duke pasur parasysh se rruga e tyre në arsim përfundon në klasë të 9-të dhe se Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë ofron orientim vetëm në tre profesione: marangoz dhe këpucari për djemtë dhe rrobaqepësi për vajzat.

Legjislati ndalon të gjitha format e diskriminimit në fushën e punësimit për shkak të aftësisë së kufizuar, duke qenë kështu në harmoni me nenin 27 të KDPAK-së për punën dhe punësimin. Gjithashtu, ligji *Për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara*¹⁹, në nenin 15 të tij përcakton se nga 25 punonjës njëri duhet të jetë person me aftësi të kufizuara. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji ka një nivel të ulët dhe sanksionet për mospërmbushjen e kuotave nuk janë detyruese. Megjithëse punësimi i personave me aftësi të kufizuara mbështetet nëpërmjet programeve të ndryshme për nxitjen e punësimit, ato kanë sjellë rezultate të dobëta, në veçanti në lidhje me gratë me aftësi të kufizuara.²⁰

Në terma afatgjatë, nëse masat e paraqitura në seksionin e mëparshëm zbatohen, personat që nuk dëgjojnë duhet të kenë mundësi të barabarta për të aplikuar për arsim të mëtejshëm dhe për të gjetur punë në profesionet që ata dëshirojnë dhe që u përgjigjen më mirë kërkesave të tyre për punën. Megjithatë, në terma afatshkurtër, edhe pse të rriturit që nuk dëgjojnë janë fizikisht të aftë për të punuar, pengesat kryesore në punësimin e tyre janë pengesat gjuhësore, të theksuara nga analfabetizmi i vërtetuar dhe disavantazhi i tyre për t'u futur në rrjetet e informacionit ku qarkullon informacioni për shumicën e mundësive për punë. Duke qenë se sistemi i arsimit nuk u ka shërbyer mirë personave që nuk dëgjojnë gjatë viteve të tyre shkollore, duhet të ofrohen programe trajnimi pa pagesë për t'u mësuar shkrim e lexim të rriturve që nuk dëgjojnë, si një rrugëzgjidhje për të shtuar mundësitë për një punësim më të mirë. Gjithashtu, informacionet për programet e punësimit dhe promovimeve të tjera duhet të reklamohen në gjuhën e shenjave. Sapo të hyjë në një program punësimi, në një trajnim për punësim ose në një vend pune, duhet të ofrohet automatikisht mundësia për të përdorur një interpret të gjuhës së shenjave.

¹⁹ Ligji nr. 7995/1995, i ndryshuar 1999, 2002 dhe 2006) [www.kerkojpune.gov.al/wp.../02/ligji_i_nxitjes_se_punesimit.pdf](http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2015/02/ligji_i_nxitjes_se_punesimit.pdf)

²⁰ Raporti përfundimtar për programet për nxitjen e punësimit në Shqipëri 2008 – 2014, RisiAlbania, dhjetor 2014 <http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2015/02/EPP-FINAL-REPORT.pdf>

Masat e propozuara:

- Ofrimi i trajnimit në gjuhën shqipe si gjuhë e dytë për të rriturit që nuk dëgjojnë.
- Organizimi i trajnimeve shtesë për mësuesit që kanë përvojë në mësimin e gjuhës shqipe për të huajt dhe specializimi i tyre për t'i mësuar gjuhën shqipe si gjuhë të dytë të rriturve që nuk dëgjojnë. Specializimi kërkon trajnim shtesë dhe, ndër të tjera, njohuri bazë të gjuhës së shenjave dhe kulturës së personave që nuk dëgjojnë.
- Informimi i popullatës së të rriturve që nuk dëgjojnë në gjuhën e shenjave për programet për nxitjen e punësimit nëpërmjet transmetimeve televizive dhe faqeve përkatese të internetit për shërbimet publike.
- Ofrimi i përkthimit pa pagesë në gjuhën e shenjave për të rriturit që nuk dëgjojnë që ndjekin çdo program për nxitjen e punësimit, trajnime shtesë ose trajnime në vendin e punës.
- Ofrimi sipas nevojave dhe pa pagesë i shërbimeve të përkthimit për punëdhënësit dhe punëmarrësit që nuk dëgjojnë.
- Organizimi ose lehtësimi i trajnimeve për vetëpunësim (planet e biznesit, administrim dhe llogari, etj.) me përkthim në gjuhën e shenjave, me pjesëmarrjen e sipërmarrësve që nuk dëgjojnë që shërbejnë si konsulentë dhe shembuj të mirë.

5.2.5 Aksesi në informacion dhe në shërbimet e përkthimit

Personat që nuk dëgjojnë nuk kanë akses në përkthim profesional të gjuhës së shenjave. Në fakt ata nuk kanë aspak akses në përkthim. Në vend ka vetëm gjashtë interpretë të gjuhës së shenjave, nga të cilët dy punojnë me kohë të plotë në ANAD dhe katër të tjerët janë të punësuar me kohë të plotë në vende të tjera. Ndaj katër interpretët e disponuar mund të prenotohen vetëm për pas orarit të punës dhe kryesisht në zonën e qytetit të Tiranës. Megjithatë, ata rrallë përdoren për përkthime private duke qenë se personat që nuk dëgjojnë nuk paguajnë dot për këtë shërbim. Në rastet kur personat që nuk dëgjojnë kanë patjetër nevojë për ndihmë në komunikim me njerëzit që dëgjojnë, ata kryesisht përdorin anëtarët e familjes.

Televizioni kombëtar TVSH ka një transmetim 5-15 minuta me lajme në gjuhën e shenjave në orën 13:00 gjatë ditëve të javës. Anëtarët e ANAD-it raportojnë se orari gjatë ditës nuk është i përshtatshëm për nxënësit, fermerët ose ata që janë të punësuar. Gjithashtu, personat që nuk dëgjojnë thonë se madhësia e personit që flet në gjuhën e shenjave në cep të ekranit të televizorit është mjaft e vogël dhe ata e kanë të vështirë të ndjekin gjuhën e shenjave. Nuk ka asnjë program tjetër të disponueshëm në gjuhën e shenjave.

Personat që nuk dëgjojnë nuk kanë asnjë metodë për të kërkuar ndihmë në gjuhën e shenjave në situata emergjence, ata nuk mund t'i telefonojnë policisë, ambulancës ose zjarrfikësve. Ata nuk mund të kuptojnë as paralajmërimet, alarmet ose njoftimet publike në situata emergjence.

Popullsia e personave që nuk dëgjojnë nuk kanë akses në informacionin e përditshëm në formë të folur ose të shkruar nga media e zakonshme si televizioni, radio, gazetatat ose interneti që janë të disponueshme për të gjithë të tjerët. Kjo u kufizon mundësitë për të qenë të përditësuar në ngjarjet që ndodhin në shoqëri ose botë. Krahasuar me personat

analfabetë që dëgjojnë, minoritetet etnike ose gjuhësore, mundësitë kufizohen edhe më tepër, duke qenë se personat që nuk dëgjojnë përjashtohen nga informacioni që ndahet edhe brenda familjes.

Qëllimi i ligjit *Për mbrojtjen nga diskriminimi*²¹ në Shqipëri, në nenin 2 germa b të tij deklaroi se çdo person ka të drejtën e shanseve dhe mundësive të barabarta për të ushtruar të drejtat dhe liritë e tij dhe për të marrë pjesë në jetën publike. Sipas gjetjeve të raportit nuk është e qartë se si personat që nuk dëgjojnë mund të ushtrojnë të drejta për të cilat ata nuk janë në dijeni ose të cilat nuk kanë asnjë mënyrë për ti mësuar.

Sipas KDPAK-së, neni 9 për aksesueshmërinë, në paragrafin 1 germa b deklarohet se autoritetet shtetërore duhet të eliminojnë të gjitha barrierat në aksesueshmërinë në informacion, komunikim dhe shërbime të tjera dhe (2E) ofrimin e interpretëve profesionalë në gjuhën e shenjave. Më konkretisht, në nenin 21 “Liria e fjalës dhe mendimit dhe qasja në informacion”, autoritetet shtetërore janë të detyruara ta japin informacionin që synohet për publikun e gjerë në formate të aksesueshme në kohën e duhur dhe pa kosto shtesë pavarësisht se kush është ofruesi i shërbimit (privat ose publik). Kjo nënkupton se duhet të miratohen masa legjislative dhe masa të tjera për të garantuar aksesin në informacionin dhe komunikimin e shtypur ose elektronik dhe shërbime të tjera duke përfshirë informacionet dhe shërbimet e emergjencës për përdoruesit e gjuhës së shenjave.

Personat që nuk dëgjojnë kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e lirisë së fjalës dhe të mendimit, duke përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe për të ndarë informacione në mënyrë të barabartë me të tjerët në gjuhën e shenjave, siç përcaktohet në nenin 2 të KDPAK-së. Neni 21 germa b dhe e e KDPAK-së, konkretisht nxit pranimin, lehtësimin dhe nxitjen e përdorimit të gjuhës së shenjave. Neni 30 “Pjesëmarrja në veprimtari të kulturore, zbavitëse, të kohës së lirë dhe sportive”, në paragrafin 1 germa b parashikon se personat që nuk dëgjojnë kanë të drejtën të gëzojnë akses në programet televizive, filma, teatro dhe veprimtari të tjera kulturore në formate të aksesueshme dhe në paragrafin 2 shpreh se për personat që nuk dëgjojnë duhet të garantohet mundësia për të zhvilluar dhe përdorur potencialin e tyre krijues, artistik dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por edhe për të pasuruar shoqërinë.

Masat e propozuara:

- Organizimi i trajnimit të interpretëve që dëgjojnë dhe nuk dëgjojnë, si fillim në nivel AFP-je, dhe më vonë në nivel universiteti.
- Vendosja e standardeve cilësore për përkthimin profesional në nivele të ndryshme.
- Ngritja e një qendre për shërbimin e përkthimit që mund të plotësojë nevojat për përkthim në të gjithë Shqipërinë dhe të shqyrtojë mundësinë për përkthim në distancë (për personat që nuk dëgjojnë të cilët jetojnë në zonat e thella).
- Organizimi i mundësive të personave që nuk dëgjojnë për t’u vendosur në kontakt dhe për të komunikuar me qendrat e reagimit në raste emergjencash nëpërmjet mesazheve me tekst dhe/ose videokonferencave duke përdorur një interpret për raste urgjencash.
- Ofrimi për personat që nuk dëgjojnë, pa pagesë dhe sipas nevojave të tyre, i shërbimeve të përkthimit në mjedise publike, studimi dhe private.

21 Ligji nr. 10221/2010 <http://www.legislationline.org/topics/country/47/topic/84>

- Garantimi i përkthimit në gjuhën e shenjave dhe/ose transmetimin në gjuhën e shenjave të të gjitha transmetimeve publike paralajmëruese, njoftuese ose që lidhen me orientimin në situata urgjence dhe emergjence (katastrofa natyrore, terrorizmi, etj.).
- Organizimi i aksesit në gjuhën e shenjave në informacionin në faqet e internetit të institucioneve publike vendore dhe qendrore dhe shërbimet e tyre.
- Zgjerimi i buletineve televizive të lajmeve në gjuhën e shenjave përgjatë gjithë ditëve të javës dhe zgjatja e orarit për të mbuluar më mirë të gjitha temat; transferimi i orarit në pasdite vonë ose herët në mbrëmje ose transmetimi i këtyre lajmeve dy herë në ditë; zmadhimi i imazhit të personit që flet me gjuhën e shenjave në ekran në mënyrë që të shikohet më mirë.
- Nisja e prodhimit të më shumë programeve televizive në gjuhën e shenjave, në veçanti programet e llojit informativ që paraqesin ngjarje aktuale nga këndvështrime të ndryshme.
- Të fillohet gradualisht me titrimin e të gjitha programeve të lajmeve dhe ato informuese në gjuhën shqipe dhe më pas të përfshihen edhe lloje të tjera programesh (zbavitëse, filma në gjuhën shqipe, etj.).
- Shqyrtimi i mundësisë për të hartuar dhe aplikuar shërbimet e lëvizshme të informacionit, si, për shembull, udhërrëfyes për muzeun në gjuhën e shenjave.

5.2.6 Për mbrojtjen sociale

Për shkak të kufizimeve në kohë, vrojtimi nuk përmbante pyetje për dhe nuk ka studiuar situatën ekonomike ose formulën e të ardhurave të të intervistuarve. Megjithatë, bazuar në përvojën e anëtarëve të ANAD-it dhe dëshmimeve të të intervistuarve të regjistruara nga raportet në terren, mund të dilet në përfundimin se popullsia e personave që nuk dëgjojnë nuk trajtohet në mënyrë të barabartë për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe pagesës përkatëse të përfitimeve (pensionit). Mungesa e dëgjimit nuk konsiderohet si aftësi e kufizuar që ndikon në aftësinë e një personi për të punuar duke qenë se pengesat gjuhësore nuk merren asnjëherë në konsideratë. Personat që nuk dëgjojnë në këtë rast gjenden pa rrugëdalje; nga njëra anë ata vlerësohen si (fizikisht) të aftë për të punuar dhe ndaj nuk u takojnë përfitime nga aftësia e kufizuar, dhe nga ana tjetër ata përballen me refuzimin në tregun e punës për shkak të aftësisë së kufizuar (komunikimi) të theksuar nga analfabetizmi që mbizotëron. Duke qenë se atyre u mohohen përfitimet që merren nga grupe të tjera të personave me aftësi të kufizuara (p.sh. të verbrit, para dhe tetraplegjikët, etj.), personat që nuk dëgjojnë kanë rënë pre e mangësive të skemave të mbrojtjes sociale. Trajtimi i pabarabartë ka çuar në një situatë ku personat që nuk dëgjojnë diagnostikohen me një “deficit” mendor shtesë që të përmbushin kriteret për pension të aftësisë së kufizuar²².

Ligji i ri kuadër për përfshirjen dhe aksesueshmërinë pritet që të reformojë sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Neni 10.3 deklaron se vlerësimi i aftësisë së kufizuar dhe nevojave për mbështetje dhe asistencë do të bazohet në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF; OBSH 2015b) të Organizatës

²² Përveç dëshmimeve nga anëtarët e ANAD-it, në raportin e PNUD-it në Shqipëri “Rishikimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri” (2014, 54), janë raportuar raste të diagnozave vullnetare shtesë.

Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Përdorimi i ICF-së do ta zhvendosë vëmendjen nga konfirmimi i diagnozës në vlerësim më gjithëpërfshirës edhe të aspekteve sociale dhe aftësisë për integrim që shoqëron aftësinë e kufizuar. Që kjo të rezultojë e suksesshme, është e nevojshme që në komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të përfshihet ekspertiza e nevojshme për të vlerësuar situatën e personave që nuk dëgjojnë dhe pengesat e aksesueshmërisë sociale dhe gjuhësore me të cilat ata përballen.

REFERENCA

ANAD. 2005. Gjuha e Shenjave Shqipe 1. Tiranë: Autori.

Argillander, A. 1999 [1762, 1771]. Forsökt sätt at lära dumbar läsa och tala. Në P. Eriksson, Dövas historia I Sverige och något om övriga Norden. Del 2 (159–163). Örebro: SIH Läromedel.

Argyrous, G. 1997. Statistics for Social Research (Statistikat për kërkime sociale). London: MacMillian Press.

Andoni, B., Shabani, I. & Baçi A. 2003. Minorities (Minoritetet): The present and the future (E tashmja dhe e ardhmja). Report of the Albanian Human Rights Group on the situation of minorities in Albania (Raporti i Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut për situatën e minoriteteve në Shqipëri). Tiranë: Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut.

Boucher, N. & Fiset, D. 2015. Monitoring individual experiences (Monitorimi i përvojave individuale). An innovative strategy to initiate social change in the exercise of human rights by persons with disabilities (Një strategji novatore për të nisur ndryshimet sociale në ushtrimin e të drejtave të njeriut nga personat me aftësi të kufizuara). Në M. H. Rioux & P. C. Pinto & G. Parekh (Eds.) Disability, rights monitoring and social change (Aftësia e kufizuar, monitorimi i të drejtave dhe ndryshimi social). Building Power out of Evidence (Fuqizimi i ngritur mbi fakte) (125–136). Toronto: Canadian Scholars' Press.

Charlton, J. 1998. Nothing about us without us: disability, oppression and empowerment (Asgjë për ne, pa ne: aftësia e kufizuar, shtypja dhe fuqizimi). Berkeley, CA: University of California Press.

Cohen, B., Durstenfeld, E. & Roehm, P. C. 2014. Viral Causes of Hearing Loss (Shkaqet virale të humbjes së dëgjimit): A review for Hearing Health Professionals (Material për profesionistët e shëndetësisë në fushën e problemeve me dëgjimin). Trends in Hearing (Tendencat në dëgjim), 18, 1–17. <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4222184/> [marrë më 3 qershor 2016].

Komisioni Evropian. 2016. Tabela 4: World Health Organisation Grades of hearing Iimpairment (Shkallët e dëmtimi të dëgjimit sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë). Health and food safety (Siguria e shëndetit dhe ushqimit). <http://ec.europa.eu/health/opinions/en/hearing-loss-personal-music-player-mp3/figtableboxes/table-4.htm> [marrë më 3 qershor 2016].

Ferré, C., Galanxhi, E. & Dhono, O. 2015. Profile of the Disabled population in Albania (Profili i personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri). Programi i Kombeve të Bashkuara për Mbështetjen e Përfshirjes Sociale në Shqipëri. Tiranë: Instituti i Statistikave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri. <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/profile-of-the-disabled-population-in-albania.html> [marrë më 3 qershor 2016].

Fortnum, H. & Davis, A. 1997. Epidemiology of permanent childhood hearing impairment in Trent Region (Epidemiologjia e mungesës së përhershme të dëgjimit në fëmijëri në Rajonin e Trentit), 1985–1993, *British Journal of audiology*, 31, 409–446.

Fortnum, H., Summerfield, A., Marshall, D., Davis, A. & Bamford, J. 2001. Prevalence of permanent childhood hearing impairment in the United Kingdom and implications for universal neonatal screening (Prevalenca e mungesës së përhershme të dëgjimit në fëmijëri në Mbretërinë e Bashkuar dhe implikimet për ekzaminimin universal neonatal): Studim konstatimi i bazuar në pyetësor. *British Medical Journal*, 323, 1–6.

Hoyer, K. 2007. Albanian Sign Language (Gjuha shqipe e shenjave): Language contact, International Sign, and gesture (Kontakti gjuhësor, Shenjat Ndërkombëtare dhe gjestet). Në D. Quinto-Pozos (Ed.) *Sign languages in contact (Gjuhët e shenjave në kontakt) (195–234)*. Washington DC: Gallaudet University Press.

Itard, J. 1801. *De l'éducation d'un homme sauvage, ou des premiers développemens physiques et moraux du jeune sauvage de l'Aveyron*. Paris: Goujon.

Jalonen, I. & Pohjonen, U. 1975. Tutkimus työikäisten kuurojen asemasta suomalaisessa yhteiskunnassa. [Studim për personat që nuk dëgjojnë në moshë për të punuar dhe situata e tyre në shoqërinë finlandeze.] Helsinki: Kuurojen Liitto ry [Shoqata Finlandeze e Njerëzve që nuk Dëgjojnë].

Kitchin, R. 1999. Morals and ethics in geographical studies of disability (Morali dhe etika në studimet gjeografike të aftësisë së kufizuar). Në J. D. Proctor & D. M. Smith (Eds.) *Geography and Ethics (Gjeografia dhe Etika)*. *Journeys in a Moral Terrain (Udhëtimet në një terren moral) (223–236)*. London & New York: Routledge.

Shoqata e Njerëzve që nuk Dëgjojnë në Kosovë dhe Shoqata Finlandeze e Njerëzve që nuk Dëgjojnë 2010. Report of the status of Deaf people in Republic of Kosovo (Raporti i statusit të personave që nuk dëgjojnë në Republikën e Kosovës). <http://www.finlandkosovo.org/public/download.aspx?ID=60612&GUID=%7B-FA9311EC-924D-4675-84EC-4BCB11BCA06D%7D> [marrë më 3 qershor 2016].

INSTAT 2012. *Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011. Rezultatet kryesore*. Tiranë: INSTAT, Instituti i Statistikave. <http://www.instat.gov.al/en/themes/population/publications/books/2012/main-results-of-population-and-housing-census-2011.aspx> [marrë më 3 qershor 2016].

Lane, H. 1984. *When the mind hears (Kur mendja dëgjon)*. A history of the deaf people (Një histori e personave që nuk dëgjojnë). New York: Random House.

Marschark, M. & Hauser, P. 2012. *How deaf children learn (Si mësojnë fëmijët që nuk dëgjojnë): What parents and teachers need to know (Çfarë duhet të dinë prindërit dhe mësuesit)*. Oxford: Oxford University Press.

Mitchell, R. & Karchmer, M. 2006. Demographics of deaf education (Demografia e arsimit të personave që nuk dëgjojnë): More students in more places (Më shumë studentë në më shumë vende). *American Annals of the Deaf (Kronikat Amerikane të personave që nuk dëgjojnë)*, 151, 95–104.

Mitchell, R. E. & Karchmer, M. A 2004. Chasing the mythical ten percent (Në kërkim të dhjetë përqindëshit mitik). Parental hearing status of deaf and hard of hearing students in the United States (Statusi i dëgjimit të prindërve të studentëve që nuk dëgjojnë dhe atyre me probleme në dëgjim në Shtetet e Bashkuara). *Sign Language Studies* (Studimet e Gjuhës së Shenjave), 4, 138–163.

Qendra Kombëtare për Statistikat e Shëndetësisë. 2016. Grupi i Uashingtonit për Statistikat e Aftësisë së Kufizuar. http://www.cdc.gov/nchs/washington_group/index.htm [marrë më 3 qershor 2016].

Shoqata Kombëtare e Fëmijëve që nuk Dëgjojnë. 2012. Prevalence of additional disabilities with deafness (Prevalenca e aftësive të tjera të kufizuara bashkë me mungesën e dëgjimit): Rishikim i literaturës. www.ndcs.org.uk/document.rm?id=7558 [marrë më 3 qershor 2016].

Divizioni i Shëndetit Publik në Oregon 2013. Measles and Rubella (Fruthi dhe Rubeola): Learning the Lesson the Hard Way (Kur vuajtjet bëhen mësim). Përmbledhje në CD 62 (16). <https://public.health.oregon.gov/DiseasesConditions/CommunicableDisease/CD-SummaryNewsletter/Documents/2013/ohd6216.pdf> [marrë më 3 qershor 2016].

Avokati i Popullit 2015. Report on the implementation of CEDAW convention in Albania (Raporti për zbatimin e Konventës së CEDAW në Shqipëri). Paraqitur në Komitetin e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave. Tiranë: Autor. http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/ALB/INT_CEDAW_IFN_ALB_21837_E.pdf [marrë më 3 qershor 2016].

Pinto, P. C. 2011. (Monitoring Human Rights) Monitorimi i të Drejtave të Njeriut. Në M. H. Rioux, L. A. Basser & M. Jones (Eds.) *Critical perspectives on human rights and disability law* (Perspektiva kritike për të drejtat e njeriut dhe ligjin për aftësinë e kufizuar) (451–477). Leiden & Boston: Martinus Nijhoff.

Reef, S. E. & Plotkin, S. A. 2013. Rubella vaccine (Vaksina e rubeolës). Në S. A. Plotkin, W. A. Orenstein & P. A. Offit (Eds.) *Vaccines* (Vaksinat) (botimi i 6-të) (688–717). [Edinburg]: Elsevier/Saunders.

Sacks, O. 1989. *Seeing Voices* (Zërat përmes vështrimit). Berkley & Los Angeles: University of California Press.

Sallavaci, S., Toci, E., Sallavaci, Y. & Stroni, G. 2014. Prevalence of hearing loss among first grade school children in Tirana, Albania? (Prevalenca e humbjes së dëgjimit mes fëmijëve të klasës së parë në Tiranë, Shqipëri?) A repeated cross-sectional survey (Një studim transversal i përsëritur). *Otolaryngology* (Otolaringologjia): Open Access (Akses i hapur). <http://omicsonline.org/open-access/prevalence-of-hearing-loss-among-first-grade-school-children-in-tirana-albania-a-repeated-crosssectional-survey-2161-119X.1000174.php?aid=31650> [marrë më 3 qershor 2016].

Samson, R. M. 2015. Securing the full participation of persons with disabilities and their representative organisations in disability rights monitoring. (Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara). Në M. H. Rioux, P. C.

Pinto & G. Parekh (Eds.) Disability, Rights Monitoring, and Social Change (Aftësia e kufizuar, Monitorimi i të Drejtave dhe Ndryshimi Social). Building Power out of Evidence (Fuqizimi i ngritur mbi fakte) (237-248). Toronto: Canadian Scholar's Press.

Skinner, R. 2013. Robert Skinner: Albania and the Deaf Community (Shqipëria dhe Komuniteti i personave që nuk dëgjojnë). Deaf Unity (Uniteti i personave që nuk dëgjojnë), 22 prill 2013. <http://deafunity.org/article-interview/robert-skinner-albania-deaf-community/> [marrë më 3 qershor 2016].

Suboti R. 1976. Histopathological findings in the inner ear caused by measles (Rezultatet histopatologjike të veshit të brendshëm të shkaktuara nga fruthi). The Journal of Laryngology & Otology 90 (Revista e Laringologjisë dhe Otologjisë 90 (2), 173–181.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri 2014. Review of the Disability Assessment System in Albania (Rishikimi i Sistemit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri). Tiranë. http://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/UNSSIA_Report_ReviewDisabilityAssessmentSystemInAlbania_English.pdf [marrë më 24 qershor 2016].

Tërësia e Traktateve të Kombeve të Bashkuara 2016. Kapitulli IV, Të drejtat e njeriut. Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Nju-Jork, 13 dhjetor 2006. https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-15&chapter=4&lang=en [marrë më 3 qershor 2016].

Organizata Botërore e Shëndetësisë [OBSh]. [2016]. Prevention of blindness and deafness, Estimates (Parandalimi i humbjes së shikimit dhe dëgjimit, Vlerësime). <http://www.who.int/pbd/deafness/estimates/en/> [marrë më 3 qershor 2016].

Organizata Botërore e Shëndetësisë [OBSh]. 2015a. Deafness and hearing loss (Mungesa e dëgjimit dhe humbja e dëgjimit). Dokumenti nr. 300. <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs300/en/> [marrë më 3 qershor 2016].

Organizata Botërore e Shëndetësisë [OBSh]. 2015b. International Classification of Functioning, Disability and Health (Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit, aftësive të kufizuara dhe shëndetit). <http://www.who.int/classifications/icf/en/> [marrë më 24 qershor 2016]

Organizata Botërore e Shëndetësisë [OBSh]. 2012. WHO global estimates on prevalence of hearing loss (Vlerësimet botërore të OBSh-së në lidhje me prevalencën e humbjes së dëgjimit). Mortality and burden of diseases and prevention of blindness and deafness (Vdekshmëria dhe barra e sëmundjeve dhe parandalimi i humbjes së shikimit dhe dëgjimit). http://www.who.int/pbd/deafness/WHO_GE_HL.pdf [marrë më 3 qershor 2016]

Organizata Botërore e Shëndetësisë [OBSh]. 2011. World report on disability (Raporti Botëror për Aftësinë e Kufizuar). http://www.who.int/disabilities/world_report/2011/en/ [marrë më 3 qershor 2016].

Organizata Botërore e Shëndetësisë [OBSh]. 2008. Grades of hearing impairment (Shkalla e dëmtimit të dëgjimit). http://www.who.int/pbd/deafness/hearing_impairment_grades/en/index.html [marrë më 15 shtator 2015].

NJERËZIT QË NUK DËGJOJNË NË SHQIPËRI

Identifikimi

1. Ju lutemi, mund të na tregoni...

(Shënoni me X, nëse personi nuk e di përgjigjen.)

Emri _____
Emri i babait _____
Emri i nënës _____
Mbiemri _____
Datw lindja (DD. MM. VVVV) _____
Numri i Identitetit (NID) _____

2. Kodi i rrethit (Qyteti/Fshati) vendbanimi që jetoni tani (në momentin e intervistës)

- | | | | | | |
|----------------------------------|--------------------------------------|----------------------------------|-----------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| <input type="radio"/> 01 Berat | <input type="radio"/> 07 Elbasan | <input type="radio"/> 13 Kolonjë | <input type="radio"/> 19 Lezhë | <input type="radio"/> 25 Mirditë | <input type="radio"/> 31 Skrapar |
| <input type="radio"/> 02 Bulqizë | <input type="radio"/> 08 Fier | <input type="radio"/> 14 Korçë | <input type="radio"/> 20 Librazhd | <input type="radio"/> 26 Peqin | <input type="radio"/> 32 Shkodër |
| <input type="radio"/> 03 Delvinë | <input type="radio"/> 09 Gramsh | <input type="radio"/> 15 Krujë | <input type="radio"/> 21 Lushnjë | <input type="radio"/> 27 Përmet | <input type="radio"/> 33 Tepelenë |
| <input type="radio"/> 04 Devoll | <input type="radio"/> 10 Gjirokastrë | <input type="radio"/> 16 Kuçovë | <input type="radio"/> 22 Malësi e Madhe | <input type="radio"/> 28 Pogradec | <input type="radio"/> 34 Tiranë |
| <input type="radio"/> 05 Dibër | <input type="radio"/> 11 Has | <input type="radio"/> 17 Kukës | <input type="radio"/> 23 Mallakastër | <input type="radio"/> 29 Pukë | <input type="radio"/> 35 Tropojë |
| <input type="radio"/> 06 Durrës | <input type="radio"/> 12 Kavajë | <input type="radio"/> 18 Kurbin | <input type="radio"/> 24 Mat | <input type="radio"/> 30 Sarandë | <input type="radio"/> 36 Vlorë |

3. Cila është gjinia juaj?

- Mashkull Femër

4. Cila është gjendja juaj civile?

- Beqar I/E fejuar I/E martuar I/E divorcuar I/E ve

5. Keni ndonjë fëmijë?

- Jo Po, 2 Po, 4
 Po, 1 Po, 3 Kam më tepër se 4. Sa? _____

6. Me kë jetoni tani?

(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)

- Vetëm Me motrat/vëllezërit Me bashkëshortin/en dhe fëmijët Me vjehrrën/vjehrrin
 Me prindërit Me gjyshin/en (gjyshërit) Me bashkëshortin/en

Pyetje për humbjen e dëgjimit/shurdhërinë

7. Si e përshkruani veten?

- Person që nuk dëgjon Me vështirësi në dëgjim Me humbje të vonë të dëgjimit Dëgjoj por nuk flas

8. Në çfarë moshe u bëtë person që nuk dëgjon/me vështirësi dëgjimi?

- Kam lindur me humbje dëgjimi Përpara moshës shkollore Pas moshës 15 vjeç
 Përpara moshës dy vjeç Ndërmjet moshës 6 - 15 vjeç Nuk e di

9. Si u bëtë person që nuk dëgjon / me vështirësi dëgjimi?

(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)

- Për shkak dëmtimi / sëmundjeje Arsye tjetër
 Nëna ishte e sëmurë gjatë shtatzënisë Nuk e di
 Shurdhëri e trashëguar (prindërit apo vëllezërit/motrat janë persona që nuk dëgjonë)
 Humba gradualisht dëgjimin

10. Është ndonjëri prej familjarëve tuaj, me vështirësi dëgjimi, ose që nuk dëgjon?

(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)

	Me vështirësi dëgjimi	Nuk Dëgjon
Prindi (prindërit)	<input type="checkbox"/> -	<input type="checkbox"/> .
Bashkëshorti/ja	<input type="checkbox"/> -	<input type="checkbox"/> -
Motra/vëllai	<input type="checkbox"/> -	<input type="checkbox"/> -
Fëmija/fëmijët	<input type="checkbox"/> -	<input type="checkbox"/> -
Gjyshi/gjyshërit	<input type="checkbox"/> -	<input type="checkbox"/> -
Vjehrrit	<input type="checkbox"/> -	<input type="checkbox"/> -

11. A keni të afërm të tjerë (kushurin, halla, daja) që nuk dëgjojnë?

- Jo Po

12. Keni aftësi të tjera të kufizuara?

- Jo Po Nuk e di Nuk dua të përgjigjem

13. Cila është aftësia juaj tjetër e kufizuar tjetër??

(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)

- I verbër Aftësi e kufizuar mendore ose inteligjence Tjetër
 Vështirësi shikimi Aftësi e kufizuar fizike Nuk dua të përgjigjem

Pyetje për profesionin tuaj

14. Para një muaji nga sot, keni punuar të paktën një orë?

- Po, në një punë stabël Po, në punë me kohë të pjesshme Jo, nuk kum punuar, asnjë orë

15. Nëse nuk punoni, shpjegoni pse?

- Jam i papunë Jam student Jam shtëpiake Te tjera

16. Në çfarë fushe punoni?

Zgjidhmi një:

- Bujqësi/blegtori Argjendari Furrë buke Elektricitist
 Saldim Rrobaqepësi Parukeri Lavazh
 Ndërtim Mekanik makinash Shtypshkrim Dekor
 Mobilieri Këpucari Pastrim Te tjera

17. Për kë punoni?

- Punoj në shtet Punoj në biznesin e familjes Tjetër
 Punoj në privat Jam i vetëpunësuar

Pyetje për komunikimin

18. A e njihni gjuhën e shenjave shqipe?

- Po e njoh mirë Po e njoh pak Jo nuk e njoh fare

19. Në çfarë moshe e mësuat gjuhën e shenjave shqipe?

Në moshën (vjeç): _____

20. Ku e mësuat gjuhën e shenjave shqipe?

(Zgjidhmi të gjitha që aplikohen.)

- Nga fëmijët e tjerë që nuk dëgjojnë në shkollë Nga motra/vëllai Nga njerëz që nuk dëgjojnë në zonë
 Nga mësuesit Nga të afërm të tjerë që nuk dëgjojnë Nga kontakti me ANAD
 Nga prindërit

21. Dini gjuhë të tjera shenjash?

- Jo Po. Cilën? _____

22. Si komunikoni tani me anëtarët që dëgjojnë të familjes? Me...

(Zgjidhmi të gjitha që aplikohen.)

- Gjuhën shqipe të folur Gjeste Gjuhën e shenjave
 Gjuhën shqipe të shkruar Daktilim Nuk komunikoj me anëtarët e familjes

23. Si komunikoni tani me njerëzit e tjerë që dëgjojnë (jo anëtarë të familjes)? Përdor...

(Zgjidhmi të gjitha që aplikohen.)

- Gjuhën shqipe të folur Duke treguar me gisht, me gjeste Unë i kërkoj një të afërmi ose shoku/shoqe të më ndihmojë
 Gjuhën shqipe të shkruar Gjuhën e shenjave shqipe Unë nuk di të komunikoj me ata
 Fotografji, figura; vizatime Me interpret te gjuhës së shenjave

24. Njerëzit e tjerë që dëgjojnë (jo anëtarë të familjes) ju kuptojnë kur komunikoni me ta?

- Po, më kuptojnë shumë mirë Nuk më kuptojnë edhe aq mirë Nuk më kuptojnë fare

25. E keni të lehtë t'i kuptoni njerëzit që dëgjojnë kur flasin?

- Po, është e lehtë Jo, nuk është edhe aq e lehtë Nuk mundem fare t'i kuptoj

26. Kush ju ndihmon ju kur komunikoni me njerëz që dëgjojnë? - për shembull kur shkoni në bankë?

(Zgjidhmi të gjitha që aplikohen.)

- Prindërit e mi Vëllai/motra Miqtë që dëgjojnë
 Fëmijët e mi të mitur Bashkëshorti/ja Mësuesit e shkollës së të nxënësve që nuk dëgjojnë
 Fëmijët e mi të rritur Miqtë me vështirësi dëgjimi Njerëz të tjerë

27. Keni pasur rastin të kontaktoni interpret profesionist te gjuhës së shenjave? (Jo anëtarë të familjes apo miq)

- Gjithmonë Ndonjëherë Kurrë

28. Kur shikoni një film në televizor, a i kuptoni titrat në gjuhën shqipe?

- Po, i kuptoj shumë mirë Po, i kuptoj me pak vështirësi Jo, nuk i kuptoj fare

29. A e kuptoni një mesazh të dërguar nga një person që dëgjon?

- Po, e kuptoj mesazhin shumë mirë Po, e kuptoj mesazhin me pak vështirësi Jo, nuk e kuptoj fare

30. A ju kuptojnë personat që dëgjojnë kur juve ju dërgoni atyre një mesazh të shkruar?

- Po, e kuptojnë mesazhin shumë mirë Jo, nuk e kuptojnë fare
 Po, e kuptojnë mesazhin me pak vështirësi Nuk e di

31. Kur shkruani një mesazh një personi që dëgjon, a keni nevojë për ndihmë nga një personi tjetër?

- Po, gjithmone më nevojitet ndihmë Po, ndonjëherë kam nevojë për ndihmë Jo, nuk kam nevojë për ndihmë


32. E keni të lehtë të shkruani gjuhën shqipe?

- Po, është e lehtë Kam vështirësi Nuk di të shkruaj fare shqip

33. Lexoni këtë teks. Me cilat nga figurat lidhet? Zgjidhni vetem tre.

Vendos (vizato) këto foto në të njëjtën mënyrë si historia.

Njëherë e një kohë ishte një sorrë që jetonte në buzë të pyllit, pranë një livadhi, ku një tufë me dele po kulloste. Një mëngjes, sorra ishte ulur mbi degën e një peme pishë duke vështruar lart në qiell. Ajo pa një shqiponjë në qiell. Papritmas shqiponja sulmoi në mes të kopesë. Shqiponja rrëmbeu një qengj dhe fluturoi larg. Sorra vendosi të bëjë të njëjtën gjë. Sorra fluturoi poshtë në drejtim të kopesë.



- Rivendosur vizatime

Pyetje për arsimin tuaj**34. Keni shkuar në parashkollor?**

(në gjuhën e shenjave = klasa 0)

- Po Jo

35. Keni shkuar në shkollën tetëvjeçare (shkolla e nxënësve që nuk dëgjojnë)?

(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)

- Po
- Po, unë kam ndjekur shkollën e zakonshme. Për sa vite keni ndjekur arsimin e zakonshëm? _____
- Po, unë kam ndjekur shkollën e zakonshme. Për sa vite keni ndjekur arsimin e zakonshëm? _____
- Jo, unë kam ndjekur vetëm shkollën e zakonshme. Për sa vite keni ndjekur arsimin e zakonshëm? (___ vjet) _____
- Jo, prindërit nuk kishin lekë të paguanin tarifat e shkollës.
- Jo, prindërit nuk e dinin për ekzistencën e Institutit të Nxënësve që Nuk Dëgjojnë.
- Jo, shkolla ishte shumë larg shtëpisë.
- Jo, prindërit nuk dëshironin të shkoja në një shkollë me konvikt.
- Jo, arsye tjetër.

36. E keni mbaruar shkollën tetëvjeçare (shkolla e nxënësve që nuk dëgjojnë)?

(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)

- Po
- Jo, familja nuk i përballonte dot shpenzimet
- Jo, prindërit nuk ishin të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies
- Jo, kisha frikë të shkoja në shkollë për shkak të dhunës/ngacmimeve
- Jo, familja ime u shpërngul në një qytet tjetër të Shqipërisë
- Jo, familja ime u shpërngul në një shtet tjetër
- Jo, arsye tjetër

37. Sa vite e keni ndjekur shkollën tetëvjeçare (shkolla e nxënësve që nuk dëgjojnë)?

- 1 vit 2 vjet 3 vjet 4 vjet 5 vjet 6 vjet 7 vjet 8 vjet

38. Cilën shkollë të Nxënësve që Nuk Dëgjojnë keni ndjekur?

(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)

- Shkollën e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë në Tiranë
- Shkollën e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë në Itali
- Shkollën e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë në Maqedoni
- Shkollën e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë në Greqi
- Shkollën e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë në Kosovë

39. Cila (cilat) ishte (ishin) mënyrat e komunikimit të përdorura në shkollën (tetëvjeçare)?*(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)*

- E folur E shkruar Me gjeeste Daktilim Gjuha e shenjave Tjetër

40. Mendoni se aftësitë e komunikimit të mësuesve kur përdornin shenja ishin...

- Të shkëlqyera Mesatare Të dobëta

41. Keni shkuar në shkollën e mesme?

- Po Jo

42. Cila ishte mënyra e komunikimit e përdorur në shkollën e mesme?*(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)*

- E folur Me gjeeste E shkruar Gjuha e shenjave Tjetër

43. Kishit vështirësi në arsimin e mesëm?

- Jo, nuk kisha vështirësi Jo, pak Po, shumë

44. Çfarë lloj vështirësish?*(Zgjidhni të gjitha që aplikohen.)*

- Mungesë e interpretëve të gjuhës së shenjave Aftësitë e mia në lexim ishin të dobëta Aftësitë e mia në të shkruar ishin të dobëta Të tjera

45. Keni ndjekur arsimin e lartë mbas gjimnazit?

- Po. (Ku?) Jo

Pyetje për lajmet në gjuhën e shenjave në televizor**46. Keni parë lajme me gjuhën e shenjave në televizor?**

- Po Jo

47. Sa herë shihni lajme në gjuhën e shenjave?

- Çdo ditë Disa herë në javë Disa herë në muaj

48. A merrni informacion nga Shqipëria dhe bota?

- Duke parë lajmet në televizion në gjuhën e shenjave. Nga njerëz të cilët përdorin gjuhën e shenjave.
 Duke lexuar gazetatat dhe lajmet në internet. Duke parë televizor.
 Nga interneti ku përdoret gjuha e shenjave. Nga njerëz të tjerë (të cilët nuk përdorin gjuhën e shenjave).

Faleminderit për pjesmarrjen tuaj

Statistika të tjera për popullsinë me probleme në dëgjim sipas Censurit të vitit 2011 në Shqipëri.

Alma Kondi, INSTAT 2016.

Tabela I. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas qarqeve.

Qarku	Numri i personave
Berat	213
Dibër	154
Durrës	249
Elbasan	357
Fier	408
Gjirokastër	118
Korçë	209
Kukës	93
Lezhë	181
Shkodër	246
Tirana	511
Vlorë	276
Totali	3 015

Tabela II. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të shikojnë, dhe që nuk mund të komunikojnë sipas qarqeve.

Qarku	Numri i personave
Berat	116
Dibër	73
Durrës	132
Elbasan	216
Fier	295
Gjirokastër	71
Korçë	101
Kukës	62
Lezhë	112

Shkodër	125
Tirana	311
Vlorë	201
Totali	1 815

Table III. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme intelektuale sipas qarqeve.

Qarku	Numri i personave
Berat	125
Dibër	78
Durrës	137
Elbasan	220
Fier	304
Gjirokastër	74
Korçë	108
Kukës	62
Lezhë	116
Shkodër	126
Tirana	309
Vlorë	201
Totali	1 860

Tabela IV. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët që nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme lëvizjeje sipas qarqeve.

Qarku	Numri i personave
Berat	126
Dibër	79
Durrës	139
Elbasan	216
Fier	309
Gjirokastër	75
Korçë	106
Kukës	62
Lezhë	114

Shkodër	134
Tirana	322
Vlorë	208
Totali	1890

Tabela V. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët që nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas nivelit arsimor.

Niveli arsimor	Numri i personave 15+
Nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë	1826
Pa diplomë	74
Fillor	491
Dytësor i ulët	464
Dytësor i lartë	135
Niveli i parë i arsimit të lartë	25
Totali	3 015

Tabela VI. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas nivelit arsimor.

Niveli arsimor	Numri i personave 15+
Nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë	1051
Pa diplomë	56
Fillor	364
Dytësor i ulët	222
Dytësor i lartë	100
Niveli i parë i arsimit të lartë	22
Totali	1 815

Tabela VII. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme intelektuale sipas nivelit arsimor.

Niveli arsimor	Numri i personave 15+
Nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë	1069
Pa diplomë	57

Fillor	380
Dytësor i ulët	227
Dytësor i lartë	105
Niveli i parë i arsimit të lartë	22
Totali	1 860

Tabela VIII. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme lëvizjeje sipas nivelit arsimor.

Niveli arsimor	Numri i personave 15+
Nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë	1078
Pa diplomë	57
Fillor	391
Dytësor i ulët	231
Dytësor i lartë	109
Niveli i parë i arsimit të lartë	24
Totali	1 890

Tabela IX. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas statusit të punësimit.

Statusi i punësimit	Numri i personave 15+
I punësuar	84
I papunë	46
Jo aktiv	2 885
Totali	3 015

Tabela X. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas statusit të punësimit.

Statusi i punësimit	Numri i personave 15+
I punësuar	30
I papunë	22
Jo aktiv	1 763
Totali	1 815

A. Shënime

- h = Shtresa, 12 prefektura në Shqipëri
 i = ZN kampion (Zonat e Numërimit), $i = 1, \dots, n_h$
 j = Familja kampion (Familje), $j = 1$ deri në 8.
 k = Personat kampion $k=1$.

- n_h = Numri i ZN-ve kampion brenda shtresës h .
 m_{hi} = Numri i ZN-ve kampion brenda shtresës h .
 m_{hij} = Numri i personave kampion në familje në ZN-në i të shtresës h .
 M_h = Numri total i familjeve në kuadër të (Census 2011) brenda shtresës h .
 M_{hi} = Numri total i familjeve në kuadër të (Census 2011) në ZN-në i të shtresës h .
 M_{hij} = Numri total i personave në familje në ZN-në i të shtresës h .

B. Probabiliteti i përzgjedhjes

Probabilitetet e kampionit janë parametra të rëndësishme për studimin, sepse ato janë baza e përlogaritjeve për vlerësimin e kampionit. Probabilitetet e kampionit do të përlogariten më vete për çdo fazë të kampionit dhe për çdo NJPK.

1. Probabiliteti i përzgjedhjes së ZN-së i në shtresën sociale dhe ekonomike h .

Nh është numri i NJPK-ve të përzgjedhura në shtresën h , M_{hi} numri i familjeve sipas kuadrit të kampionit në NJPK-në i , dhe M_h numri total i familjeve në një shtresë. Probabiliteti i përzgjedhjes së NJPK-së i në kampion llogaritet si më poshtë:

$$(1) \quad p_1 = n_h \frac{M_{hi}}{M_h}$$

2. Probabiliteti i përzgjedhjes së familjes j , duke përfshirë ZN-në i .

M_{hi} është numri i familjeve të renditura në listën e familjeve në grupin i të shtresës h , m_{hi} është numri i familjeve të përzgjedhura në NJPK. Probabiliteti i përzgjedhjes në fazën e dytë për çdo familje në NJPK llogaritet si më poshtë:

$$(2) \quad p_1 = n_h \frac{M_{hi}}{M_h}$$

3. Probabiliteti i përzgjedhjes së personit k , duke përfshirë ZN-në i dhe familjen j .

m_{hi} është numri i personave të renditur në listën e familjeve në grupin i të shtresës h , m_{hij} është numri i personave të kthyer të përzgjedhur në familje, NJPK. Probabiliteti i përzgjedhjes në fazën e dytë për çdo familje në NJPK llogaritet si më poshtë:

$$(3) \quad p_2 = \frac{m_{hi}}{M_{hi}}$$

4. Rrjedhimisht, probabiliteti i përgjithshëm i përzgjedhjes për çdo familje në NJPK i të shtresës h është produkt i probabiliteteve të përzgjedhjes në të tre fazat:

$$(4) \quad p_1 * p_2 * p_3 = n_h \frac{M_{hi}}{M_h} * \frac{m_{hi}}{M_{hi}} * \frac{m_{hij}}{M_{hij}} = n_h \frac{m_{hi}}{M_h} * \frac{m_{hij}}{M_{hij}}$$

C. Faktorët bazë të vlerësimit

Faktori bazë i vlerësimit për çdo person është i barabartë me probabilitetin reciprok të përzgjedhjes së personit. Faktori i vlerësimit merr në konsideratë probabilitetet e përzgjedhjes në secilën prej fazave të përzgjedhjes, ashtu siç shpjeguar në seksionin e mëparshëm.

Faktori bazë i vlerësimit nuk ndryshon brenda çdo ZN-je, por ndryshon disi nga njëra ZN në tjetrën brenda një shtrese, në varësi të ndryshimit të numrit të familjeve dhe personave të kthyer në atë kuadër. Ky ndryshim shkaktohet nga rregullimi që diskutuam më parë për të kompensuar mangësitë në kuadrin e Censurit 2011.

Faktori fillestar ose bazë i vlerësimit është i barabartë me probabilitetin reciprok të përzgjedhjes. Kjo rezulton nga:

$$(5) \quad w_{dhij} = \frac{1}{p_1 * p_2 * p_3} = \frac{1}{n_h \frac{m_{hi}}{M_h} * \frac{m_{hij}}{M_{hij}}} = \frac{1}{n_h} * \frac{M_h * M_{hij}}{m_{hi} * m_{hij}}$$

D. Rregullimet e faktorëve bazë të vlerësimit

Faktori bazë ose fillestar i vlerësimit i përmendur në seksionin e mëparshëm përfaqëson probabilitetin e përzgjedhjes së personit, në bazë të informacionit të marrë nga kuadri i Censurit në tetor të vitit 2011. Në disa situata të caktuara, do të lindë nevoja të bëhen rregullime të faktorit bazë apo fillestar.

Rregullimet e faktorëve bazë të vlerësimit janë të një lloji: rregullimi nga mospërgjigjet (njëri nga faktorët), F_{1hi} përcaktohet në seksionin më poshtë. Këto do të shumëzohen me faktorët bazë të vlerësimit sipas rastit.

Faktori përfundimtar i vlerësimit (d.m.th. pas rregullimeve) rezulton nga:

$$(5) \quad w_{dhij}^* = w_{dhij} * F_{1hi}$$

Vini re se w_{dhij}^* nuk do të jetë domosdoshmërisht e pandryshueshme brenda ZN-së i në të gjitha rastet.

E. Rregullimet nga mospërgjigjet

Përdorimi i faktorit bazë të vlerësimit presupozon vetëm ekzistencën e intervistave krejtësisht të përfunduara. Në shumicën e rasteve kjo është e vërtetë. Nëse ka pasur raste kur nuk janë marrë përgjigje gjatë intervistave, do të na duhet të rregulojmë vlerësimin e njësive për të cilat është marrë informacion në mënyrë që të kompensohet humbja e individëve të vlefshëm. Rregullimi do të kryhet në nivel prefekturë, ku mund të prezumohet një nivel i caktuar homogjeniteti mes familjeve lidhur me variablat sociale dhe ekonomike që përbëjnë interes.

TABELA

Tabela 1.	Shkalla e dëmtimit të dëgjimit.
Tabela 2.	Shpërndarja e ZR-ve, familjeve dhe individëve me aftësi të kufizuara në dëgjim, sipas qarqeve.
Tabela 3.	Zonat e vlerësimit (qarku).
Tabela 4.	Madhësia e kampionit sipas qarqeve.
Tabela 5.	Numri mesatar i familjeve për ZR dhe numri mesatar i personave për familje sipas qarkut dhe zonës urbane/rurale, sipas Census 2011 në Shqipëri.
Tabela 6.	Mosha mesatare e popullsisë në total, personave me aftësi të kufizuara dhe personave që nuk dëgjojnë.
Tabela 7.	Krahasimi i grupit të kampionit të intervistuar dhe madhësia e propozuar e grupit të kampionit nga INSTAT.
Tabela 8.	Shpërndarja e të intervistuarve sipas moshës dhe zonës së banimit.
Tabela 9.	Anëtarët që nuk dëgjojnë apo ata me probleme në dëgjim në familjet e të anketuarve.
Tabela 10.	Mënyra e komunikimit e përdorur në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë.
Tabela 11.	Formimi arsimor dhe të kuptuarit e teksteve të shkruara.
Tabela 12.	Aftësitë në të shkruar të vlerësuara nga vetë të anketuarit, të ndër-tabuluara me formimin arsimor.
Tabela 13.	Aftësitë në të shkruar të të anketuarve të vlerësuara nga persona të jashtëm, të ndër-tabuluara me formimin arsimor.
Tabela 14.	Punësimi dhe formimi arsimor.
Tabela 15.	Punësimi në grupin e synuar (dhjetor 2014 - shkurt 2015).
Tabela 16.	Statusi i punësimit në fusha të ndryshme pune.
Tabela 17.	Vendbanimi dhe statusi i punësimit në momentin e intervistës.
Tabela 18.	Komunikimi me anëtarë të familjes që dëgjojnë.
Tabela 19.	Përgjigjet ndaj pyetjes “Si komunikoni me persona të tjerë që dëgjojnë”.
Tabela 20.	Ndër tabulimi mes aftësive në gjuhën e shenjave dhe punësimit.
Tabela 21.	Mosha e të anketuarve dhe të kuptuarit e titrave.
Tabela 22.	Burimet e lajmeve për të anketuarit sipas grupmoshave.
Tabela 23.	Suksesi në detyrën e leximit dhe në marrjen e informacionit nga tekstet e shkruara të lajmeve.
Appendix 2.	
Tabela I.	Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas qarqeve.
Tabela II.	Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të shikojnë, dhe që nuk mund të komunikojnë sipas qarqeve.
Tabela III.	Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme intelektuale sipas qarqeve.

- Tabela IV. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët që nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme lëvizjeje sipas qarqeve.
- Tabela V. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët që nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas nivelit arsimor.
- Tabela VI. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas nivelit arsimor.
- Tabela VII. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme intelektuale sipas nivelit arsimor.
- Tabela VIII. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe me probleme lëvizjeje sipas nivelit arsimor.
- Tabela IX. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas statusit të punësimit.
- Tabela X. Numri i personave 15 vjeç e sipër, të cilët nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të shikojnë dhe nuk mund të komunikojnë sipas statusit të punësimit.

FIGURA

- Figura 1. Intervistuesit që nuk dëgjojnë gjatë trajnimit në zyrat e ANAD-it në Tiranë përpara nisjes së punës në terren.
- Figura 2. Eduart Ajas me një të anketuar vendas rrugës për në shtëpinë e tij në një fshat të largët.
- Figura 3. Foto nga intervistat në terren. I anketuari i përqendruar në testin e leximit dhe në dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të vrojtimit të përcjella përmes shenjave nga personat që punuan në terren.
- Figura 4. Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës, Census 2011.
- Figura 5. Popullsia banuese 15 vjeç e lart sipas gjinisë, grupmoshës dhe shkallës së aftësisë së kufizuar në dëgjim, Censusi i Popullsisë i vitit 2011.
- Figura 6. Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës, personat që nuk dëgjojnë sipas vrojtimit.
- Figura 7. Personat që nuk dëgjojnë sipas gjendjes civile.
- Figura 8. Personat që ndihmojnë të anketuarit në komunikim.
- Figura 9. Zotërimi i gjuhës shqipe të shenjave mes të anketuarve.
- Figura 10. Ku e keni mësuar gjuhën shqipe të shenjave?



Personat që nuk Dëgjojnë në Shqipëri 2015 – Studim

Qëllimi i këtij studimi “Personat që nuk Dëgjojnë në Shqipëri 2015” është sigurimi i informacionit për personat e rritur që nuk dëgjojnë në Shqipëri, mundësitë e tyre për ndërveprim me njerëzit në jetën e përditshme dhe aksesin e tyre në informacion, arsimim dhe punësim, në kuadër të neneve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) lidhur me personat që nuk dëgjojnë dhe gjuhën e shenjave. Personat që nuk dëgjojnë u përfshinë në të gjitha aspektet dhe fazat e procesit të studimit, që nga planifikimi e deri te shpërndarja e rezultateve përmes zbatimit të metodave me pjesëmarrje dhe me bashkëpunim të studimeve më të fundit të aftësisë së kufizuar. Nëntë intervistues që nuk dëgjojnë nga Shoqata Kombëtare e Shqiptare Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD) i kryen anketimet në fillim të vitit 2015, duke intervistuar 434 persona që nuk dëgjojnë në gjuhën e shenjave.

Kjo është hera e parë që në botë kryhet një studim demografik statistikor i këtij niveli nga personat që nuk dëgjojnë në gjuhën e shenjave.

“Ekipi i studimit shpreh mirënjohjen e tij për të gjithë personat që nuk dëgjojnë dhe interpretët që dhanë kontributin e tyre në këtë studim: anëtarët e ekipeve të punës në terren që udhëtuan në të gjithë Shqipërinë; drejtuesit e komuniteteve që nuk dëgjojnë nëpër rrethe dhe personat e kontaktit për ndihmën e dhënë në gjetjen e personave që nuk dëgjojnë për t’u intervistuar dhe shoqërimin në disa raste të ekipeve edhe në zonat më të thella të vendit; të gjithë të anketuarit që morën pjesë në intervista si dhe familjarët dhe të afërmit e tyre të cilët lehtësuan komunikimin. Falë informacioneve të dhëna prej jush u bë i mundur realizimi i këtij vrojtimi shumëkrahësh dhe shumëgjuhësor.”

– Florjan Rojba

Koordinator i Përgjithshëm i ANAD-it

